


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**
**RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË BASHKINË TEPELENË”**
**Dhjetor 2019**

<b>PËRMBAJTJA</b>	<b>Faqe</b>
Përmbajtja e lëndës dhe shkurtime	1-2
<b>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	3-11
<i>a. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.</i>	
<i>b. Përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve.</i>	
<i>c. Konkluzioni dhe opinioni i auditimit.</i>	
<b>II. HYRJA</b>	12-15
<i>Objektivat dhe qëllimi.....</i>	
<i>Identifikimi i çështjes.....</i>	
<i>Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....</i>	
<i>Përgjegjësitë e audituesve.....</i>	
<i>Kriteret e vlerësimit.....</i>	
<i>Standardet e auditimit.....</i>	
<b>III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>	16-16
<b>IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET</b> (Përmbajtja e punës së kryer)	
A. Mbi vlerësimin e kontrollit të brendshëm.....	17-19
B.1. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit.....	20-25
B.2. Burimi i krijimit të të ardhurave dhe vlerësimi i mbledhjes së tyre.....	25-42
C. Vlerësimi i Raportimit Financiar (Pasqyrat financiare).....	42-52
D.1. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike.....	52-60
D.2. Hartimi dhe zbatimi i kontratave të punimeve.....	60-72
E. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.....	72-78
<b>V. REKOMANDIMET</b>	79-92
<b>VI. ANEKSET</b>	93-108


**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**
**SHKURTIMET**

<b>KLSH</b>	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
<b>MFK</b>	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
<b>NA</b>	Nëpunës Autorizues.
<b>NZ</b>	Nëpunës Zbatues.
<b>GSM</b>	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
<b>NJAB</b>	Njësia e Auditimit të Brendshëm.
<b>AB</b>	Auditi i Brendshëm
<b>MAB</b>	Manuali i Auditimit të Brendshëm.
<b>FZHR</b>	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
<b>AQT</b>	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
<b>UMF</b>	Udhëzim i Ministrisë së Financave
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave.
<b>VKB</b>	Vendim i Këshillit Bashkiak.
<b>ISSAI</b>	Standartet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
<b>INOTSAI</b>	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
<b>IFAC</b>	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
<b>IPSAS</b>	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
<b>ALUIZNI</b>	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave të Ndërtimeve Informale.
<b>IT</b>	Teknologjia e Informacionit.
<b>NJA</b>	Njësi Administrative.
<b>SHA</b>	Shoqëri Anonimë.
<b>BOE</b>	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë.
<b>OE</b>	Operator Ekonomik.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”

#### I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

##### I.a. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr.603/1 prot., datë 26.08.2019 dhe shkresës “Njoftim për ndryshim në programin e auditimit”, nr.603/2 prot., datë 21.10.2019, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 02.09.2019 deri më datën 15.11.2019, në Institucionin Bashkia Tepelenë u krye auditimi “Financiar dhe i përputhshmërisë”. Auditimi mbuloi periudhën: prej 01.01.2017 deri më datën 30.09.2019.

Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. Berti Meçaj, përgjegjës grupi
2. Hekuran Avdulaj, anëtar grupi
3. Herman Imeraj, anëtar grupi
4. Alush Zaçe, anëtar grupi
5. Skënder Muçaj, anëtar grupi
6. Fatos Çoçoli, anëtar grupi

Auditimi u krye me zgjedhje, mbi bazën e riskut dhe materialitetit.

Auditimi u krye për hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2017 dhe 2018, rregjistrimin e të dhënave dhe mbajtjen e kontabilitetit, aplikimin e parimeve kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe parimet për një qeverisje të mirë në përmbushje të objektivave të institucionit, ngritjen dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, vlerësimin e njësisë së auditit të brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, planifikimin për të ardhurat dhe masat e marra për arkëtimin e tyre, zbatimin e kuadrit rregullator në fuqi për zhvillimin e i procedurave të prokurimit publik dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

Për këto u analizuan evidencat e marra nga subjekti i audituar, u krye analiza e llogarive të pasqyrave financiare dhe llogarive analitike, duke u fokusuar në aktivin dhe pasivin e pasqyrës së pozicionit financiar.

Për gjetjet e konstatuara janë mbajtur 19 akte konstatimi dhe dy akt verifikime, të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit të auditimit brenda afatit të periudhës së auditimit.

Nga grupi i auditimit janë shqyrtuar me kujdes kundërshtitë e bëra nga subjekti i audituar, mbi aktet e konstatimit dhe projektraportin dhe janë marrë në konsideratë ato kundërshti të cilat janë të mbështetura nga ana ligjore, apo është paraqitur dokumentacion shtesë, ndërsa për rastet e tjera të cilat nuk gjejnë argumentim, mangësitë gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, i cili i dërgohet subjektit për njohje dhe marrjen e masave për përmirësimin e gjendjes.

Mbështetur në punën audituese në teren (subjekt), në evidencat e marra, të cilat sipas mendimit tonë kanë qënë të përshtatshme, të mjaftueshme dhe të besueshme për punën audituese, në projekt raportin e auditimit, kundërshtitë e subjektit të audituar, qëndrimin e grupit të auditimit ndaj kundërshtive të subjektit, rezultatet kryesore të punës audituese përfshihen në këtë përmbledhje ekzekutive të Raportit Përfundimtar të Auditimit si më poshtë:



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

## Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”

## I.b. Përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve, sipas tabelës së mëposhtme:

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Referenca në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
Nr. 1.	<p>Nga puna e pa mjaftueshme e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Tepelenë, në fund të vitit 2019 janë krijuar debitorë për taksat dhe tarifa vendore në vlerën totale <b>12,618,921 lekë</b>. Kjo vlerë përbëhet nga detyrimi prej 11,263,917 lekë nga subjektet private (principal 9,410,242 lekë, kamatëvonesë 1,826,675 lekë), si dhe detyrimi prej 1,355,004 lekë nga 953 subjekte familjare, sipas rakordimit që njëzia vendore ka me “Ujësllësin Tepelenë” SHA. Vlera debitore e taksapaguesve privat është e ndarë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- për vitin 2017 vlera e debisë 2,739,025 lekë, nga e cila principali 2,212,959 lekë, kamat vonesa 526,066 lekë, numri subjekteve debitor 112, nga të cilat 16 subjekte biznesi i madh dhe 96 subjekte biznesi i vogël;</li> <li>- për vitin 2018 vlera e debisë 3,987,683, nga e cila principali 3,268,040 lekë, kamat vonesa 719,643 lekë, numri subjekteve debitor 143 nga të cilat 31 subjekte biznesi i madh dhe 112 subjekte biznesi i vogël;</li> <li>- për vitin 2019 vlera e debisë 4,537,209 lekë, nga e cila principali 3,722,074 lekë, kamat vonesa 815,135 lekë, numri subjekteve debitor 205, nga të cilat 32 subjekte biznesi i madh dhe 173 subjekte biznesi i vogël.</li> </ul> <p>Nga zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk janë ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme ligjore, për arkëtimin e debitorëve veprim në kundërshtim me nenin 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenet 91, të ligjit nr. 9920 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe nenin 12 të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore (<i>Më hollësisht trajtuar në pikën B2 faqe xx-xx të raportit të Auditimit</i>).</p>	25-43	E lartë	<p>Drejtoria ekonomike, zyra e taksave dhe tarifave vendore, <i>për të gjitha subjektet e private</i> për vlerën e detyrimit prej <b>11,263,917 lekë</b> të nxjerrë njoftim vlerësimet tatimore dhe në vazhdim të marren masat për arkëtimin e këtij detyrimi, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:</p> <p><b>a-</b> Tu dërgohen të gjitha bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.</p> <p><b>b-</b> Tu dërgohen Drejtorisë Rajonale të Transportit, si dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, kërkesat për vendosjen e barrës sigurose respektivisht për mjetet dhe për pasuritë e paluajtshme.</p> <p><b>c-</b> Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë, nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, bazuar në nenin 182, të ligjit të Kodit Penal në RSH i ndryshuar, pasi të vendosen masa administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal.</p> <p><b>d-</b> Për debitorët e kategorisë familjare bazuar në akt-marrëveshjen e lidhur me “U.” ShA, të kërkojë nga kjo e fundit në cilësinë e agjentit tatimor, të marrë masa për arkëtimin e detyrimit prej 1,355,004 lekë nga 953 subjekte familjare.</p>
Nr. 2.	<p>Nga drejtoria e planifikimit, zhvillimit dhe kontrollit të territorit dhe sektori i taksave dhe tarifave vendore, nuk është llogaritur saktë taksat e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja, nuk është kryer përlogaritja në</p>	25-43	E lartë	<p>Nga titullari i njësisë vendore, drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, zyra e taksave</p>



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”

	<p>bazë të çmimit referencë që është kosto mesatare e ndërtimit sipas Entit Kombëtar të Banesave, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e njësisë vendore në vlerën <b>7,429,682 lekë</b>. Kjo vlerë është detyrim nga tre pronarët e lejeve të ndërtimit si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- z. Xh. N. në vlerën 43,920 lekë, leje ndërtimi në vitin 2017;</li> <li>- z. R.T. në vlerën 782,818 lekë, leje ndërtimi në vitin 2018;</li> <li>- z. I. H. dhe B. H. në vlerën 6,603,574 lekë leje ndërtimi në vitin 2019.</li> </ul> <p>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, neni 46, Udhëzimin e KM nr.4, datë 30.9.2015 “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i banesave, për vitin 2015”, Udhëzimin KM nr.3, datë 28.12.2016, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i banesave, për vitin 2016”, VKB nr.2, datë 20.01.2017, nr.41, datë 21.12.2017 dhe nr.74, datë 28.12.2018 “Për miratimin e Paketës Fiskale të Bashkisë Tepelenë”</p>			<p>vendore, të merren të gjitha masat e duhura ligjore, për arkëtimin e detyrimit prej <b>7,429,682 lekë</b> nga pronarët e lejeve të ndërtimit si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- z. Xh. N. në vlerën 43,920 lekë;</li> <li>- z. R. T. në vlerën 782,818 lekë;</li> <li>- z. I. H. dhe B. H. në vlerën 6,603,574 lekë.</li> </ul>
Nr. 3.	<p>Nga dhënia me qira e asetëve të Bashkisë Tepelenë subjekteve private, të cilat janë pajisur me leje minerare për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore, për periudhën 01.01.2017 deri më 30.09.2019, u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Në një rast nuk është lidhur kontratë qiraje me subjektin “K.” SHPK me NIPT K.....W, pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror, me vendndodhje në fshatin Luzat, Tepelenë, me sipërfaqe 1 (një) ha, me pasojë mos llogaritjen dhe mos arkëtimin e detyrimit në vlerën 1,209,994 lekë, të ardhura të munguara për buxhetin e njësisë vendore.</li> <li>-Në një rast është lidhur kontratë qiraje me subjektin “C.” SHPK me NIPT K.....M, pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror, me vendndodhje në Bënçë, Tepelenë me sipërfaqe 3,3 ha, por nga detyrimi total që rrjedh nga kontrata e lidhur nuk është arkëtuar vlera 3,570,600 lekë, e ardhur e munguar për buxhetin e njësisë vendore.</li> <li>-Në një rast, është lidhur kontratë qiraje nr.53, datë 11.04.2011 me subjektin “I.” SHPK, me objekt dhënie në përdorim nga fondi Pyjor/kullor një sipërfaqe prej 2,253 ha, për ndërtimin e Hidrocentralit “B. i L.”, me vendndodhje në fshatin Mezhgoran”, por nga subjekti nuk është kryer pagesa e plotë e detyrimit në vlerën 185,873 lekë.</li> </ul> <p><b>Tre rastet e mësipërme i kanë shkaktuar buxhetit të njësisë vendore të ardhura të munguara në vlerën <b>4,966,467 lekë</b>.</b></p>	25-43	E lartë	<p>Nga titullari i njësisë vendore, drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, të merren të gjitha masat e duhura ligjore, për arkëtimin e detyrimit në vlerën <b>4,966,467 lekë</b>, përkatësisht nga subjektet “K.” SHPK në vlerën 1,209,994 lekë, “C.” SHPK në vlerën 3,570,600 lekë dhe nga “I.” SHPK në vlerën 185,873 lekë</p>



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”

	Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 391, datë 21.06.2006, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar, lidhja nr. 2, pikat 6 dhe 11.			
Nr. 4.	Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, në 4 raste nuk ka përllogaritur saktë dhe nuk ka arkëtuar tarifën për dhënien dhe rinovimin e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse (karburante), që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, me pasojë <b>të ardhura të munguara për buxhetin e njësisë vendore në vlerën 3,950,000 lekë</b> . Konkretisht janë subjektet: “K.” SHPK, “O.” SHPK “S.” SHPK, “K.” ShA. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar me VKM nr.344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 2.12.2015, të këshillit të ministrave, "për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", kapitulli II, pika 1; germa “b”; pika 9	25-43	E lartë	Nga titullari i njësisë vendore, drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, të merren të gjitha masat e duhura ligjore, për arkëtimin e detyrimit prej <b>3,950,000 lekë</b> për mos rinovimin e licencave nga subjektet e tregtimit të karburanteve si më poshtë: Subjekti “ K.” SHPK në vlerën 950,000 lekë, subjekti “O.” SHPK në vlerën 1,000,000 lekë, subjekti “S.” SHPK në vlerën 1,000,000 lekë, subjekti “K.” ShA, në vlerën 1,000,000 lekë.
Nr. 5.	Nga IMTV për periudhën janar 2017 deri më 30.09.2019 janë vendosur 4 masa administrative me gjobë në vlerën totale 1,900,000 lekë, nga të cilat janë arkëtuar 500,000 lekë, ndërsa vlera prej <b>1,400,000 lekë</b> është ende e pa arkëtuar, e cila përbën <b>të ardhura të munguara në buxhetin e njësisë vendore</b> . Gjobat e pa arkëtuara janë për z. R. S.me objekt rritje fiktive të çmimeve në vlerën 500,000 lekë, si dhe për subjektin “E. C. C.” SHPK, në vlerën 100,000 lekë, me objekt prishje e infrastrukturës, subjektin “K. K. ” SHPK në vlerën 800,000 lekë me objekt ndërtim pa leje. Afati ligjor i pagesë së gjobave (10 ditë) ka përfunduar, por nga njësia vendore nuk është bërë kërkesa në gjykatë për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit, me qëllim arkëtimin e gjobave,	25-43	E lartë	Nga titullari i njësisë vendore, drejtoria juridike dhe ekonomike të merren masa për arkëtimin e vlerës <b>1,400,000 lekë</b> , duke kërkuar pranë organeve përkatëse (përmbarim, gjykatë), kthimin e tre vendimeve për kundërvajtjen administrativenë titull ekzekutiv.
Nr.6	Bashkia Tepelenë nuk ka ngritur si duhet një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Nuk janë hartuar rregulla për ruajtjen e aktiveve, përfshirë këtu edhe mbrojtjen dhe ruajtjen e të dhënave elektronike (sistem rezervë back-up), rregulla për dorëzimin e detyrës në rastet e largimit të punonjësve nga puna,nuk është hartuar regjistri i rriskut, lista e proceseve të punës, gjurma e auditimit nga asnjë sektor dhe drejtori. Në fund të çdo viti vlerësimi i funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit nuk është bërë si	19-22	E lartë	Titullari i njësisë vendore, njësia e auditit të brendshëm dhe menaxherët kryesor të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësinë vendore. Të hartohen rregulla për ruajtjen e aktiveve, duke përfshirë edhe ruajtjen dhe sigurinë e



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”

	duhet nga menaxherët kryesor, duke mos përcaktuar pikat e dobëta të këtij sistemi e marrjen e masave për përmirësimin e tij. Nga stafi nuk njihet mjaftueshëm ligji 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe manuali përkatës në zbatim të këtij ligji. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe nenin 32, të ligjit nr. 68/2017” Për financat e vetëqeverisjes vendore”			informacionit elektronik, duke siguruar sisteme rezervë të IT (back-up). Të hartohet regjistri i rrishtit, gjurma e auditimit dhe lista e proceseve të punës për secilin sektor dhe në nivel institucioni.
Nr.7	<p>Bazuar në të dhënat e pasqyrave të buxhetit dhe të dhënave të pasqyruara në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2018, konstatohet se totali i faturave të pa likuiduara në fund të vitit 2018 në llog (401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to”, dhe detyrime të tjera në llog (467) “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën 54,927,944 lekë nga të cilat llogaria 401-408 Furnitor e llogari të lidhura me to, në vlerën 31,109,492 lekë dhe llogaria 467 kreditorë të ndryshëm, në vlerën 23,818,452 lekë), detyrim i Bashkisë Tepelenë ndaj subjekteve private.</p> <p>Vlera e faturave të palikujduara gjendje në 30.09.2019, të pasqyruara në llog 401-408 “Furnitor e llogari të lidhura me to”, dhe detyrime të tjera në llog 467 “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën <b>48,674,646 lekë</b>, ndaj subjekteve private, nga të cilat detyrime për Investime në vlerën 12,220,490 lekë, në 13 raste; detyrime për mallra e shërbime në vlerën 32,435,561 lekë, në 33 raste; detyrime për vendimet gjyqësore të cilat kanë marrë formën e prerë për vlerën 4,018,595 lekë, për 5 raste.</p> <p>Vlera 48,674,646 lekë është e trashëguar sips periudhave si më poshtë:</p> <p>Vlera 9,026,517 e mbartuar nga periudha para vitit 2017;</p> <p>Vlera 6,242,576 është e krijuar gjatë vitit 2017;</p> <p>Vlera 19,417,869 lekë është e krijuar gjatë vitit 2018;</p> <p>Vlera 13,987,684 lekë është krijuar gjatë vitit 2019.</p> <p>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH”, i ndryshuar, neni 40 “E drejta për të kryer shpenzime”; UMF nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr.5/1 datë 21.05.2014; Udhëzimin plotësues nr. 2 të MF, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”; UMF nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore”</p>	22-25	E lartë	Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, bazuar në Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” dhe Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 “Për buxhetin e vitit 2019”, pikat 106-110, “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” dhe pikat 116-117- <i>Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore</i> ”, të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave për vlerën 48,674,646 lekë, sipas aneksit bashkangjitur mbi gjendjen e faturave të palikujduara me datën 30.09.2019.
Nr.8	Në pasqyrat e pozicionit financiar, gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” në fund të vitit 2018, paraqitet në vlerën 10,516,840 lekë, e cila përfaqëson	43-53	E mesme	Të sistemohen këto llogari sipas rregullave kontabël dhe


**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

	<p>vlerat e 9 projekteve për objekte të cilat kanë përfunduar punimet dhe janë marrë në dorëzim nga njësia vendore, (sipas aneksit në fund të raportit) , vlerë e cila duhet të ishte sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar, si pjesë e kostos totale të objektit.</p> <p>Në pasqyrat e pozicionit financiar, gjendja e llogarisë 210 “Toka, troje, terrene” në vitin 2018 paraqitet në vlerën 7,778,488 lekë, e cila përbëhet nga vlera 250,910 lekë për parqe dhe lulishte, vlera 2,879,803 lekë për rehabilitim ambiente publike, vlera 3,279,917 lekë për sistemime të ambienteve publike dhe vlera 1,367,858 lekë për kënde lojërash për fëmijë. Në këtë llogari nuk është pasqyruar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-vlera e trojeve të ndërtesave të pasqyruar në llogarinë nr.212 “Ndërtime e konstruksione” si godina e bashkisë, ndërtesat si: shkolla e mesme, shkollat 9-vjeçare; ndërtesat e ish komunave sot njësi administrative, ndërtesat e shkollave në njësitë administrative, etj.</li> <li>-vlera e trojeve të cilat me VKM janë kaluar në pronësi të Bashkisë Tepelenë.</li> <li>-vlera e truallit të lirë.</li> </ul> <p>Në pasqyrat e pozicionit financiar, gjendja e llogarisë nr.211 “Pyje, kullota, plantacione” në fund të vitit 2018, paraqitet me një vlerë 96,200 lekë e pa ndryshuar, nga viti mëparshëm dhe paraqet vlerën e pemëve dekorative. Nga auditimi konstatohet se në këtë llogari nuk është pasqyruar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-vlera e pyjeve dhe kullotave të transferuara në pronësi të Bashkisë Tepelenë, sipas VKM nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 30, shtojca me nr.28, Lista e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Tepelenë, me numër rendor nga 1 deri 688.</li> <li>-nuk është kryer inventarizimi i Pyjeve dhe Kullotave me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit.</li> <li>-vlera e pyjeve dhe kullotave të cilat janë regjistruar në ZRPP, në pronësi të Bashkisë Tepelenë.</li> </ul>			<p>sipas pasurive reale që administrojnë njësia vendore.</p>
Nr.9	<p>Gjendja e llogarisë “Sigurime shoqërore dhe shëndetësore” më 31.12.2017 paraqitet në vlerën 8,981,573 lekë dhe në 31.12.2018 në vlerën 19,907,525 lekë, e cila përfaqëson detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të pa paguara. Gjatë vitit 2019 janë kryer pagesa dhe ky detyrim ka ardhur në ulje. Në datën 30.09.2019 vlera e këtij detyrimi është 9,815,896 lekë, ndërsa në datën 20.12.2019, bazuar në dokumentacionin e dërguar nga njësia vendore (urdhër shpenzimet) pas fazës së projekt raportit, ky detyrim ka shkuar në vlerën 7,063,544 lekë. Edhe pse janë marrë masa dhe është ulur konsiderueshëm ky detyrim,</p>	43-53	E lartë	<p>Titullari i njësisë vendore dhe Drejtorja e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, të marrin masa të menjëhershme pagesën e detyrimeve të prapambetura për sigurime shoqërore dhe shëndetësore në vlerën <b>7,063,544 lekë.</b></p>




**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

	anomalia e mos pagesës në kohë të sigurimeve shoqërore është materiale, si në kuptimin e materialitetit sasior edhe atij cilësor. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.9136, datë 11.9.2003 i ndryshuar “ Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, neni 6 - Detyrimet e personave që paguajnë kontributet, neni 11 - Afatet e deklarimit dhe te pagesës.			
Nr.10	Në 4 procedura prokurimi, një pjesë e kriterëve të veçanta të DST që lidhen me kapacitetin teknik, nuk janë të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, vlerën dhe natyrën e kontratës, si dhe nuk janë argumentuar. Në raste të veçanta nuk janë përcaktuar dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Procedura në të cilat janë konstatuar shkeljet e mësipërme janë:1) "Sistemim asfaltim rruga Pasarele – Dragot (loti I), me vlerë të fondit limit 46,796,083 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.09.2017; 2) "Rehabilitim kanali ujitës Gusmar”, me vlerë të fondit limit 16,906,652 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.11.2017; 3) “Rikonstruksion i kanalit ujitës në fshatrat Koder-Lekel” me vlerë të fondit limit 11,427,499 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.03.2017; 4) “Rikonstruksion i kanalit ujitës në fshatin Luzat” me vlerë të fondit limit 9,245,280 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.03.2017. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm: - neni 26- Kontratat për punë publike, pika nr.5; - nenin 61, pika nr.2	53-61	E lartë	Në hartimin e kriterëve të DST, njësia e prokurimit të jap argumente për secilin kriter dhe këto argumente të bëhen pjesë e procesverbalit që mbahet prej saj. Argumentimi të bëhet duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin, afatin e punimeve, etj

c. Konkluzioni dhe opinioni i auditimit.

**OPINIONI I AUDITIMIT**
**Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare.**

Opinionin e dhënë mbi besueshmërinë e llogarive vjetore e mbështesim në konstatimet se deklaratat e të ardhurave, shpenzimeve, banka, etj., janë përfshirë në deklaratat financiare. Janë marrë evidenca të mjaftueshme që të mund të japim një opinion. Deklaratat financiare janë paraqitur sipas ligjit të kontabilitetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

“Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, mbështetur në standardet ISSAI 1700 shprehim një **opinion të kualifikuar**<sup>1</sup> për llogaritë vjetore të

<sup>1</sup>Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar kur ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalië apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet e tjera financiare.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”

*Bashkisë Tepelenë dhe fushën e prokurimeve publike, duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura”.*

#### **Opinion i kualifikuar për prokurimet publike.**

Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Opinionin e dhënë mbi çështjet e fushës së prokurimeve publike e mbështesim në konstatimet se hartimi i kriterëve të dokumenteve standarde të tenderave (në katër raste), nuk është në përputhshmëri me kuadrin rregullator në fuqi, pasi disa kriterë nuk kanë lidhje me objektin dhe natyrën e kontratës. Këto gabime janë materiale. Gjithashtu anomalitë e konstatuara në fushën e zbatimit të kontratave të punimeve, për shkak të vlerës së vogël të tyre, nuk janë materiale. Përsa i përket shkallës së përputhshmërisë me kuadrin ligjor në fuqi, të veprimtarisë së komisionit të vlerësimit të ofertave, gabimet e kryera prej këtij komisioni nuk kanë ndikuar në kualifikimin apo s’kualifikimin e pa drejtë të operatorëve ekonomik. “*Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, mbështetur në standardet ISSAI 4100 shprehim një opinion të kualifikuar.*

#### **Baza për dhënien e opinionit**

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Bashkisë Tepelenë për vitin 2017 dhe 2018, vlerat e paraqitura në postet e formatit nr.1 -Pasqyra e pozicionit financiar (aktivet dhe pasivet), krahasuar me vlerat e paraqitura në informacionet që jepen në formatet anekse, formati nr.2 -Pasqyra e performancës financiare, (të ardhurat dhe shpenzimet), formati nr.3 -Pasqyra e flukseve monetare (cash floë), Formatit nr.4

-Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/Fondet neto, Formatit nr.5 -Shënime shpjeguese për hartimin e pasqyrave financiare vjetore, Formatit nr.6 -Pasqyra statistikore e investimeve dhe burimet e financimit, Formatit nr.7/a -Pasqyra gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike), Formatit nr.7/b -Pasqyra gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto), Formatit nr.8, Pasqyra statistikore e numrit të punonjësve dhe fondit të pagave.

Gjithashtu është audituar nëse hartimi i kriterëve të dokumenteve standarde të tenderave, vlerësimi i ofertave dhe zbatimi i kontratave të punimeve, janë në përputhshmëri me kriteret e fushës së prokurimeve publike dhe kriteret e kontratave të lidhura.

Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i auditimit ka marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej 2% (vlerën 8,153 mijë lekë për shpenzimet).

#### **Përshkrimi i çështjeve:**

- Vlera e faturave të pa likuiduara gjendje në 30.09.2019, ka vlerën 48,674,646 lekë, nga të cilat detyrime për investime në vlerën 12,220,490 lekë, në 13 raste; detyrime për mallra e shërbime në vlerën 32,435,561 lekë, në 33 raste; detyrime për vendimet gjyqësore të cilat kanë marrë formën e prerë për vlerën 4,018,595 lekë, për 5 raste.

-Në shpenzimet buxhetore ka diferenca midis treguesve të planifikimit dhe zbatimit të buxhetit, më e dukshme kjo në zërin e investimeve publike.

-Efekti real si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore për periudhën janar 2017 – shtator 2019 është 5,621,108 lekë, efekt negativ financiar për buxhetin e njësisë vendore.

- Gjendja e llogarisë “Sigurime shoqërore dhe shëndetësore” më 31.12.2017 paraqitet në vlerën 8,981,573 lekë dhe në 31.12.2018 në vlerën 19,907,525 lekë, e cila përfaqëson detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të pa paguara. Gjatë vitit 2019 janë kryer pagesa dhe ky detyrim ka ardhur në ulje. Në datën 30.09.2019 vlera e këtij detyrimi është 9,815,896 lekë, ndërsa në datën 20.12.2019, bazuar në dokumentacionin e dërguar nga njësia vendore (urdhër shpenzimet) pas fazës së projekt raportit, ky detyrim ka shkuar në vlerën 7,063,544 lekë. Edhe pse janë marrë masa dhe është ulur konsiderueshëm ky detyrim, anomalia e mos pagesës në kohë të sigurimeve shoqërore është materiale, si në kuptimin e materialitetit sasior edhe atij cilësor.


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

-Llogaria “Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa”, në 31.12.2019 ka vlerën 3,255,400 lekë dhe përfaqëson detyrime të pa shlyera të bashkisë ndaj buxhetit të shtetit për tatimin mbi pagë të personelit. Përveç kësaj kjo llogari nuk është analizuar sipas klasifikimit kontabël.

-Në llogarinë “Studime dhe kërkime”, nuk është sistemuar vlera prej 10,516,840 lekë që i përkasin 9 raste studime, kërkimeve dhe projektme për investimet e kryera në periudhën para vitit 2018, për objekte të përfunduara në vitet e kaluara, vlerë e cila duhet të ishte sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit.

-Llogaria “Toka, troje, terrene” dhe llogaria “Pyje, kullota, plantacione”, nuk paraqesin vlerën e saktë të pasurisë së njësisë vendore, për shkak të mos marrjes së masave për rregjistrimin në ZVRPP të pasurive ekzistuese dhe të atyre të cilat me VKM të posaçme kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Tepelenë.

- Në katër procedura prokurimi, një pjesë e kriterëve të veçanta të DST që lidhen me kapacitetin teknik, nuk janë të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, vlerën dhe natyrën e kontratës, si dhe nuk janë argumentuar.

**Përgjegjësitë e drejtuesve të njësisë vendore**

Drejtimi i njësisë vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshime dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi. Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme. Staf i drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e miratuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

**Përgjegjësitë e audituesve të KLSH mbi auditimin**

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojme bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar, si dhe nëse hartimi i kriterëve të DST, vlerësimi i ofertave dhe zbatimi i kontratave të punimeve janë në përputhshmëri me kriteret e fushës së prokurimeve publike dhe kriteret e kontratave të lidhura. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe fushave të tjera të auditimit dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”

## II. HYRJA

**-Titulli:** Ky Raport Auditimi përmbledh punën e bërë nga grupi i auditimit në teren në Bashkinë Tepelenë.

**-Marrësi:** Raport Auditimi i drejtohet Kryetarit të Bashkisë Tepelenë, Z. T. P., si dhe menaxherëve të tjerë të institucionit, për njohjen dhe vlerësimin e problemeve të konstatuara në këtë fazë të auditimit, në mënyrë që mbi bazën tyre të hartohen kundërshti nga subjekti nëse ka, e për të vazhduar më tej në fazën tjetër të auditimit.

**Objektivat dhe qëllimi:** Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e pasqyrave financiare janë:

-Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim si përkatësia, plotësia, saktësia, periudha, klasifikimi, ligjshmëria dhe rregullsia.

-Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës si; ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi.

-Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese si; transaksione, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, klasifikimi dhe kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi.

- Marrja e garancive nëse procedurat e prokurimit publik janë zhvilluar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi, mbi përputhshmërinë e zbatimit të kuadrit rregullator në fuqi në mbledhjen e të ardhurave dhe ekzekutimin e buxhetit.

**Oëllimi i auditimit** të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.

Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar.

Për fushat e prokurimeve dhe të të buxhetit qëllimi i auditimit është të kuptohet se deri në çfarë shkalle subjekti zbaton kuadrin rregullator në fuqi, zbulimi i shkallës së devijimeve nga standardet e pranura dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së parimeve të ligjshmërisë, efijencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit të menaxhimit financiar, me qëllim që për rastet individuale të identifikuar të detyrohen personat përgjegjës të mbajnë përgjegjësi, si dhe të merren masa për parandalimin e shkeljeve në të ardhmen

### Identifikimi i çështjes:

A. Kontrolli i brendshëm

B.1. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit.

B.2. Burimi i krijimit të të ardhurave dhe vlerësimi i mbledhjes së tyre, borxhi tatimor

C. Vlerësimi i Raportimit Financiar (Pasqyrat financiare për vitin 2017 dhe 2018).

D.1. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike.

D.2. Hartimi dhe zbatimi i kontratave të punimeve.

E. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme

### Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:

Titullarët e njësive publike, përgjigjen për vendosjen e përmblidhjes dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efijencë, sigurimin, nëpërmjet akteve të brendshme administrative, të zbatimit të rregullave për kontrollin e brendshëm.

*Nëpunësi autorizues* z. T. P., me detyrë Kryetar i Bashkisë Tepelenë dhe *Nëpunësi zbatues* z. S. K., me detyrë përgjegjëse finance, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”

e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Tepelenë.

Bazuar në pikën 6 të nenit 34, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”: “Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore”.

Sipas neni 91. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: pika 1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës:

a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;  
b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre;

ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.

Neni 65; “Administrata e njësisë administrative”, pika 1, “Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori”.

Strukturat drejtuese të Bashkisë Tepelenë, për problematikat e trajtuara lidhur me çështjet nën auditim për hartimin dhe zbatimin e buxhetit, mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, hartimin e pasqyrave financiare dhe inventarizimin e pasurisë; mbi prokurimet me fonde publike dhe zbatimin e kontratave, mbajnë përgjegjësi në lidhje me mangësitë, në shkelle të dispozitave ligjore të përcaktuara nga ligjet nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të akteve të tjera ligjore e nënligjore në aktivitetin financiar dhe përputhshmërisë. Problematikat dhe përgjegjësitë lidhur me to, të konstatuara gjatë procesit të auditimit, janë evidentuar në akt-konstatimet e mbajtura dhe në këtë Raport Auditimi.

#### **Përgjegjësitë e audituesve**

Përgjegjësia e audituesve të KLSH-së, është që nëpërmjet auditimit të mund të shprehë një opinionin mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e raportimit të pasqyrave financiare dhe Raportimit Financiar si dhe çështjet që lidhen me zbatimin e procedurave të prokurimit me fonde publike dhe mbi të ardhurat dhe shpenzimet.

Në këtë funksion, auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, sipas INTOSAI.

Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi.

Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe raportimit të shifrave në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi profesional i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesi vlerëson nivelin e kontrollit të brendshëm në entitet, në mënyrë që të programojë procedura auditimit që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit.

Gjatë kryerjes së auditimit, në mënyrë që të jepet një gjykim sa më profesional, objektiv dhe i pavarur, audituesit e grupit kanë zbatuar parimet e mëposhtme me karakter etik:

Parimin e integritetit

Parimin e pavarësisë



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”

Parimin e objektivitetit

Parimin e shmangies së konfliktit të interesit

Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë në lidhje me pasqyrat financiare, procedurat e prokurimit publik dhe buxhetin.

#### **Kriteret e vlerësimit.**

Kriter vlerësimi është i gjithë kuadri rregullator në fuqi (baza ligjore, aktet e brendshme të institucionit, kushtet e kontratës etj., me të cilat krahasohet aktiviteti i njësisë vendore që auditohet) dhe kryesisht:

Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2017 “Për vetëqeverisjen vendore”; ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” si dhe ligjet e udhëzimet vjetore të Ministrisë së Financave për buxhetin; ligji nr. 147/2015 “Për buxhetin e vitit 2016”; ligji nr. 130/2016, datë 17.12.2016 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2017”; ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar; UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Menaxhimi i aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar; etj.

-Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funkcionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.

#### **Standardet e auditimit**

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t.

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC.

Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe

Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Adituesve;

Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”, etj.

Manualet e Auditimit Financiar dhe Përputhshmërisë të miratuar nga Kontrollit i Lartë i Shtetit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH-së etj.

Gjatë zhvillimit të auditimit nga grupi u patën parasysh dhe u zbatuan:

-Qasjen e auditimit mbi bazë risku (rreziku), sipas së cilës të gjithë përpjekjet dhe burimet drejtohen në fushat dhe çështjet më të rëndësishme dhe ku vlerësimi i riskut është në nivelet më të larta;

-Përdorimin e gjykimit profesional duke u bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Manualin e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë.

Gjithashtu auditimi është kryer në zbatim të:

Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Rregullores së Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimit administrativ të KLSH-së”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30.06.2015;

-Rregullores “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së.

#### **Procedurat e auditimit.**

Përcaktimi i procedurave të auditimit nga grupi i auditimit u bë duke pasur parasysh parimet themelore të auditimit si më poshtë:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”

Procedurat e auditimit kanë për qëllim të sigurojnë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme cilat do të përbëjnë një bazë të arsyeshme për vlerësimet dhe përfundimet e auditimit (ISSAI 300, 3.5.1).

Audituesit përzgjedhin ato procedura auditimi të cilat sipas gjykimit të tyre profesional janë më të përshtatshme në varësi të rrethanave (ISSAI 300, 3.4.5)

Për arsye se në bazë të vlerësimi paraprak sistemi i kontrollit të brendshëm është përcaktuar jo në nivelin e duhur, grupi i auditimit u mbështetet më shumë në procedurat thelbësore dhe më pak në qasjen e mbështetur në sistemin e kontrollit të brendshëm. Siguria e auditimit është marrë nga procedurat thelbësore.

#### 1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

#### 2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

#### 3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

#### 4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

#### 5. Konfirmim nga të tretët.

Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduara) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepcave ose të çdo regjistrimi tjetër.

#### 6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsisive kontabile. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit (akt-konstatimet, akt-verifikimet dhe letrat e punës), i cili është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur konkluzionet e auditimit. Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Raporti i Auditimit.


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**
**III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

**Informacioni i përgjithshëm.** Bashkia Tepelenë ka nja popullsi rreth 16,500 banorë e si rezultat i reformës administrative-teritoriale përfshinë 3njësi administrative: Lopës, Kurvelesh dhe Qendër. Veprimtaria e njësisë vendore bazohet në një bazë të gjerë ligjore, por ligji bazë për të është ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” . Parimet themelore të vetë qeverisjes vendore janë: veprojnë në bazë të parimit të autonomisë vendore; respektojnë kushtetutën. Aktiviteti, të drejtat dhe detyrat e njësisë të VV shpjegohen në këtë ligj.

**Objekti i këtij auditimi:** “Auditimi financiar dhe përputhshmërisë.

**Qëllimi i auditimit:** Vlerësimi nëse aktivitetet dhe informacionet e raportuara në pasqyrat financiare, prokurimet publike, mbledhjen e të ardhurave, buxhetin, në çdo aspekt material, është në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet, dhënia e opinionit apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime.

**Fusha e veprimit:** Pasqyrat financiare, prokurimet publike, buxheti, të ardhurat për periudhën 01.01.2017 deri më datën 30.09.2019.

Në përputhje me objektin e auditimit, u auditua mbajtja e kontabilitetit, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullave të institucionit dhe parimeve për një qeverisje të mirë në përmbushje të objektivave të institucionit Bashkia Tepelenë dhe ligjit nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Në Bashkinë Tepelenë evidenca kontabël, mbahet në mënyrë manuale (Excel) dhe jo me programe të posaçme financiare.




**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**
**IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET (Përmbajtja e punës së kryer)**
**A1.Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe organizimi dhe funksionimi i njësisë së auditit të brendshëm**

U auditua funksionimi i pesë elementëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm: mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit, informimi dhe komunikimi, monitorimi. Në përfundim të auditimit arrihet në konkluzionin se edhe pse është hartuar rregullore e brendshme, nuk është hartuar një paketë e plotë rregullash të tjera të shkruara për të siguruar një funksionim të mirë të kontrollit të brendshëm. Mjedisi i kontrollit, si elementi bazë dhe kryesor i kontrollit të brendshëm, nuk është në nivelin e duhur, punonjësit kanë mangësi në njohjen e kërkesave të ligjit 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nuk janë hartuar programe për të siguruar ruajtjen dhe zhvillimin profesional të stafit. Nuk janë hartuar dokumente si regjistri i rrisikut, gjurma e auditimit, rregulla për ruajtjen e aktiveve, nuk ka sistem rezervë për ruajtjen e të dhënave të menaxhimit financiar IT (back-up) për njësinë. etj.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Mungesa e hartimit të një paketë e plotë rregullash të tjera të shkruara për të siguruar një funksionim të mirë të kontrollit të brendshëm. Mjedisi i kontrollit, si elementi bazë dhe kryesor i kontrollit të brendshëm.
<b>Situata:</b>	Në Bashkinë Tepelenë gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen pak. Nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, pavarësisht se këtë e realizon referuar kompetencave dhe akteve nënligjore në fuqi, duke reflektuar kështu nivel mesatar të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, rezultoi se: <u>Në lidhje me mjedisin e kontrollit.</u> Është hartuar Rregullorja e funksionimit të Njësisë, pjesë e së cilës është edhe kodi i etikës. Nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke mos hartuar dhe zhvilluar programe trajnimesh, nuk është realizuar vlerësimi vjetor i punonjësve që janë me statusin e nëpunësit civil. <u>Në lidhje me menaxhimin e riskut:</u> Nuk kanë çelur regjistrin e risqeve. Nuk ka asnjë procedurë për menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. <u>-Në lidhje me informacionin dhe komunikimin:</u> Në rregullore nuk është përfshirë mënyra e komunikimit brenda institucionit, por në fakt veprohej me komunikim verbal, nuk ka përgatitur rregullore për shërbimin IT, dhe nuk ka sistem rezervë për ruajtjen e të dhënave të menaxhimit financiar IT (back-up) për njësinë.
<b>Kriteri:</b>	Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.
<b>Ndikimi</b>	Mos identifikimi dhe menaxhimi i risqeve, mos trajnimi për rritjen profesionale të stafit si dhe mos perfeksionimi i sistemeve të IT për ofrimin e informacionit, ndikojnë në arritjen e objektivave të institucionit. Mosfunksionim i sistemit të kontrollit të brendshëm, sjell risk të lartë për institucionin.
<b>Shkaku:</b>	Mosnjohje e plotë e koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave. Mosnjohje nga niveli i lartë drejtues i kriterëve të MFK, me nivel mesatar të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë


**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

<b>Rekomandim</b>	<p>Nga Titullari i Bashkia Tepelenë, me atributet e Nëpunësit Autorizues, Kordinator i Riskut, të marrë masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, hartimin e regjistrit të riskut, dhe miratimin e gjurmëve të auditimit, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.</p>
-------------------	--

**A.2. Mbi vlerësimin e auditit të brendshëm.**

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	<p>Mungesa në plotësimin e strukturës organike për strukturën e njësisë së auditit të brendshëm, mos kryerje prej kësaj njësie të auditimeve në të gjitha fushat kryesore me rrisht të lartë.</p>
<b>Situata:</b>	<p>Në njësinë vendore Bashkia Tepelenë struktura e njësisë së auditimit të brendshëm është miratuar me tre punonjës, por kjo strukturë është e pa plotësuar, pasi aktualisht kryen detyrën e audituesit të brendshëm vetëm një punonjës. Mos plotësimi i strukturës është në kundërshtim me kërkesat e pikës 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se kjo njësi përbëhet nga jo më pak se tre punonjës.</p> <p>Nga auditimi u konstatua se njësia e auditit të brendshëm nuk ka kryer auditime në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me rrisht të lartë, të tilla si prokurimet publike, ngritja, implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm dhe efektiviteti i këtij sistemi, inspektorati i mbrojtjes së teritorit, asetet. Gjithashtu nga kjo njësi, në auditimin e kryer prej saj, nuk është bërë ndjekja e rekomandimeve pas 6- muajsh, sipas afatit të përcaktuar në manualin e auditimit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e nenit nr.5 dhe nr.6 të ligjit 114/2015, datë 22.10.2015 “ Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.</p> <p>Për vitin 2017 janë planifikuar 4 (katër) auditime dhe si rrjedhojë janë kryer 4 angazhime respektivisht: 1. Agjencia Mirëqenies dhe Kujdesit Social, 2. Saktësimi i Pagave të këshilltareve sipas Nj. Administrative, 3. Drejtoria e shërbimeve publike 4. Sektori i zhvillimit ekonomik i tatim taksave. Nga njësia e auditimit të brendshëm për vitin 2017 janë rekomanduar gjithsej 16 masa organizative dhe 4 masa shpërbllim dëmi në vlerën 12,262,273 lekë, nga të cilat 2 masa në vlerën 7,309,265 lekë janë pagesat e 71 këshilltareve për periudhën 2012-2016, shuma prej 4,801,608 lekë janë detyrimet e prapambetura nga debitorët e tatim taksave dhe shuma prej 151,400 lekë është detyrimi i dy ish punonjësve të ndihmës ekonomike, z. A. D. dhe znj. L. D..</p> <p>- Për vitin 2018 janë planifikuar 4 (katër) auditime dhe si rrjedhojë është kryer 1 angazhime respektivisht: 1. Agjencia e Shërbimeve Bujqësore Veterinare, Mjedisore. Nga njësia e auditimit të brendshëm për vitin 2018 janë rekomanduar gjithsej 6 masa organizative.</p> <p>- Për vitin 2019 deri më 30.09.2019 janë planifikuar 4 (katër) auditime dhe si rrjedhojë është realizuar 1 angazhime në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe</p>


**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

	<p>Menaxhimit Financiar dhe 2 auditime në proces respektivisht: 1. Agjencia e Inspektimit të Territorit dhe 2. Drejtorja e Arsimit Kulturës, Sporteve dhe Arteve. Nga njëësia e auditimit të brendshëm për vitin 2019 janë rekomanduar gjithsej 3 masa organizative. Konstatohet se nga njëësia e auditimit nuk është realizuar plani strategjik, plani vjetor i punës, sipas kërkesave të nenit 14, të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “ Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. Audituesit e brendshëm në punën e tyre pavarësisht dhënies se rekomandimeve nuk janë treguar këmbëngulës në auditimin e zbatimit të rekomandimeve, në 25 masa organizative të rekomanduara dhe 4 masa shpërblim dëmi në vlerën 12,360 mijë lekë raste nuk është bere ndjekja e rekomandimeve sipas afatit të përcaktuar në manualin e auditimit pas 6- muajsh. konformë ligjit 114/2015, datë 22.10.2015 “ Për auditimin e brendshëm në sektorin Publik”(Sipas tabelës Nr. x bashkëlidhur Raportit)</p> <p><b>Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:</b></p> <p>-Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”,</p> <p>-VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”,</p> <p>-Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016 “Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” me emërtesën “Njësia e Auditimit të Brendshëm”,</p> <p>-UMF nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm një njësitë publike”, të Bashkisë Tepelenë</p> <p><b>Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:</b></p> <p><b>Znj. A. S.</b> me detyrë, Përgjegjëse e auditit të brendshëm, <b>Z. F. K.</b> me detyrë, auditues i brendshëm.</p>
<b>Kriteri:</b>	Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”. VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”. Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016 “Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”. UMF nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm një njësitë publike”, të Bashkisë .
<b>Ndikimi</b>	Nuk jep siguri të mjaftueshme për objektivat e përcaktuara nga Institucioni.
<b>Shkaku:</b>	Nga neglizhenca dhe nga mos këmbëngulja në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna si nga auditimi i ushtruar nga KLSH ashtu dhe në rekomandimet e Auditimit të Brendshëm.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandim</b>	Nga njëësia e auditimit të brendshëm të merren masa për planifikimin në programet e auditimit të fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me rrisht të lart, duke i dhenë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave. Të ndiqet zbatimi brenda afateve të caktuara, i rekomandimeve të dhëna nga KLSH si dhe zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga vetë njëësia e auditit të brendshëm.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”

#### **B.1. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit**

Për çdo procedure prokurimi, urdhri është regjistruar në kohë dhe kanë vulën dhe datën e depozitimit të tyre në Degën e Thesarit Tepelenë. Nuk u konstatua asnjë rast mos regjistrimi të urdhrimit të prokurimit në Degën e Thesarit.

Kontratat janë regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në Degën e Thesarit Tepelenë dhe të shtrira në kohë sipas fiancimit. Në të gjitha rastet e regjistrimit të kontratave fondet kanë qenë disponibël. Nuk janë regjistruar kontrata të copëtuara me qëllim pagesën e saj dhe në rastet kur fondi nga Ministria ka ardhur i ndarë në afate mujore kontrata është regjistruar e plotë ndërsa pagesa është kryer sipas limitit mujor.

Për çdo rast të depozitimit të kontratave në thesar është hartuar shkresë përcjellëse ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit, kur është e shtrirë në disa vite, vlera për secilin vit.

Janë depozituar për regjistrim në Degën e Thesarit Tepelenë, brenda afatit 30-ditor të gjitha urdhër shpenzimet, duke përjashtuar rastet kur ka pasur limit të vendosur nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë me shkresën nr. 15973, datë 09.11.2017.

<b>Titulli i Gjetjes</b>	-Programimi, aprovimi, monitorimi dhe realizimi i treguesve të buxhetit. Diferenca midis vlerave të programimit dhe vlerave të realizimit të treguesve të buxhetit.
<b>Situata:</b>	- <i>Për vitin 2017</i> buxheti është realizuar në masën 80,9% ose nga 637,570 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 515,970 mijë lekë, <i>për vitin 2018</i> është realizuar në masën 94,9% ose nga 410,952 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 389,998 mijë lekë, ndërsa për periudhën janar-shtator është realizuar në masën 72% ose nga 319,323 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 228,915 mijë lekë <i>Në zërin investime, buxheti për vitin 2017</i> është realizuar në masën 68% ose nga 361,883 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 245,810 mijë lekë, <i>nga të cilat financim me të ardhurat e veta në vlerën 16,177 mijë lekë ose 6,5%, për vitin 2018</i> është realizuar në masën 89,8% ose nga 129,982 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 116,777 mijë lekë, <i>nga të cilat financim me të ardhurat e veta në vlerën 13,221 mijë lekë ose 11,3%</i> , ndërsa për periudhën <u>janar-shtator 2019</u> është realizuar në masën 31% ose nga 48,794 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 15,166 mijë lekë, <i>nga të cilat financim me të ardhurat e veta në vlerën 5,261 mijë lekë ose 34,6%</i> . Ka diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit. Planifikimi i zërave të shpenzimeve dhe investimeve dhe mos realizimi i tyre për shkak të mos realizimit të të ardhurave, sjellin mos plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës së njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve. Peshën më të madhe të mosrealizimit e zënë investimet në periudhën janar-shtator 2019 të cilat janë realizuar në masën 31% ku ndër të tjera shkak i mosrealizimit është edhe vonesa në kryerjen e procedurave të prokurimit.
<b>Kriteri</b>	-Veprime në mospërputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “ <i>Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë</i> ”, neni 42; 43; 47; 50; 65; UMF nr.2, datë 06.02.2012 “ <i>Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit</i> ”, pikat 253; 354 i ndryshuar me Udhëzimin plotësues nr.2, datë 10.01.2018 “ <i>Për buxhetin e vitit 2018</i> ”, pikat 82-91 “ <i>Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore</i> ” dhe UMF nr.5, datë 27.12.2014 “ <i>Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura</i> ”.


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

<i>Ndikimi</i>	-Përformancë jo e mirënë lidhje me nivelin e realizimit të treguesve të buxhetit, e cila ka sjellë edhe mos arritjen e objektivave për sa i përket investimeve publike. Krijohen pritshmëri jo reale për komunitetin lidhur me investimet publike, të cilat planifikohen të realizohen në një periudhë të caktuar kohore, por në fakt për planifikime jo objektive këto investime shtyhen në kohë.
<i>Shkaku</i>	Planifikim jo i saktë i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, duke mos u mbuluar me fonde reale investimet e planifikuara. Vonesa në realizimin e prokurimeve publike gjatë vitit 2019. -Akumulimi i detyrimeve të pa likuajuara për mallra, shërbime dhe vendime gjyqate, në shuma të konsiderueshme në fund të periudhës 31.12.2017 është vlera 81,982,381lekë, në fund të periudhës 31.12.2018 është vlera 54,927,944lekë dhe në 30.09.2019 vlera 48,674,646 lekë, duke ndikuar që niveli i detyrimeve të jetë në nivel të lartë, pavarësisht shlyerjes të detyrimeve të trshëguara përpara viti 2017. - Akumulimi i detyrimeve të pa likuajuara për tatime e taksa kryesisht për tatimin mbi pagaë, në vlerën 3,255,400 lekë dhe detyrimeve të pa likuajuara për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, në vlerën 7,233,263 lekë, gjëndje në fund të periudhës 31.12.2018 të cilat janë gjëndje dhe më 30.09.2019, duke ndikuar që niveli i detyrimeve të jetë në nivel të lartë, pavarësisht shlyerjes të detyrimeve të trshëguara përpara viti 2017.
<i>Rëndësia</i>	-E lartë
<i>Rekomandimi</i>	-Me qëllim të mos krijohen diferenca të theksuara ndërmjet programimit dhe realizimit të treguesve të buxhetit, njësia publike Bashkia Tepelenë të marr masa për hartimin sa më real të treguesve të buxhetimit, mbështetur në realizimin e mundshëm e objektiv të të ardhurave dhe brenda afateve ligjorë, në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit.

*Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore.*

<b>Titulli gjetjes</b>	-Faturat e pa likuiduara
<b>Situata:</b>	- Bazuar në të dhënat e Buxhetit dhe të dhënave të pasqyruara në Pasqyrat Financiare të vitit ushtrimor 2018, konstatohet se totali i faturave të palikuiduara në fund të vitit 2018 në Llog (401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to”, dhe detyrime të tjera në llog (467) “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën 54,927,944 <b>lekë</b> ( nga të cilat llogaria 401-408 Furnitor e llogari të lidhura me to, në vlerën 31,109,492 lekë dhe llogaria 467 kreditorë të ndryshëm, në vlerën 23,818,452 lekë), detyrim i Bashkisë Tepelenë ndaj subjekteve private. Ndërsa vlera faturave të palikujduara gjendje në 30.09.2019, të pasqyruara në llog 401-408 “Furnitor e llogari të lidhura me to”, dhe detyrime të tjera në llog 467 “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën <b>48,674,646 lekë</b> , ndaj subjekteve private, nga të cilat detyrime për investime në vlerën 12,220,490 lekë, në 13 raste; detyrime për mallra e shërbime në vlerën 32,435,561 lekë, në 33 raste; detyrime për vendimet e gjykatave të cilat kanë marrë formën e prerë për vlerën 4,018,595 lekë, për 5 raste. Veprimet apo mos veprimet janë në kundërshtim me: -Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne R.SH”, ndryshuar me ligjin nr. 114/2012, datë 07.12.2012 dhe ligjin nr.57/2016, datë 02.06.2016, neni 40 “E drejta për të kryer shpenzime”; -Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr.5/1 datë 21.05.2014;



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”

	-Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 2, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”; -Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”
<b>Kriteri</b>	-Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH”, i ndryshuar. -VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kap. I, pika 1. -Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar. -Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, -Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”.
<b>Ndikimi/Efekt</b>	-Mos realizim i treguesve të zbatimit të buxhetit, ku për vitin 2017, 2018 dhe 9 mujori vitit 2019, janë realizuar respektivisht në masën 80,9% , 94,9% dhe 72%.
<b>Shkaku</b>	- Mos zbatimi i kërkesave ligjore.
<b>Rëndësia:</b>	-E lartë.
<b>Rekomandimi</b>	-Të merren masa nga Bashkia, që të zbatohen procedurat ligjore për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, në vlerën <b>48,674,646 lekë</b> .

Faturat e pa likuiduara për blerje mallra e shërbime të klasifikuara në llogarinë buxhetore 602 “Shpenzime operative” dhe gjendja e faturave të pa likuiduara në llogarinë 401 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” dhe në llogarinë 467 “kreditorë të ndryshëm” si gjendje në fund të vitit 2018 paraqiten në aneks të veçantë bashkangjitur.

-Bashkia Tepelenë ka administruar 9 detyrime për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (vendime të mbartura dhe gjatë periudhës së auditimit) në vlerën 6,270,288lekë, efekt negativ në buxhetin e njësisë vendore, nga të cilat, tre raste për largime të pa drejta nga puna në vlerën 2,520,968 lekë, katër raste për “detyrim kontrate” në vlerën 2,572,314 lekë, janë shtuar gjatë periudhës vlera 3,369,415 lekë, janë zbatuar (likuiduar) në vlerën 5,621,108 lekë, përkatësisht në vitin 2017 vlera 2,173,493, lekë, në vitin 2018 vlera 2,977,615 lekë dhe në vitin 2019 vlera 470,000 lekë, mbetur për likuidim të mëtejshëm në buxhetin e vitit 2019, e në vijim vlera 4,018,595 lekë. Përpara zbatimit të vendimit gjyqësor, nga titullari nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative dhe nuk është nxjerrë akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi, në kundërshtim me kërkesat e pikës 62 të udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Pasqyra e detyrimeve të pa likuiduara sipas financimit buxhetor gjëndje 31.12.2018.

Kategoritë							Vendime gjyqësore	Investimenga FZHR	Totali detyrimeve më 31.12.2018
Investime			Mallra dhe shërbime						
Pjesa që i përket Grandit Qeveritar	Pjesa që i përket të ardhurave	Detyrimi total për investimet	Pjesa që i përket Grandit Qeveritar	Pjesa që i përket të ardhurave	Detyrimi total për mallra				
3,964,584	14,996,097	18,960,681	0	32,915,468		3,051,795	0	<b>54,927,944</b>	

Pasqyra e detyrimeve të pa likuiduara sipas financimit buxhetor gjëndje 30.09.2019.

Kategoritë						
Investime	Mallra dhe shërbime			Vendime gjyqësore	Investime nga FZHR	Totali detyrimeve më 30.09.2019


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

Pjesa që i përket Grandit Qeveritar	Pjesa që i përket të ardhurave	Detyrimi total për investimet	Pjesa që i përket Grandit Qeveritar	Pjesa që i përket të ardhurave	Detyrimi total për mallra	Detyrimi total		
3,964,584	8,255,906	12,220,490	0	32,435,561	32,435,561	4,018,595	0	<b>48,674,646</b>

-Sipas të dhënave të pasqyruara në Pasqyrat Financiare të vitit ushtrimor 2018, konstatohet se totali i faturave të pa likuiduara në fund të vitit 2018 në Llog (401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to”, dhe detyrime të tjera në llog (467) “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën 54,927,944 lekë ( nga të cilat llogaria 401-408 Furnitor e llogari të lidhura me to, në vlerën 31,109,492 lekë dhe llogaria 467 kreditorë të ndryshëm, në vlerën 23,818,452 lekë), detyrim i Bashkisë Tepelenë ndaj subjekteve private.

Ndërsa vlera faturave të pa likuiduara gjendje në 30.09.2019, të pasqyruara në llog 401-408 “Furnitor e llogari të lidhura me to”, dhe detyrime të tjera në llog 467 “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën **48,674,646 lekë**, ndaj subjekteve private, nga të cilat detyrime për Investime në vlerën 12,220,490 lekë, në 13 raste; detyrime për mallra e shërbime në vlerën 32,435,561 lekë, në 33 raste; detyrime për vendimet e gjykatave të cilat kanë marrë formën e prerë për vlerën 4,018,595 lekë, për 5 raste.

Faturat e pa likuiduara janë raportuar çdo tre-mujor në Ministrinë e Financave. Për vitin 2017 shumë fatura nuk janë likuiduar në afat për arsye të limit të vendosur nga Ministria e Financave në Degën e Thesarit. Në total sipas zërave faturat e pa likuiduara paraqiten në mënyrë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme e konkretisht për faturat e pa likuiduara për Investimet e kryera, për faturat e pa likuiduara për vendimet e gjykatave dhe për faturat e pa likuiduara për blerje mallra e shërbime të klasifikuara në llogarinë buxhetore 602 “Shpenzime operative” dhe gjendja e faturave të pa likuiduara në llogarinë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” dhe llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Ndikimi në shkurtimet e buxhetit apo bllokimi nga MFE në fund të vitit në krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Limiti i vendosur nga MFE, ka ndikuar në krijimin e faturave të prapambetura pasi ka pasur fonde për likuidim dhe faturat kanë mbetur pa likuiduar duke shtuar vlerën e detyrimeve të paraqitura në bilanc ku për vitin 2017, vlera totale e detyrimeve është 81,982,893 lekë, përfshirë dhe faturat e muajit dhjetor 2017 dhe në vitin 2018 në vlerën 54,927,944lekë. Janë likuiduar faturat të lindura për arsye limit me vlerë 7,043,581 lekë ndërsa nga detyrimet e trashëguara nga vitet e mëparshme në vitin 2017 janë vetëm detyrimet për Vendime Gjykate në vlerën 2,173,493 lekë. Në vitin 2018 janë likuiduar detyrime të prapambetura në shumën 44,223,505 lekë nga të cilat vendime gjyqësore vlera 2,977,615 lekë.

Në vitin 2018 janë 19 fatura që mbajnë data të fundvitit 2017, ndërsa në vitin 2019 fatura që datojnë në fund të vitit 2018 janë 28, të cilat nuk janë likuiduar për arsye limit si dhe faturat e muajit dhjetor që likuidohen në janar të vitit pasardhës, si ujë, energji, postë etj.

Nga ana e Bashkisë Tepelenë të gjitha faturat janë regjistruar si detyrime të prapambetura në sistemin e Thesarit. Duhet theksuar fakti se detyrimet që përbëhet nga këto fatura është në vlerën 81,982,893 lekë për vitin 2017, që janë likuiduar në vitin 2018 ndërsa vlera 54,927,944 lekë në vitin 2019 për llogari të vitit 2018.

Nuk ka patur raste të mos regjistrimit në kohë të dokumentacionit nga zyra e financës, është bërë kontrolli dhe pastaj pagesa në Degën e Thesarit Tepelenë, përjashtim bëjnë raste pas vendosjes së limitit të shpenzimeve në muajt nëntor, dhjetor 2017-2018. Nuk janë likuiduar shumica e faturave kapitale dhe të tjera në fund të vitit ushtrimorë, por sipas procedurave të realizimit të punëve apo


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

shërbimeve. Muajt nëntor-dhjetor janë thujse të njëjtë me muajt e tjerë të vitit sa i përket faturimeve të ndryshme.

Sa i përket raportimit të shpenzimeve të ndodhura të papaguara paraqiten në vlerën 81,982,893 lekë për vitin 2017 që duhet të likuidohet gjatë vitit 2018, vlera **54,927,944lekë** në vitin 2019 për llogari të vitit 2018. ndërsa vlera **48,674,646 lekë** në vitin 2019 për llogari të vitit 2019 dhe të vitit 2020. Në këto fatura janë detyrimet e fundvitit, detyrimet për Vendime Gjykatë si dhe detyrimet për arsye limiti nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë. Stoku i detyrimeve të Bashkisë Tepelenë është raportuar i saktë dhe sipas klasave të Buxhetit për të gjitha detyrimet e prapambetura, të cilat janë pasqyruar në aktiv të bilancit në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe sipas llogarive 231 dhe 602. Në vitin 2019 për llogari të detyrimeve të viteve të kaluar janë likuiduar vlera 18,716,922 lekë nga të cilat vendime gjyqësore në shumën 470,000 lekë.

*Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;* Bashkia Tepelenë nuk ka asnjë investim në proces me FZHR të gjitha investimet e zhvilluara janë përfunduar dhe marrë në dorëzim.

<b>Titulli Gjetjes</b>	- Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.
<b>Situata:</b>	- Bashkia Tepelenë për periudhën objekt auditimi ka administruar për zbatim 7 detyrime për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (vendime të mbartura dhe gjatë periudhës së auditimit) në vlerën 6,270,288lekë, efekt negativ në buxhetin e njësisë vendore, nga të cilat, tre raste për “Dëmshtëpërbim për largim të padrejtë nga puna”, në vlerën 2,520,968 lekë, katër raste për “detyrim kontrate” në vlerën 2,572,314 lekë, janë shtuar gjatë periudhës vlera 3,369,415 lekë, janë zbatuar (likuiduar) në vlerën 5,621,108 lekë, përkatësisht në vitin 2017 vlera 2,173,493, lekë, në vitin 2018 vlera 2,977,615 lekë dhe në vitin 2019 vlera 470,000 lekë, pra efekti real si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore për periudhën janar 2017 – shtator 2019 është <b>5,621,108 lekë, efekt negativ financiar për buxhetin e njësisë vendore.</b> Mbeten për likuidim të mëtejshëm në buxhetin e vitit 2019, e në vijim vlera 4,018,595 lekë, zbatimi i vendimeve të mësipërme do të rëndoj shpenzimet e viteve në vazhdim, pasi njësisia vendore për shkak të buxhetit të vogël nuk ka mundësi likuidimi brenda një periudhe ushtrimore. Për këtë arsye janë hartuar akt-marrëveshje për pagesën me këste. Përpara zbatimit të vendimeve gjyqësore nga titullari nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative dhe nuk është nxjerrë akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi, në kundërshtim me pikën 62 të UMF nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”
<b>Kriteri</b>	-UMF nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pikën 62.
<b>Ndikimi/Efekti</b>	-Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve.
<b>Shkaku</b>	-Mos zbatimi i kërkesave ligjore.
<b>Rëndësia:</b>	-E lartë.
<b>Rekomandimi</b>	-Titullar i njësisë vendore të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore, të nxjerr arsyet dhe përgjegjësitë për efektin negativ që këto vendime kanë dhënë në buxhetin e njësisë vendore, ndërsa sektori juridik të ndjek proceset në të gjitha shkallët e gjyqimit, duke bërë edhe rekurs. Në rastet e largimeve të punonjësve nga puna, nga sektori juridik dhe titullari të zbatohen të gjitha procedurat e nevojshme të afateve të njoftimit dhe të pagesave të duhura, me qëllim që të ulen rrisqet e humbjes së proceseve gjyqësore. Përpara zbatimit të vendimit gjyqësor Titullari të nxjerr përgjegjësitë administrative, si dhe aktin që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi




**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:*

**Z.S. K.** me detyrë Drejtor i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar

**Znj.K. S.** me detyrë specialiste financës e ngarkuar për buxhetin.

(Sa më sipër është mbajtur akt konstatimi nr.4, datë 15.11.2019)

**B.2.Burimi i krijimit të të ardhurave dhe vlerësimi i mbledhjes së tyre**
**a. Parashikimi, realizimi i taksave vendore sipas llojeve**

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Punë e pa mjaftueshme e sektorit të taksave dhe tarifave vendore për parashikimin dhe arkëtimin e taksave nga biznesi dhe taksapaguesit familjar
<b>Situata:</b>	<p><u>Për vitin 2017</u>, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore nga <b>37,339 mijë</b> lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën <b>39,235 mijë</b> lekë ose <b>105 %</b>, me një tejkalim në vlerën <b>1,896</b> mijë lekë. Pavarësisht se në vlerën totale të ardhurat janë me tejkalim, por duke i analizuar sipas zërave, rezulton me mosrealizim.</p> <p>Për këtë vit nuk janë realizuar 12 lloje taksash dhe tarifash vendore në vlerën <b>8,061 mijë</b> lekë. Përqindjen më të madhe e zë taksat e pasurisë, ndërtesa, me 73% e cila ka ardhur për arsye të mos pagesës të kësaj tarife, zëri “Tarifa për lënd drusore” me realizim 15%, e cila ka ardhur në mosrealizimin e vjeljes së tarifave nga personat që kanë shfrytëzuar lëndën, taksat e truallit me një realizim prej 80%, kjo ka ardhur për arsye të mospagesës së debitorëve, taksat e bujqësorisë me një realizim prej 57%, e cila ka ardhur si pasojë e mungesës së listave në format elektronik, etj.</p> <p><u>Për vitin 2018</u>, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore nga <b>47,095 mijë</b> lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën <b>40,617</b> lekë ose <b>86.2 %</b> me një mosrealizim në vlerën <b>6,478 mijë</b> lekë</p> <p>Për këtë vit nuk janë realizuar 11 lloje taksash dhe tarifash vendore në vlerën <b>12,169 mijë</b> lekë. Përqindjen më të madhe e zë taksat e pasurisë, ndërtesa, me 52% e cila ka ardhur për arsye të mospagesës të kësaj tarife, zëri “Tarifa për lënd drusore” me realizim 13%, e cila ka ardhur në mosrealizimin e vjeljes së tarifave nga personat që kanë shfrytëzuar lëndën, zëri “taksat e truallit” me një realizim prej 77%, kjo ka ardhur për arsye të mospagesës së debitorëve, taksat e bujqësorisë me një realizim prej 42%, e cila ka ardhur si pasojë e mungesës së listave në format elektronik, etj.</p> <p><u>Për vitin 2019</u>, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore nga <b>31,277 mijë</b> lekë të parashikuara, në 9-mujorin e parë janë realizuar në vlerën <b>26,557 mijë</b> lekë ose <b>85 %</b>, me një diferencë të përafërt në vlerën <b>4,719 mijë</b> lekë.</p> <p>Për këtë vit nuk janë realizuar 7 lloje taksash dhe tarifash vendore në vlerën <b>12,169 mijë</b> lekë. Përqindjen më të madhe e zë taksat e pasurisë, ndërtesa, me 28% e cila ka ardhur për arsye të mospagesës të kësaj tarife, zëri “Tarifa për lënd drusore” me realizim 9%, e cila ka ardhur në mosrealizimin e vjeljes së tarifave nga personat që kanë shfrytëzuar lëndën, zëri “taksat e kulloteve” me një realizim prej 34%, kjo ka ardhur për arsye të mospagesës së debitorëve, taksat e bujqësorisë me një realizim prej 18%, e cila ka ardhur si pasojë e mungesës së listave në format elektronik, etj.</p> <p><i>Sa më sipër arrihet në konkluzionin se:</i></p> <p>-Disa taksat e tarifave në bashkinë Tepelenë duke i krahasuar me planifikimin kanë tejkalime të ndjeshme, kjo tregon se planifikimi i të ardhurave të Bashkisë për periudhën objekt auditimi nuk është bërë i studiuar, pasi ka patur rezerva për rritjen e</p>


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

planit të këtyre taksave e tarifave, dhe për disa nga taksat e tarifave vendore rezultojnë me mosrealizime, kjo tregon se nuk është analizuar e mbajtur parasysh realizimi i një viti më përpara dhe të eksperiencës së krijuar ndër vite për të gjithë treguesit.

-Realizimi i treguesve të planit nuk tregon se puna në këtë njësi është e mirorganizuar, kjo pasi planifikimi i të ardhurave nuk është bërë sipas nevojave dhe mundësive që ka kjo njësi, duke mos planifikuar saktë detyrimet për disa lloj taksash, konkretisht: Në vitin 2017 nga taksa e dhe tarifave vendore ka mos planifikim në vlerën totale prej 1,339 mijë lekë, për zërat “Shërbime.legalizime+private.banesë”, “Të ardhurat nga sponsorizimet”, “të ardhura nga shërbimi i MZSH-së”, “Kamata” dhe “Taksa e kalimit të pronësisë”. Në vitin Në vitin 2018 nga taksa e dhe tarifave vendore ka mos planifikim në vlerën totale prej 7,825 mijë lekë, për zërat “Të tjera”, “të ardhura nga shërbimi i MZSH-së”, dhe “Kamata”.

-Për 9-mujorin të vitit 2019, nuk janë planifikuar bërë ndryshime në planifikimin e zërave dhe për vetë faktin se nuk është mbyllur viti ushtrimor. (Sipas Aneksit nr. 2 mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave bashkëlidhur raportit)

Sipas rakordimit me QKL rezultoi se numri i bizneseve në total është në rrenie, si dhe nuk janë evidentuar regjistrime të reja për periudhën objekt auditimi, bizneset që kanë mbyllur aktivitetin në total janë 254, biznese të cilat kanë pezulluar aktivitetin në total janë 168 dhe gjendja deri më 30.09.2019 është në total 619. Nga rakordimi me zyrën e QKL rezultoi se: Nr. total i subjekteve të cilat janë të pajisura me certifikatë në QKL është përkatësisht 155 subjekte juridike dhe 464 subjekte fizike, ndërsa Nr. total i subjekteve të regjistruara në Bashki është 87 subjekte juridike dhe 325 subjekte fizike duke krijuar një diferencë respektivisht: 68 subjekte juridike dhe 139 subjekte fizike. Nga të dhënat e vëna në dispozicion konstatohet se në Bashkinë Tepelenë në vitin 2017 kanë zhvilluar aktivitet 16 subjekte pa u regjistruar në QKL (pa NIPT) dhe në vitin 2019 numri i këtyre subjekteve ka qenë 32 (të mbartura nga 2017+subjekte të reja gjatë 2018-2019) si rezultat i mosregjistrimit në QKL këto subjekte janë lejuar të ushtrorjnë veprimtarinë dhe nuk kanë paguar detyrimet në vlerën totale **5,235,264 lekë çka përbën të ardhur të munguara për fondin e sigurimeve shoqërore.** (Sipas Aneksit nr 2.1 bashkëlidhur raportit)

-Nga zyra e taksave dhe tarifave vendore e bashkisë dhe e Njësive Administrative, është vepruar për inventarizimin e dokumentacionit që ndodheshin në dosjet e subjekteve taksapagues të taksave dhe tarifave vendore ku nga auditimi u konstatuan me mangësi e konkretisht:

-të gjitha praktikatat nuk shoqërohen me fletë inventari për numrin dhe llojin e dokumenteve dhe shkresave që përmban një dosje e subjektit.

-i gjithë dokumentacioni i subjektit mbahet në një dosje qysh nga krijimi i subjektit për disa vite me radhë.

-praktikat e përfunduara të viteve të mëparshëm nuk janë dorëzuar në arkivin e institucionit. *Veprimi dhe mosveprimi është në kundërshtim, me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” neni 24, ku përcaktohet: Arkivat e institucioneve shtetërore qendrore dhe vendore kanë detyrë : a) të evidencojnë korrespondencën që dërgohet ose merret nga institucioni b) të bëjnë përpunimin arkivor, të ruajnë dhe të shërbejnë dokumentet që administrojnë, c) të dorëzojnë dokumentet në arkivat shtetërore, sipas afateve ligjore përkatësisht sipas përshkrimit në nenin 9 shkronjat "b", "c", "ç" dhe "d" të këtij ligj, dhe me rregulloren e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave “Për normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në*


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

*Republikën e Shqipërisë” kapitulli II-Rregulla për punën me dokumentet administrative në subjektet shtetërore dhe jo shtetërore, neni 21 dhe neni 27.*

Vlera debitorë e bizneseve juridike dhe fizike paraqitet si më poshtë:

Për vitin 2017, vlera debitorë e biznesit të madh dhe të vogël është në vlerën totale prej 2,402,128 lekë dhe kamat vonesa në vlerën totale 526,066 lekë, për 112 biznese nga të cilat 16 subjekte biznesi i madh dhe 96 subjekte biznesi i vogël.

Për vitin 2018, vlera debitorë e biznesit të madh dhe të vogël është në vlerën totale prej 3,268,040lekë dhe kamat vonesa në vlerën totale **719,643** lekë, për 143 biznese nga të cilat 31 subjekte biznesi i madh dhe 112 subjekte biznesi i vogël.

Për vitin 2019, vlera debitorë e biznesit të madh dhe të vogël është në vlerën totale prej 3,722,074lekë dhe kamat vonesa në vlerën totale 815,135leke, për 205 biznese nga të cilat 32 subjekte biznesi i madh dhe 173 subjekte biznesi i vogël. (Të dhëna për numrin e bizneseve jepen në aneksin nr. 2.2 në fund të raportit të auditimit)

**Taksa dhe tarifa lokale (familjarët).**

Për vitin 2017, me VKB nr. 2, datë 20.01.2017, është miratuar taksë ndërtese për familjarët 5 lekë m<sup>2</sup> në vit për çdo familje deri me 30.09.2019 dhe nuk ka patur ndryshim të kësaj takse. Për vitin 2017-2018, nuk janë planifikuar të ardhurat nga taksa dhe janë realizuar 2,630 mijë lekë, sipas Akt-Rakordimit me Nr. 773 prot datë 17.11.2017 për vitin 2017 dhe Akt-Rakordimit Nr. 477 prot, datë 07.06.2019 dhe gjendja debitorë në vlerën totale prej 1,355 mijë. Nga verifikimi rezulton se numri i familjeve gjithsej sipas gjendjes civile dhe sipas njësive administrative është 4557 familje, nga të cilat 865 familje janë në emigracion, 147 familje trajtohen përkatësisht me ndihme ekonomike, invalid të verbër, paraplegjik, të cilat nuk ngarkohen me detyrime për taksa dhe tarifa familjare, sipas vendimeve të këshillit të bashkisë për paketën fiskale. Diferenca prej 2060 familje nuk ngarkohen me taksa familjare. Në formë tabele paraqitet sipas pasqyrës së mëposhtme: Në planifikim nuk janë planifikuar saktë të ardhurat për vitin 2017-2019, pasi nuk janë marrë në konsideratë vlera debitorë e trashëguar në vite për taksat dhe tarifatat familjare.

Nga sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk janë dorëzuar listat e debitorëve familjarë, në zyrën e financës për tu kontabilizuar në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2018 sepse nga zyra e taksave dhe tarifave vendore nuk janë evidentuar debitorët familjar edhe pse është bërë marveshje me agjentin tatimor “Ujësjellës Tepelenë” Sh.a. Nga mos dorëzimi i listave të debitorëve familjar, pasqyrat financiare nuk janë reale pasi llogaritë debitorë për shumën e detyrimeve Tatim Taksat Lokale, nuk pasqyrojnë gjendjen reale për detyrime për taksat familjare për 4557 familje. Mos evidentimi i vlerës së debitorëve familjarë, tregon se pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e aktiveve, veprimi dhe mos veprimi janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar neni 35; Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” dhe me kërkesat e UMF nr.08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

*Sa më sipër arrihet në konkluzionin se:*

Për vjeljen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore nga ana e Zyrës së Taksave dhe Tarifave vendore të Bashkisë Tepelenë, nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme ligjore të mëposhtme:


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

-Nuk i është kërkuar Këshillit të Bashkisë, ndërhyrje me forcën e Policisë Bashkiake, për vjeljen e detyrimeve të subjekteve debitorë, siç parashikohet në nenin 5, shkronja (ç) pika (iii), të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”

-Për subjektet debitor dhe subjektet të pa reregjistruar në QKB nga administrata tatimore nuk janë ndjekur të gjitha etapat sipas ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar nga neni 89,90,91,92,93 e në vazhdim ku përcaktohet me marrjen e masave të tjera shtrënguese si bllokimi i aktivitetit të biznesit deri në sekuestron e mallrave të debitorëve, dhe kallëzim penal.

-Nga administrata tatimore e bashkisë rezultoi se janë hapur dosje individuale për të gjithë subjektet, për vitet 2017, 2018, dhe 2019. Nga kontrolli i dokumentacionit u konstatuan me mangësi në dosjet e subjekteve; të gjitha praktikat nuk shoqërohen me fletë inventari për numrin dhe llojin e dokumenteve dhe shkresave që përmban një dosje e subjektit; i gjithë dokumentacioni mbahet në dosje qysh nga krijimi i subjektit për disa vite me radhë; praktikat e përfunduara të viteve të mëparshëm nuk janë dorëzuar në arkivin e institucionit, në kundërshtim me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” neni 24, dhe me Rregulloren e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, kapitulli II, nenet 21, 27.

Në dosjet e subjekteve tatimpagues duhet të ishin plotësuar me dokumentet e mëposhtme, si: Lista e përmbajtjes së dokumenteve të një biznesi, njoftim vlerësimet tatimore, deklaratat parashikuese të qarkullimit vjetor, gent planet apo planimetritë kjo për taksën e ndërtesave, akt- konstatimet apo akt-verifikimet për mbylljen e aktivitetit, të konfirmuara dhe nga Policia bashkiake etj, mandat arkëtimi i taksës, etj.

-Zyra e Tatim Taksave Vendore për arkëtimin e taksave të popullatës është mjaftuar vetëm duke detyruar familjet që marrin shërbim (vërtetime etj) në bashkinë e Tepelenës të paguajnë tarifën familjare, duke mos marrë masat e duhura për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të “Njoftim Vlerësimit”, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Për mos nxjerrjen e Njoftim Vlerësimit tatimor, për popullatën është shkelur neni 70 pika 3 “ E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “ Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar.

-Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2017, 2018 dhe 9-mujorin e vitit 2019 nuk ka korrespondencë shkresore me Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastër (agjentët tatimor) për akt-rakordimet për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin në lidhje me të ardhurat e arkëtuara për subjektet të cilat ndodhen në administrimin e Bashkisë Tepelenë, por janë mjaftuar vetëm me të dhënat që vijnë nga thesari.

-Nga zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore për periudhën e auditimit mbi parashikimin, realizimin dhe përdorimin e taksave vendore sipas llojeve të tyre, ka rezerva në planifikim, në lidhje me pasurinë e paluajtshme dhe tarifatat e pastrimit, ndriçimit etj, për familjarët, ku nuk është planifikuar për tu mbledhur dhe arkëtuar nga ky sektor. Nga ky tregues del qartë se po të ishin planifikuar këto taksa dhe tarifa, që zënë dhe peshën kryesore në llojin e taksave dhe tarifave, do të kishim një mosrealizim taksave vendore në përgjithësi për periudhën objekt auditimit.

**Kriteri:**

Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, Vendimet e Këshillit Bashkiak për miratimin e paketës fiskale, etj.


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

<b>Ndikimi</b>	Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve nga ana e Njësisë së Qeverisjes Vendore.
<b>Shkaku:</b>	Mungesa e zbatimit me rigorozitet akteve ligjore dhe nënligjore që disiplinojnë taksat dhe tarifave vendore.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandim</b>	Nga Bashkia Tepelenë të merren masa që të zbatohen procedurat ligjore për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore dhe arkëtimin e borxhit të akumuluar nga mospagimi i taksave dhe tarifave vendore.

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***

**Z. R. H.**, me detyrë inspektor i sektorit të ardhurave, në bashkinë Tepelenë për periudhën 2017 - 2019

**Z. G. G.** me detyrë inspektor i sektorit të ardhurave, në bashkinë Tepelenë për periudhën 2017 - 2019

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	<b>i</b>	<b>Mos arkëtim i gjobave të vendosura nga IMTV</b>
<b>Situata:</b>		<p>Në bashkinë Tepelenë nga ana e sektorit të IMTV nuk është mbajtur regjistri për gjobat e vendosura nga IMTV Bashkia Tepelenë, në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 darë 01.10.2014 Për “Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar me ligjin nr.73/215, datë 09.07.2015 dhe nr. 28/2017, datë 23.03.2017 neni 51.</p> <p>Nga IMTV për periudhën e auditimit 2017-30.09.2019 janë vendosur 4 masa administrative me gjobë në vlerën totale 1,900,000 lekë, nga të cilat vlera prej 500,000 lekë është kryer pagesa referuar mandat arkëtimin nr. 36 datë 08.02.2019 dhe ka mbetur pa u arkëtuar vlera prej 1,400,000 lekë shumë e cila përbën të ardhur të munguar për bashkinë Tepelenë respektivisht: 1 z. R. S. me objekt ritje fiktive të çmimeve në vlerën 500,000 lekë, shoqëria “E. C.C.” shpk me objekt prishje e infrastrukturës në vlerën totale 100,000 lekë dhe shoqëria “K. K. ” shpk me objekt ndertim pa leje në vlerën totale 800,000 lekë. Gjithashtu nga ana e IMTV nuk është ber njoftimi i Drejtorisë së Legjislacionit dhe Shërbimeve Organizativ për të nisur procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ (vendimit të Gjobës) të përcaktuara në ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, përkatësisht: neni 9 -Ekzekutimi i kundërvajtjeve administrative; neni 22 -Vendimi për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë, si titull ekzekutiv” dhe neni 30-Arkëtimi i shumave të detyrimeve.</p> <p><i>Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi :</i>          Kryeinspektor i IMTV G. M., të cilët mbajnë përgjegjësi sipas përcaktimeve në ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe konkretisht nenin 44-Përgjegjësia e punonjësit të organit administrative.</p>
<b>Kriteri:</b>		<p>Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, përkatësisht: neni 9 -Ekzekutimi i kundërvajtjeve administrative; neni 22 -Vendimi për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë, si titull ekzekutiv” dhe neni 30-Arkëtimi i shumave të detyrimeve</p> <p>Ligji 107/2014 darë 01.10.2014 Për “Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar me ligjin nr.73/215, datë 09.07.2015 dhe nr. 28/2017, datë 23.03.2017 neni 51.</p>

	<b>KONTROLLI I LARTË I SHTETIT</b> <b>Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”</b>
---	--

<b>Ndikimi</b>	Mungesë të ardhurash në bashkinë Tepelenë.
<b>Shkaku:</b>	Mosrakordimi midis drejtorisë juridike dhe sektorit të IMTV
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandim</b>	Nga sektori i IMTV në bashkëpunim me drejtorin Juridik, të kërkohet në Gjykatë, shndrimi i 3 vendimeve të kundërvajtjes në titull ekzekutiv në përputhje me nenin 24-Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv, të ligjit nr.10279,datë 20.05.2010 ”Për kundërvajtjet administrative”.

\*Në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga zyra e ALUIZNI- Drejtoria Rajonale Gjirokastrë, u auditua i gjithë dokumentacioni për periudhën 01.01.2017 deri 30.09.2019, në zbatim të ligjit nr. 9482 datë 03.04.2016, “Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 23, ku cilësohet: “Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë llogaritet dhe arkëtohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me pikën 2/1, të nenit 27, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”.

Gjatë viti 2017, vitit 2018 dhe deri në 30.09.2019, nga ALUIZNI- Drejtoria Rajonale Gjirokastrë, janë dërguar shkresat përcjellëse dhe listat me emrat përkatës që ju janë miratuar Lejet e Legalizimit për ndërtimet pa leje ndërtimi brenda territorit të bashkisë Tepelenë. Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Bashkia Tepelenë, nuk janë marrë masa të veçanta për vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI- Drejtoria Rajonale Gjirokastrë. Pasqyra e personave të cilët janë pajisur me Leje Legalizimi, sipërfaqet ndërtimore sipas objekteve, Funkzioni, vendndodhja e objektit, Sipërfaqja e objektit, detyrimi sipas personave që duhet të paguanin, për periudhën deri më 30.09.2019, paraqitet bashkangjitur.

Konstatohet se nuk kanë shlyer detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 1,106,995 lekë nga 24 persona të pajisur me leje legalizimi për objektet e ndërtuara pa leje ndërtimi. Pasqyra e personave të cilët janë pajisur me Leje Legalizimi, për objektet e ndërtuara pa leje ndërtimi, sipërfaqet ndërtimore sipas objekteve, vendndodhja e objektit dhe detyrimi i pa likuiduar sipas aneksit B/1, bashkangjitur.

Sipas të dhënave zyrtare që ALUIZNI i ka dërguar Bashkisë Tepelenë, konstatohet se deri më 30.09.2019, janë posedues të lejes së legalizimit që nuk kanë paguar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë për 24 persona për sipërfaqe ndërtimore gjithsej 7065 m<sup>2</sup>. Veprimi dhe mosveprimi janë, jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në ligjin nr. 9482 datë 03.04.2016, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014 neni 23, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar dhe Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.2, datë 20.01.2017, VKB nr.41, datë 21.12.2017 dhe VKB nr.74, datë 28.12.2018 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore”, pika 10, të Bashkisë Tepelenë”, sipas aneksit B/2, në vlerën **1,106,995 lekë**.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:*

**Z.L. B.** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit të Bashkisë Tepelenë, për periudhën vitet 2017, 2018 deri 30.09.2019.

*(Sa më sipër është mbajtur akt konstatimi nr.5, datë 15.11.2019)*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”

\*Bazuar në dokumentet e paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, specialistët e Sektorit të Tatim-Taksave, lidhur me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitetet me seli në territorin e bashkisë Tepelenë dhe në Njësitë Administrative, u audituan për arkëtimin e tarifës për lëshimin e Autorizimeve/Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë të Bashkisë Tepelenë. Subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë në Bashkinë Tepelenë, NIPTI, adresa ku ushtron aktivitetin, afati i fillimit dhe përfundimit të autorizimit/Licencës, paraqiten në vijim:

Pasqyra e subjekteve që tregtojnë karburante bashkia Tepelenë periudha janar 2017-30.09. 2019.

Nr	Subjekti	Nipti	Adresa	Nr. Dt. Afati
1	"K." shpk	J.....P	Qendër Tepelenë	04.06.2018-03.06.2023
2	"O."shpk	J.....I	Luzat Tepelenë	03.08.2018-02.08.2023
3	"S."shpk	K.....V	Qendër Tepelenë	08.07.2019-06.07.2024
4	"K." sha	K.....N	Qendër Tepelenë	S'ka

Shënim: Të dhënat janë disponuar nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar.

Në lidhje me auditimin e kryer, për zbatimin e legjislacionit të taksave dhe tarifave vendore, vendimeve të këshillit bashkiak, si dhe procedurave ligjore për përcaktimin dhe llogaritjen e taksave dhe tarifave vendore për Licencë karburanti, (autorizime), sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, si dhe të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pikës 1, germës “b”; pika 6/1; dhe pika 9; të VKB nr.2, datë 20.01.2017 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore”, VKB nr.41, datë 21.12.2017 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Tepelenë për vitin 2018”, VKB nr.74, datë 28.12.2018 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore”, pika 10, u konstatua se:

-Subjekti “K.” shpk, me NIPT J.....P, është pajisur nga Bashkia me Autorizim nr.ska, datë 04.06.2018, për tregti me pakicë të lëndëve djegëse, me vendndodhje në Rruga Nacionale Tepelenë-Memaliaj KM 1. Konstatohet se nga subjekti është kryer pjesërisht pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencës për stacionin e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, në vlerën 50,000 lekë sipas dokumentit të Raiffeisen Bank datë 04.06.2018, nga 1,000,000 lekë, që duhej të paguante, me një diferencë më pak në vlerën prej **950,000 lekë**.

-Subjekti “O.” shpk, me NIPT J.....I, është pajisur nga Bashkia me Autorizim nr.3, datë 03.08.2018, për tregëti me pakicë të lëndëve djegëse, me vendndodhje në Rruga Nacionale Tepelenë-Gjirokastër km 2. Konstatohet se nga subjekti nuk është kryer pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencës për stacionin e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, në vlerën **1,000,000 lekë**.

-Subjekti “S.” shpk, me NIPT K.....V, është pajisur nga Bashkia me Autorizim nr.1, datë 08.07.2019, për tregti me pakicë të lëndëve djegëse, me vendndodhje në pjesën veriore të qytetit pranë portës perëndimore të Kalasë Ali Pashë Tepelena. Konstatohet se nga subjekti nuk është kryer pagesapër dhënien dhe përsëritjen e licencës për stacionin e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante. në vlerën **1,000,000 lekë**.

-Subjekti “K.” shpk, me NIPT K.....N, nuk është pajisur nga Bashkia me Autorizim, për tregti me pakicë të lëndëve djegëse, për aktivitetin e biznesit që ushtron në Lagjen Selam Musai, pranë Rrapit, Bashkia Tepelenë, për pasojë nuk është kryer as pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencës për stacionin e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, në vlerën **1,000,000 lekë**. Si përfundim konstatohet se: Nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, Sektori i Tatim Taksave, Bashkia Tepelenë, nuk është arkëtuar tarifa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë në tre raste në vlerën 3,000,000 lekë dhe në një rast është përlllogaritur gabim tarifa e përsëritjes së licencës, me diferencë më pak në vlerën 950,000 lekë, të trajtuara në pikën B/4, veprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”

nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, kapitulli II, pika 1; germa “b”; pika 9, dhe të VKB nr.2, datë 20.01.2017 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore”, pika 10. -VKB nr.41, datë 21.12.2017 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Tepelenë për vitin 2018”, pika 10.-VKB nr.74, datë 28.12.2018 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore”, pika 10. Dhënie e Licencave për tregëtimin e Naftës bruto dhe nënprodukteve të saj. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 1,000,000 lekë. Struktura e ngarkuar për dhënien e kësaj licence dhe vjeljen e detyrimit është Sektori i Zhvillimit Ekonomik (Tatim-Taksa). Struktura e ngarkuar për penalitetet për mospajisje dhe mos zbatim të saj (bazuar në rregulloren përkatëse) është Policia Bashkiake, sipas aneksit nr. B/2, në 4 raste në vlerën **3,950,000 lekë**.

Pasqyra e detyrimeve të subjekteve që tregtojnë karburante periudha 01.01.2017-30.06.2019.

Nr	Subjekti	Nipti	Detyrimi Lekë	Arkëtuar Lekë	Diferenca Lekë
1	"K." shpk	J.....P	1,000,000	50,000	950,000
2	"O." shpk	J.....I	1,000,000	0	1,000,000
3	"S." shpk	K.....V	1,000,000	0	1,000,000
4	"K." sha	K.....N	1,000,000	0	1,000,000
	Total		<b>4,000,000</b>	<b>50,000</b>	<b>3,950,000</b>

Shënim: Të dhënat janë disponuar nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar.

Nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, Sektori i Tatim Taksave, Bashkia Tepelenë, nuk është arkëtuar tarifa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë në tre raste dhe në një rast është përlllogaritur gabim tarifa e përsëritjes së licencës, të trajtuara në pikën B/4, veprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, kapitulli II, pika 1; germa “b”; pika 9, dhe të VKB nr.2, datë 20.01.2017, nr.41, datë 21.12.2017, nr.74, datë 28.12.2018, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore”, pika 10, sipas aneksit nr. B/2, në 4 raste në vlerën **3,950,000 lekë**.

### Gjetje nga auditimi

<b>Titulli gjetjes</b>	-Mos arkëtim tarife nga mos dhënia e Licencave për tregti karburanti.
<b>Situata:</b>	-Nuk është vepruar për të pajisur subjektet, me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe nuk janë arkëtuar tarifa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, në vlerën <b>3,950,000 lekë</b> .
<b>Kriteri</b>	-VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9.
<b>Ndikimi/Efekti</b>	-Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve.
<b>Shkaku</b>	-Mos zbatimi i kërkesave ligjore.
<b>Rëndësia:</b>	-I lartë.
<b>Rekomandimi</b>	-Të merren masa nga Bashkia Tepelenë, që të zbatohen procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimit në vlerën <b>3,950,000 lekë</b> .

**Komente nga subjekti i audituar:** Për sa më sipër janë bërë kundërshti nga z.L. B. me detyrë drejtor i drejtorisë së planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit, ku në mënyrë të përmbledhur thuhet:




**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

“Për arkëtimin e të ardhurave nga Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë të Ndërtimeve Informale që ndodhen në Territorin e Bashkisë Tepelenë”, nga DPKZHT nuk ka asnjë urdhër për caktimin e specialistit për llogaritjen e kësaj takse. Këtë llogaritje e ka kryer specialisti z. V. P. (caktuar nga zyra e financës), i cili nuk është në organikën e DPKZHT për shkak të nenit nr. 14 të ligjit nr. 107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.

Pavarësisht, DPKZHT e ka monitoruar dhe ka bërë disa herë ndërhyrje e korrigjime për këtë proces. Ndërhyrjet dhe korrigjimet kanë qenë të llojit verbal dhe shkresor. Ju informojmë se ndërhyrjet e llojit verbal kanë qene si me specialistin duke i dhënë udhëzime (për shkak se kjo taksë vijohej të llogaritej më shumë se legjislacioni), ku është udhëzuar se të gjithë qytetareve t’i kthehet shumë e arkëtuat gabimisht duke i njoftuar me shkresë secilin. Gjithashtu ndërhyrjet verbale kanë qenë dhe për ish Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Tepelenë (sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës) Drejtoria Vendore Tepelenë) si dhe ALUIZNI Drejtoria Gjirokastër (sot e pa transferuar tek ASHK Drejtoria Vendore Tepelenë).

Duke parë mos reagimin e tyre (Leja e Legalizimit apo Regjistrimet kryheshin edhe pa u paguar me parë kjo taksë), i kemi dërguar disa herë shkresë zyrtare në lidhje me këtë çështje. Nga ana e tyre ka filluar reagimi (shkresor dhe sensibilizues, frenues pozitiv në zbatim të ligjit dhe në koordinim me Bashkinë Tepelenë), vetëm pasi në ALUIZNI Gjirokastër është kryer audit këtë në vitin 2019 nga KLSH, ku i është konstatuar shkelja. Nga ana e DPKZHT, është konstatuar se TNI për ndërtimet informale i ka shkaktuar Bashkisë Tepelenë jo 1,106,995 lekë por rreth 2,100,000 lekë nga keqinterpretimi i legjislacionit. Kjo për faktin se Subjektet “D.” shpk dhe Subjekti “J. I. T.”, nuk kanë paguar këtë detyrim për shkak të favorizimit nga ana e ALUIZNI Gjirokastër. Edhe pse këta 2 subjekte e kanë paguar TNI kur janë pajisur me leje ndërtimi, fakti se këto objekte po trajtohen me legalizim, duhet patjetër ta paguajnë TNI në masën 0.5% që parashikohet për këtë procedurë, ose në të kundërtën duhet të vijnë me lejen e ndërtimit, ku veç penaliteteve për shkelje të kondicioneve të zhvillimit apo shkelje të afateve të punimit (që arrijnë deri në 10,000,000 lekë për secilin), kanë shmangur/përfituar edhe tatimet shtetërore në vlera të konsiderueshme (rreth 20,000,000 lekë për secilin).

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Nga grupi i auditimit kundërshtimet e subjektit nuk merren në konsideratë pasi:

-Në auditimin e programimit dhe realizimit të të ardhurave, nga arkëtimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se, nga Bashkia Tepelenë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, nuk janë marrë masa lidhur me arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI-Drejtoria Rajonale Gjirokastër. Sipas të dhënave zyrtare që ALUIZNI i ka dërguar Bashkisë Tepelenë, konstatohet se deri më 30.09.2019, janë posedues të lejes së legalizimit që nuk kanë paguar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë për 24 persona për sipërfaqe ndërtimore gjithsej 7065 m<sup>2</sup>, në vlerën **1,106,995 lekë**. Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me kërkesat e:

- ligjit nr. 9482 datë 03.04.2016, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014 neni 23;
- ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar;
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar;
- Vendimet e Këshillit të Bashkisë Tepelenë si vijon: VKB nr.2, datë 20.01.2017, VKB nr.41, datë 21.12.2017 dhe VKB nr.74, datë 28.12.2018 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore”, pika 10. Për arsye se nuk keni fakte dhe prova të reja, kundërshtitë tuaja nuk merren parasysh.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

**Z.R.H.** me detyrë, Specialist i Sektorit të Tatim-Taksave.

**Z.G. G.** me detyrë, Specialist i Sektorit të Tatim-Taksave.

(Sa më sipër është mbajtur akt konstatimi nr.6, datë 15.11.2019)

\*Në auditivin e kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit, nga dhënia me qira e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore dhe Inproduktive, në pronësi dhe në përdorim të Bashkisë Tepelenë, për të cilat janë lidhur kontrata qiraje, me subjektet të ndryshme private. Sipas dokumenteve të paraqitura nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, specialistët e Sektorit të Tatim-Taksave, konstatohet se në territorin e Bashkisë Tepelenë ushtrojnë aktivitet privat 2 (dy) subjekte të pajisura me leje minerare nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe 2(dy) subjekte të cilat kanë lidhur kontratë qiraje për sipërfaqet pyjore dhe kullimore me afat 6-10 vjet. Në vijim po paraqesim subjektet që ushtrojnë aktivitet në territorin e bashkisë Tepelenë dhe që janë pajisur me leje minerare dhe/ose me kontratë qiraje të lidhur midis palëve.

1.Subjekti “C.” shpk me NIPT K.....M, është pajisur me Leje Minerare nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, me nr.8321 prot, datë 21.05.2015 dhe nga Bashkia Tepelenë është lidhur kontrata e qirasë me nr.1095/1, datë 15.09.2017, me objekt dhënie në përdorim nga fondi Pyjor/kulloror një sipërfaqe prej 0,033 km<sup>2</sup> ose 0,33 ha. Qëllimi i përdorimit është “Për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja” me vendndodhje në fshatin Bënçë Tepelenë. Afati i kontratës është për 6 (gjashtë) vjet, vlera e qirasë vjetore është 132,000 lekë, vlerë e cila është arkëtuar. sipas dokumentit të A.b. datë 14.06.2017, datë 19.04.2018 vlera 145,200 lekë dhe datë 03.04.2019 vlera 145,200 lekë. Nga auditimi i kësaj kontrate konstatohet se:

-Sipërfaqja nga fondi Pyjor/kulloror sipas kontratës është 0,033 km<sup>2</sup> ose 0,33 ha, e cila është konvertuar gabim nga km<sup>2</sup> në ha, pasi 0,033 km<sup>2</sup> nuk bëjnë 0,33 ha por 3,3 ha, (sepse 0,033 km<sup>2</sup> x 100, është ë barabartë me 3,3 ha dhe jo 0,33 ha), pra është konvertuar gabim, në kontratë.

-Përllogaritja e vlerës së qirasë, sipas kontratës është 0,33 ha x 440,000 lekë/ha = 132,000 lekë, kurse sipas auditimit dhe përllogaritjeve tona, në fakt duhet të jetë 3,3 ha x 440,000 lekë/ha =1,452,000 lekë detyrimi vjetor, me diferencë më pak në vlerën **1,320,000 lekë**, (1,452,000 lekë- 132,000 lekë).Veprimi dhe mosveprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar, lidhja nr. 2 “Tarifat dysheme për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjorë dhe kullororë publik për ushtrimin e veprimtarive”, pika 6. Për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrierë), tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lekë/ha/vit, 6-10 vjet, Inproduktive është 440,000 lek/ha/vit.

2.Subjekti “K.” shpk me NIPT K.....W, është pajisur me Leje Minerare nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, me nr.955 prot, datë 07.08.2006 dhe nga Bashkia Tepelenë nuk është lidhur kontrata qiraje për dhënie në përdorim nga fondi Pyjor/kulloror sipërfaqen prej 1(një) ha, e përcaktuar në Lejen Minerare Shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror. Nga auditimi i kësaj Leje Minerare konstatohet se:

-Nga Bashkia nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektin “K.” shpk me Nipt K.....W, pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror, me vendndodhje në Luzat, Tepelenë, me sipërfaqe të fondit pyjor/kulloror prej 1 (një) ha, detyrimi pa arkëtuar është në vlerën **440,000 lekë**, (1ha x 440,000 lekë/ha vit).

Veprimi dhe mosveprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar, lidhja nr. 2 “Tarifat dysheme për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjorë dhe kullororë publik për ushtrimin e veprimtarive”, pika 6. Për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrierë), tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lekë/ha/vit, 6-10 vjet, Inproduktive është 440,000 lek/ha/vit.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”

3. Subjekti “I.” shpk dhe Bashkia Tepelenë kanë lidhur kontratë qirasë me nr.53, datë 11.04.2011, me objekt dhënie në përdorim nga fondi Pyjor/kullosor një sipërfaqe prej 2253 km. Qëllimi i përdorimit është “Për ndërtimin e Hidrocentralit B. i L.” me vendndodhje në fshatin Mezghoran”, Tepelenë. Afati i kontratës është për 6 (gjashtë) vjet, vlera e qirasë vjetore është 327,105 lekë, arkëtuar vlera 327,105 lekë, sipas dokumentit të R. B. datë 20.04.2017, datë 26.11.2018 vlera 327,105 dhe datë 20.03.2019 vlera 327,105 lekë. Nga auditimi i kësaj kontrate konstatohet se:

-Përlllogaritja e vlerës së qirasë, sipas kontratës është 2253 km trungishte x 145,000 lekë/km/vit = 326,685 lekë, plus 420 lekë/ha kullotë, në total detyrimi sipas kontratës rezulton në vlerën 327,105 lekë. Tarifa prej 145,000 lekë/km/vit për trungishte është aplikuar gabim, duhet 175,000 lekë/km/vit. -Përlllogaritja sipas auditimit duhet të jetë 2253 km trungishte x 175,000 lekë/km/vit = 394,275 lekë /vit, plus 420 lekë/ha kullotë, në total detyrimi i korrigjuar është në vlerën 394,695 lekë, me diferencë më pak në vlerën **67,590 lekë/vit.**

Veprimi dhe mosveprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar, lidhja nr. 2 “Tarifat dysheme për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjorë dhe kullosorë publik për ushtrimin e veprimtarive”, pika 11. Për shtrirje tubacionesh dhe linjash në sipërfaqe, si dhe ndërtim kanalesh (uji, naftë, gazi, tensioni elektrik etj.), Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lekë/km/vit, 6-10 vjet, është për “Pyll trungishte **175,000 lekë/km/vit.**”

4. Subjekti I. H. person fizik dhe Bashkia Tepelenë kanë lidhur kontratë qirasë me nr.136, datë 15.11.2017, me objekt dhënie në përdorim nga fondi Pyjor/kullosor një sipërfaqe prej 3,34 ha. Qëllimi i përdorimit është “Për qëllime pushimi argëtimi, shëndetësore e shoqërore dhe veprimtari turistike kampingje” me vendndodhje në fshatin Luzat”, Tepelenë. Afati i kontratës është për 10 (dhjetë) vjet, vlera e qirasë vjetore është 251,100 lekë, arkëtuar vlera 1,515,250 lekë, sipas dokumentit të Raiffeisen bank datë 16.11.2017. Nga auditimi i kësaj kontrate nuk u konstatuan probleme.

5. Subjekti “E. C.” shpk dhe Bashkia Tepelenë kanë lidhur kontratë qirasë me nr.16/2/1, datë 27.12.2017, me objekt dhënie në përdorim nga fondi Pyjor/kullosor një sipërfaqe prej 1,0623 km. Qëllimi i përdorimit është “Për përdorim rruge lidhjen e sipërfaqes së dhënë në përdorim me rrjetin rrugor ekzistues me vendndodhje në Njësinë Administrative Qendër”, Tepelenë. Afati i kontratës është për 10 (dhjetë) vjet, vlera e qirasë vjetore është 37,200 lekë, arkëtuar vlera 111,600 lekë, sipas dokumentit të MA nr.550, datë 128.12.2017. Nga auditimi i kësaj kontrate nuk u konstatuan probleme.

Në vijim paraqiten sipas viteve dhe sipas subjekteve, numri dhe data e lejes minerare, numri dhe data e kontratës së qirasë midis Bashkisë dhe subjektit, vendndodhja e ushtrimit të aktivitetit të subjektit, sipërfaqja e dhënë në përdorim me qira, tarifat përkatëse, detyrimi vjetor, arkëtimet dhe diferenca për tu arkëtuar.

#### Viti 2017

Aneksi B/4/1.Pasqyra e detyrimeve të subjekteve nga kontratat e qirave periudha viti 2017.

Nr	Nr Lejes	Data	Nr kontratës	Data	Emri i Subjektit	Vendndodhja	Sipërfaqja ha	Tarifa lek/ha	Detyrimi	Arkëtuar	Diferenca
1	8,321	21.05.15	1095/1	15.09.17	C." shpk	Bence.	0,33	440,000	1,452,000	132,000	1,320,000
2	955	07.08.06	0	0	"K." shpk	Luzat	1	440,000	440,000	0	440,000
3			53	11.04.17	"I."	Mezghoran	2253 km	175,000	394,695	327,105	67,590
4			136	15.11.17	I. H.	Luzat	3,34	75,000	251,100	251,100	0
									2,537,795	710,205	1,827,590

Shënim: Të dhënat janë disponuar nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar.

#### Viti 2018

Aneksi B/4/2.Pasqyra e detyrimeve të subjekteve nga kontratat e qirave periudha viti 2018.

Nr	Nr Lejes	Data	Nr kontratës	Data	Emri i Subjektit	Vendndodhja	Sipërfaqja ha	Tarifa lek/ha	Detyrimi	Arkëtuar	Diferenca
----	----------	------	--------------	------	------------------	-------------	---------------	---------------	----------	----------	-----------



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”

1	8,321	21.05.15	1095/1	15.09.17	"C." shpk	Bençë.	0,33	440,000	1,452,000	145,200	1,306,800
2	955	07.08.06	955	07.08.06	"K." shpk	Luzat	1	440,000	440,000	0	440,000
3			16/2/1	27.12.17	"E. K."	ZK1149 TP	1,063	35,000	37,200	37,200	0
4			53	11.04.17	"I."	Mezhgoran	2,253	175,000	394,695	327,105	67,590
5			136	15.11.17	I. H.	Luzat	3,34	75,000	251,100	251,100	0
									2,574,995	760,605	1,814,390

Shënim: Të dhënat janë disponuar nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar.

### Viti 2019 ( janar-shtator)

Aneksi B/4/3.Pasqyra e detyrimeve të subjekteve nga kontratat e qirave periudha 01.01-30.09.2019.

Nr	Nr Lejes	Data	Nr kontratës	Data	Emri i Subjektit	Vendndodhja	Sipërfaqja ha	Tarifa lek/ha	Detyrimi	Arketuar	Diferenca
1	8,321	21.05.15	1095/1	15.09.17	"C" shpk	Bençë.	0,33	440,000	1,089,000	145,200	943,800
2	955	07.08.06	955	07.08.06	"K" shpk	Luzat	1	440,000	329,994	0	329,994
3			16/2/1	27.12.17	"E. K."	ZK1149 TP	1,063	35,000	27,900	27,900	0
4			53	11.04.17	"I."	Mezhgoran	2,253	175,000	296,021	245,328	50,693
5			136	15.11.17	I. H.	Luzat	3,34	75,000	188,325	188,325	0
									1,931,240	606,753	1,324,487

Shënim: Të dhënat janë disponuar nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar.

Si përfundim konstatohet se nga auditimi i kryer për realizimin e të ardhurave nga dhënia me qira e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore, për periudhën janar 2017 deri më 30.09.2019, konstatohet se nga 7,044,030 lekë që duhej të ishin arkëtuar, janë arkëtuar vlera 2,077,563 lekë sipas dokumenteve të thesarit dhe të bankës, ose me një diferencë më pak në vlerën 4,966,467 lekë. Kjo për faktin se në auditimin e programimit dhe realizimit të të ardhurave, nga dhënia me qira e aseteve të Bashkisë subjekteve private, të cilat janë pajisur me leje minerare të miratuara nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi, për periudhën 01.01.2017 deri më 30.09.2019, u konstatua se:

-në një rast nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektin "K." shpk me Nipt K.....W, pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror, me vendndodhje në Luzat, Tepelenë, me sipërfaqe 1 (një) ha, detyrimi pa arkëtuar në vlerën 1,209,994 lekë.

-në një rast është lidhur kontratë qiraje me subjektin "C." shpk me Nipt K.....M, pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror, me vendndodhje në Bençë, Tepelenë me sipërfaqe 3,3 ha, detyrimi pa arkëtuar në vlerën 3,570,600 lekë.


-në një rast me subjektin "I." shpk, është lidhur kontratë qiraje nr.53, datë 11.04.2011, me objekt dhënie në përdorim nga fondi Pyjor/kulloror një sipërfaqe prej 2,253 ha, për ndërtimin e Hidrocentralit "Bregu i Lerës" me vendndodhje në fshatin Mezhgoran", Tepelenë, nga subjekti nuk është kryer pagesa e plotë e detyrimit në vlerën 185,873 lekë.

Veprimi dhe mosveprimi është në shkelje të VKM nr. 391, datë 21.06.2006, "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", i ndryshuar, lidhja nr. 2, pikat 6 dhe 11, në tre raste sipas aneksit B/3, në vlerën **4,966,467 lekë**.

Pasqyra e detyrimeve, arkëtimeve dhe diferencave nga dhënia me qira e sipërfaqeve pyjore e kullimore të cilat ndodhen në territorin Bashkisë Tepelenë, të grupuara paraqitet bashkangjitur sipas aneksit B/3.

### Gjetje nga auditimi

<b>Titulli gjetjes</b>	-Mos arkëtim detyrimi nga dhënia me qira e aseteve pyje kullota.
<b>Situata:</b>	-Në Bashkinë Tepelenë ushtrojnë aktivitet disa biznese të pajisur me leje minerare nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, të cilat shfrytëzojnë asetet e bashkisë si Pyje dhe Kullota përkatësisht:

	<b>KONTROLLI I LARTË I SHTETIT</b> <b>Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”</b>
---	--

	<p>-në një rast nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektin “K.” shpk me Nipt K.....W, pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror, me vendndodhje në Luzat, Tepelenë, me sipërfaqe 1 (një) ha, detyrimi pa arkëtuar në vlerën <u>1,209,994 lekë</u>.</p> <p>-në një rast është lidhur kontratë qiraje me subjektin “C.” shpk me Nipt K.....M, pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror, me vendndodhje në Bënçë, Tepelenë me sipërfaqe 3,3 ha, detyrimi pa arkëtuar në vlerën <u>3,570,600 lekë</u>.</p> <p>-në një rast me subjektin “I.” shpk, është lidhur kontratë qiraje nr.53, datë 11.04.2011, me objekt dhënie në përdorim nga fondi Pyjor/kullosor një sipërfaqe prej 2,253 ha, për ndërtimin e Hidrocentralit “Bregu i Lerës” me vendndodhje në fshatin Mezhgoran”, Tepelenë, nga subjekti nuk është kryer pagesa e plotë e detyrimit në vlerën <u>185,873 lekë</u>. Në total detyrimi i pa arkëtuar është në vlerën <b>4,966,467 lekë</b>.</p>
<b>Kriteri</b>	-VKM nr. 391, datë 21.06.2006, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar, lidhja nr. 2, pikat 6 dhe 11.
<b>Ndikimi/Efekti</b>	-Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve.
<b>Shkaku</b>	-Mos zbatimi i kërkesave ligjore.
<b>Rëndësia:</b>	-I lartë.
<b>Rekomandimi</b>	-Të merren masa nga Bashkia, që të zbatohen procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimit në vlerën <b>4,966,467 lekë</b> .

**Komente nga subjekti i audituar:** Për sa më sipër janë bërë kundërshti nga z. S. S., me detyrë drejtor i drejtorisë së zhvillimit rural, ku në mënyrë të përmbledhur thuhet:

Konstatimi nga ana jua se për veprimet dhe mos veprimet në lidhje me Akt Konstatimin Nr.7 ngarkon me përgjegjësi z.S. S.me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Rural, nuk qëndron për arsye se: Kontratat në bashkinë tonë të çdo lloj qofshin, nuk hartohen, përpilohen, përlllogariten dhe lidhen nga drejtoria e bujqësisë dhe zhvillimit rural, por nga drejtoria juridike. Konkretisht për sa i përket pese kontratave që trajtoni në akt konstatim, për problemet specifike në lidhje me heqjen nga fondi pyjor e kullosor, raportet teknike çmimet e të tjera, ka punuar përgjegjësi i sektorit pyje-kullotave inxh.Lefter Ajdini i cili ka ndërruar jetë në qershor 2019 (i cili e kishte për detyrë)

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Nga grupi i auditimit kundërshtimet e subjektit merren në konsideratë dhe janë bënë rregullimet përkatëse në Raportin Përfundimtar të Auditimit. Për këtë çështje nuk ka përgjegjësi z. S. S., pasi për lidhjen e kontratave është përgjegjësi e zyrës juridike, kurse monitorimi i tyre është përgjegjësi e drejtorisë së zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, sektori i taksave dhe tarifave vendore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

**Z.R. H.** me detyrë, Specialist i Sektorit të Tatim-Taksave.

**Z.G. G.** me detyrë, Specialist i Sektorit të Tatim-Taksave.

(Sa më sipër është mbajtur akt konstatimi nr.7, datë 15.11.2019)

\*Në lidhje me auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit, nga dhënia e tokave bujqësore me qira të Bashkisë Tepelenë), bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi dhe sipas dokumenteve të paraqitura nga Drejtoria e Shërbimit Rural dhe Njësia Administrative Qendër, Bashkia Tepelenë, u krye auditimi për realizimin e të ardhurave nga dhënia me qira e tokave bujqësore për të cilat janë lidhur kontrata qiraje në vitet e mëparshme të cilat administrohen nga Bashkia. Në kontratën tip të qirasë janë përcaktuar sanksione ku citohet: “Palët duhet të respektojnë kohën dhe



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”

mënyrën e dhënies me qira dhe të pagesave që bëhet në këtë kontratë për detyrimet që marrin përsipër. Në rast se qiradhënësi vonon pagesën sipas kësaj kontrate do të paguaj gjobë 1% të çmimit të kontratës për çdo ditë vonesë”. Në auditimin e kryer të kontratave të dhënies me qira të tokave bujqësore, konstatohet se jo në të gjitha rastet janë zbatuar detyrimet sipas kontratave për të kryer arkëtimin e detyrimeve të përcaktuara pasi, në 16 raste, nuk janë arkëtuar vlera e detyrimit dhe kamat vonesa përkatëse.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që, nga Bashkia Tepelenë, Njësia Administrative Qendër, nuk është arkëtuar detyrimi sipas kontratave tip të qirave të tokave bujqësore të pandara të lidhur midis ish Bashkisë Tepelenë dhe personave fizik qiramarrës, gjithashtu nuk janë përlllogaritur kamat vonesat përkatëse për çdo ditë vonesë për mosarkëtimin në kohë të detyrimeve, veprim jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr. 531, datë 21.8.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, i ndryshuar, UKM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, kreu V, pika 1,2,5, sipas aneksit nr. B/4, në vlerën **961,491 lekë**. ( detyrim 304,710 lekë, kamat vonesë 656,781 lekë).

Nga përlllogaritjet e kryera bazuar në kontratat e qirasë për sipërfaqen e dhënë me qira rezulton diferencë e pa arkëtuar dhe kamat vonesa të pa llogaritura dhe të pa arkëtuar të cilat paraqiten në aneksin nr. B/4, bashkangjitur.

#### Gjetje nga auditimi

<b>Titulli gjetjes</b>	-Mos arkëtim të ardhura nga dhënia me qira e tokave bujqësore.
<b>Situata:</b>	-Nuk është arkëtuar detyrimi sipas kontratave tip të qirave të tokave bujqësore të pandara të lidhur midis ish Bashkisë Tepelenë dhe personave fizik qiramarrës, gjithashtu nuk janë përlllogaritur kamat vonesat përkatëse për çdo ditë vonesë për mosarkëtimin në kohë të detyrimeve, <b>në vlerën 961,491 lekë</b> . ( detyrim vlera 304,710 lekë, kamat vonesë 656,781 lekë)
<b>Kriteri</b>	-VKM nr. 531, datë 21.8.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, i ndryshuar, -UKM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, kreu V, pika 1,2,4,5
<b>Ndikimi/Efekt</b>	-Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve.
<b>Shkaku</b>	-Mos zbatimi i kërkesave ligjore.
<b>Rëndësia:</b>	-I lartë.
<b>Rekomandimi</b>	-Të merren masa nga Bashkia, që të zbatohen procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimit në vlerën <b>në vlerën 961,491 lekë</b> .

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:*

Z.L. Sh., me detyrë Administrator Nj A Qendër.

Z.M. M., me detyrë specialist Pyje Kullota Nj A Qendër.

*(Sa më sipër është mbajtur akt konstatimi nr.8, datë 15.11.2019)*

\*Në lidhje me auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit, bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënljigjor në fuqi dhe sipas dokumenteve të paraqitura nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, u krye auditimi për realizimin e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për lejet e ndërtimit të dhënë nga Bashkia Tepelenë, për të cilat janë ndjekur procedurat ligjore për marrjen e vendimeve për leje zhvillimore ndërtimi në pronë private. Nga Bashkia Tepelenë për periudhën 01.01.2017 deri në 30.09.2019, janë miratuar 11 (njëmbëdhjetë) leje ndërtimi për objekte banimi, objekte ndihmëse, objekte bare dhe restorante si dhe shtesa objektesh në objektet ekzistuese. Në vijim po paraqesim të dhënat sipas objekteve, vendndodhja e tyre, data e miratimit të lejeve të ndërtimit si dhe vlerat e preventivit për ndërtimin e objekteve, për periudhën 01.01.2017 deri më 30.09.2019.


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

Pasqyra e Lejeve të ndërtimit për periudhën 01.01.2017 deri 30.09.2019 të miratuara nga Bashkia Tepelenë.


Nr	Emër Mbiemër	Objekti	Vendndodhja	Data e Miratimit të L Ndert	Vlera e Preventivit
1	B. H.	Baxho + ambjent nihmës	Dukaj	24.03.2017	5,702,497
2	M. Q.	Godin banimi 2kt +n/çati+podrum	Progonat	15.05.2017	12,454,400
3	Xh. N.	Shtesë kati në shtëpi ekzistuese	Qytet	19.07.2017	4,332,250
4	H. Xh.	Agroturizëm URLA	Rexhinë	20.01.2018	20,136,524
5	N.B.	Banesë individuale 1+2 kt	Nivicë	17.07.2018	10,757,500
6	R. T.	Shtesë Ansore 2kt+shtesë në lartësi 1 kt	Luzat	03.08.2018	18,582,038
7	F. H.	Stallë Lopësh	Beçisht	20.11.2018	28,509,650
8	I. B. H.	Bar Restorant hoteleri 4 kt+2kt podrum	Luzat	24.01.2019	209,162,637
9	I.	Iumentis	Qytet	30.01.2019	70,614,733
10	O.o. e.	Agroturizëm Nivica	Nivicë	20.02.2019	23,235,786
11	S. Q.	Punime infrastrukture dhe sistemime	Dragot	08.08.2019	6,555,279

*Shënim: Të dhënat janë disponuar nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit.*

Në auditimin e kryer për zbatimin e vendimeve të Këshillit të Bashkisë nr.2, datë 20.01.2017 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore”, VKB nr.41, datë 21.12.2017 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Tepelenë për vitin 2018” dhe VKB nr.74, datë 28.12.2018 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore”, të Bashkisë Tepelenë, përse i përket arkëtimit të të ardhurave nga shlyerja e detyrimeve financiare për marrjen e lejeve të ndërtimit, për periudhën 01.01.2017 deri më 30.09.2019. Sipas dokumenteve të paraqitura nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit Bashkia Tepelenë, u krye verifikimi i përllogaritjeve të taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet e pajisura me leje ndërtimi. Verifikimi u krye në se janë zbatuar aktet ligjore si kërkesat e ligjit nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar neni 46, Udhëzimi KM nr.3, datë 28.12.2016, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i banesave, për vitin 2016” dhe Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.2, datë 20.01.2017, nr.41, datë 21.12.2017 dhe nr.74, datë 28.12.2018 “Për miratimin e Paketës Fiskale të vitit 2017 të Bashkisë Tepelenë”. Nga verifikimi i kryer i përllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë për të 11 (njëmbëdhjetë) objektet e pajisura me leje ndërtimi, u konstatua se në tre raste nuk është zbatuar përllogaritja në bazë të çmimit referencë që është kosto mesatare e ndërtimit sipas Entit Kombëtar të Banesave dhe nga rillogaritjet e kryera nga auditimi rezulton sipas aneksit nr.B/5, bashkangjitur.

Në realizimin e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për periudhën janar 2017 deri më 30.09.2019, konstatohet se nga 14,665,698 lekë që duhej të ishin arkëtuar, janë arkëtuar vlera 7,236,016 lekë sipas dokumenteve të thesarit dhe të bankës, ose me një diferencë më pak në vlerën 7,429,682 lekë. Kjo për faktin se nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tepelenë, nuk është llogaritur saktë taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja, nuk është kryer përllogaritja në bazë të çmimit referencë që është kosto mesatare e ndërtimit sipas Entit Kombëtar të Banesave, në shkelje të ligjit nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar neni 46, Udhëzimi KM nr.3, datë 28.12.2016, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i banesave, për vitin 2016” dhe Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.2, datë 20.01.2017, nr.41, datë 21.12.2017 dhe nr.74, datë 28.12.2018 “Për miratimin e Paketës Fiskale të vitit 2017 të Bashkisë Tepelenë”.

Si përfundim konstatohet se, të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për periudhën janar 2017 deri më 30.09.2019, nga 14,665,698 lekë që duhej të ishin arkëtuar, janë arkëtuar vlera 7,236,016 lekë sipas dokumenteve të thesarit dhe të bankës, me një diferencë më pak në vlerën 7,429,682 lekë. Kjo për faktin se nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tepelenë, nuk është llogaritur saktë

	<b>KONTROLLI I LARTË I SHTETIT</b> <b>Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”</b>
---	--

taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja, nuk është kryer përlllogaritja në bazë të çmimit referencë që është kosto mesatare e ndërtimit sipas Entit Kombëtar të Banesave, në shkelje të ligjit nr.107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar neni 46, Udhëzimi KM nr.3, datë 28.12.2016, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i banesave, për vitin 2016” dhe Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.2, datë 20.01.2017, nr.41, datë 21.12.2017 dhe nr.74, datë 28.12.2018 “Për miratimin e Paketës Fiskale të vitit 2017 të Bashkisë Tepelenë”, në vlerën **7,429,682 lekë**, sipas aneksit nr.B/5, bashkangjitur.

#### Gjetje nga auditimi:

<b>Titulli gjetjes</b>	-Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.
<b>Situata:</b>	-Nuk është llogaritur saktë taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja, nuk është kryer përlllogaritja në bazë të çmimit referencë që është kosto mesatare e ndërtimit sipas Entit Kombëtar të Banesave, në vlerën <b>7,429,682 lekë</b> .
<b>Kriteri</b>	-Ligji nr.107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, I ndryshuar, neni 46, -Udhëzimi i KM nr.4, datë 30.9.2015 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i banesave, për vitin 2015”, -Udhëzimi KM nr.3, datë 28.12.2016, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i banesave, për vitin 2016”, -Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.2, datë 20.01.2017, nr.41, datë 21.12.2017 dhe nr.74, datë 28.12.2018 “Për miratimin e Paketës Fiskale të vitit 2017 të Bashkisë Tepelenë”,
<b>Ndikimi/Efekti</b>	- Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve
<b>Shkaku</b>	-Moszbatim i kërkesave ligjore.
<b>Rëndësia:</b>	-I ulët.
<b>Rekomandimi</b>	-Të merren masa nga Bashkia , që të zbatohen procedurat ligjore për kërkimin e detyrimit në vlerën <b>7,429,682 lekë</b> .

**Komente nga subjekti i audituar:** Për sa më sipër janë bërë kundërshti nga z.L. B. me detyrë drejtor i drejtorisë së planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit, ku në mënyrë të përmbledhur thuhet: Në programin e punës të paraqitur nga KLSH, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit (DPKZHT) nuk figuron për auditim. Njoftimi për auditim është bërë vetëm verbalisht. Sidoqoftë nga ana e DPKZHT jepen argumentet e mëposhtëm:

“Për realizimin e të ardhurave të institucionit, nga arkëtimet e Taksës së Ndikimit në Infrastrukture nga dhënia e lejeve të ndërtimit të Bashkisë Tepelenë”.

Verifikimet në lidhje me këtë takse duhet të bëheshin për kontrollin/auditimin e dosjeve në tërësi (të projektit teknik, Raportit të Vlerësimit Teknik RTV të DPKZHT, Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë Tepelenë dhe letër këmbimeve) në mënyrë që mos të kishte keqkuptime. Meqenëse siç u evidentua me lart, në DPKZHT nuk ka ardhur asnjë shkresë zyrtare, përveç këtyre 3 akt konstatimeve, nga ana e Drejtorit të financave të Bashkisë Tepelenë, DPKZHT-së i është kërkuar disa here në mënyrë verbale për vënien në dispozicion fillimisht të arkëtimeve nga subjektet e pajisur me leje dhe me pas janë kërkuar edhe preventivat dhe mënyra e llogaritjes, por jo projekti teknik apo argumentet tekniko-financiare. DPKZHT i ka vënë në dispozicion dokumentet duke ia dërguar me poste elektronike pasqyrat.

Theksojmë se:





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”

1. Është hequr detyrimi në vlerën e 2,208,208 leke që i ka “UK Tepelenë” sha kundrejt Bashkisë Tepelenë. Ky detyrim duhet paguar patjetër pavarësisht rrethanave, meqenëse ka kërkuar dhe pranuar të jetë zhvilluesi i punimeve.

2. Subjekti “Xh. N.” i pajisur me leje ndërtimi, e ka të pavlefshme lejen e ndërtimit meqenëse nuk ka zbatuar kushtet e saj të përcaktuara në po këtë leje. Gjithashtu llogaritja e kësaj diferencë duhet të bazohet në legjislacionin e mësipërm dhe të jetë/ishte paraqitur në këtë Akt Konstatim, në mënyrë që të reflektohej qartë diferenca.

3. Subjekti “R. T.” i pajisur me leje ndërtimi, i cili është në proces për pajisje me Certifikatë Përdorimi (pra jemi në kohë për ta arkëtuar këtë diferencë nëse është e drejtë). Pra llogaritja e kësaj diferencë duhet të bazohet në legjislacionin e mësipërm dhe të jetë paraqitur nga audituesi mënyra se si ka dalë/llogaritur në këtë Akt Konstatim në mënyrë që të reflektohej qartë diferenca.

4. Subjekti “I. H.” i cili ia ka transferuar të drejtat e zhvillimit të birit të tij, subjektit “B. H.”, rezulton me këtë diferencë të pa arkëtuar sepse preventivi i punimeve për të cilën është lëshuar dhe leja e ndërtimit, ka pasur zëra të tjerë dhe vlerë ekzaktësisht siç dhe është llogaritur nga DPKZHT. Më pas, subjekti ka kërkuar të pajiset me certifikatë përdorimi për fazën karabina nga ku është konstatuar që ka zëra të rinj dhe volume të tjera, referuar dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e-Leje (situacion përfundimtar-faza karabina, fatura tatimore, relacione teknike etj.). DPKZHT menjëherë ka rillogaritur TNI dhe diferencën prej 6,603,574 lekë, si dhe në koordinim me Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit (IMT) Tepelenë, ka marrë masat administrative “Dënim me Gjobjë” për shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit dhe i ka kërkuar subjektit të arkëtojë menjëherë detyrimet. DPKZHT ka njoftuar Zyrën e Tatim-Taksave në Bashkinë Tepelenë si dhe subjektin. Janë disa shkresa të protokolluara të cilat i janë dërguar me lajmërim marrje nëpërmjet postes shqiptare subjektit. Pas diskutimeve tepër intensive, duke parë rrethanat për mos largimin e investitorit për shkak të vlerave të paparashikuara nga ai, Kryetari i Bashkisë me vendim, ka vendosur që diferencën e TNI subjekti ta shlyejë para se objekti të pajiset me certifikatë përdorimi, duke i lenë kohë zhvilluesit të menaxhojë situatën financiare.

**Oëndrimi i grupit të auditimit:** Nga grupi i auditimit kundërshtimet e subjektit nuk merren në konsideratë pasi:

1. Për sa i përket pretendimit të subjektit se në programin e punës të paraqitur nga KLSH, drejtorja e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit (DPKZHT) nuk figuron për auditim dhe, pretendimit tjetër se njoftimi për auditim është bërë vetëm verbalisht, sqarojmë në programin e auditimit nr. 603/1, datë 26/08/2019, është përcaktuar që të auditohen të gjitha të ardhurat e krijuara nga Bashkia Tepelenë, ku përfshihen edhe të ardhurat e realizuara nga arkëtimet e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga dhënia e Lejeve të Ndërtimit të Bashkisë Tepelenë. Citojmë nënpikën nr. 4 të pikës B të programit të auditimit B.4. Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor; Niveli i arkëtimit të gjobave të vendosura nga IMTV, apo organeve të tjera. (Të dhënat e të ardhurave të analizohen në mënyrë progresive dhe të mbartura në vite, regjistrimi në kontabilitet, etj).

2. Për sa i përket pretendimit se detyrimi në vlerën e 2,208,208 lekë i shoqërisë “U. T.” sha kundrejt Bashkisë Tepelenë, nuk është trajtuar nga grupi i auditimit, nuk qëndron, pasi ky detyrim është konstatuar nga vetë bashkia Tepelenë (Drejtorja e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit), detyrim i cili duhej të ishte shlyer. Aktualisht figuron si detyrim në pasqyrën e paraqitur grupit të auditimit. Grupi i auditimit auditoi realizimin e të ardhurave të institucionit, bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi dhe sipas dokumenteve të paraqitura nga Drejtorja e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, u krye auditimi për realizimin e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për lejet e ndërtimit të dhënë nga Bashkia Tepelenë, për të cilat janë


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

ndjekur procedurat ligjore për marrjen e vendimeve për leje zhvillimore ndërtimi në pronë private. Shoqëria “U.T.” sha është tërësisht me kapital shtetëror.

3. Për sa i përket pretendimit tuaj lidhur me taksën e qytetarit “Xh. N.”, ju e pranoni që qytetari është pajisur me leje ndërtimi dhe për rrjedhojë me pajisjen e qytetarit me leje ndërtimi duhej paguar edhe taksa e ndikimit në infrastrukturë të cilën e ka paguar sipas përlllogaritjeve të DPZHKT të Bashkisë, kurse grupi i auditimit ka konstatuar diferencë më pak në përlllogaritje në vlerën 43,290 lekë.

4. Për sa i përket pretendimit tuaj lidhur me taksën e qytetarit “R. T.” ju e pranoni që qytetari është pajisur me leje ndërtimi dhe për rrjedhojë me pajisjen e qytetarit me leje ndërtimi duhej paguar edhe taksa e ndikimit në infrastrukturë, të cilën e ka paguar sipas përlllogaritjeve të DPZHKT të Bashkisë, kurse grupi i auditimit ka konstatuar diferencë më pak në përlllogaritje në vlerën 782,818 lekë.

5. Për sa i përket pretendimit tuaj lidhur me taksën e qytetarit “I. H.”, edhe ju e pranoni që qytetari është pajisur me leje ndërtimi dhe për rrjedhojë me pajisjen e qytetarit me leje ndërtimi duhej paguar edhe taksa e ndikimit në infrastrukturë të cilën e ka paguar sipas përlllogaritjeve të DPZHKT të Bashkisë, kurse grupi i auditimit ka konstatuar diferencë më pak në përlllogaritje në vlerën 6,603,574 lekë.

Për sa më sipër për arsye se nuk keni argumente dhe prova të reja, kundërshtitë tuaja nuk merren parasysh.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

**Z.L. B.** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit  
(Sa më sipër është mbajtur akt konstatimi nr.9, datë 15.11.2019)

**C. Vlerësimi i Raportimit Financiar (Pasqyrat financiare)**
**Llogaritë e Aktiveve të pasqyrave financiare:**

Aktivi i bilancit për vitin 2017 dhe 2018 paraqitet në aneksin nr. xx në fund të Raportit të auditimit. Nga analiza e llogarive të pasqyrave të pozicionit financiar të viteve 2017 dhe 2018 konstatohet sa më poshtë vijon:

\*Në llogarinë 423,429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” paraqitet një vlerë prej 1,254,774 lekë e cila nuk është analizuar sipas klasifikimit kontabël, nuk është arkëtuar nga nga punonjësit dhe nuk është derdhur në buxhetin e shtetit në kohën e duhur.

**Gjetje nga auditimi.**

<b>Titulli gjetjes:</b>	Mos analizim sipas klasifikimit kontabël, mos arkëtim nga punonjësit dhe mos derdhje në buxhetin e shtetit të vlerës 1,254,774 lekë, pasqyruar në llogarinë 423,429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba”.
<b>Situata:</b>	Në Pasqyrat e Pozicionit Financiar, gjendja e llogarisë 423,429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba”, në fund të viteve 2017 dhe 2018 paraqitet e pa ndryshuar në vlerën 1,254,774 lekë, e cila përfaqëson detyrimet e punonjësve ndaj buxhetit të shtetit, për tatimin mbi pagë për vitin 2018 dhe të trashëguar ndër vite. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se; -vlera totale 1,254,774 lekë nuk është analizuar sipas klasifikimit kontabël përkatësisht: - në detyrime të vitit në vazhdim 2018 në vlerën 351,466 lekë, -në detyrime të viteve të mëparshme për vitet 2010-2013 në vlerën 903,308 lekë,


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

	<p>-e analizuar sipas periudhave detyrimi për tatimin mbi pagë është trashëguar ndër vite e konkretisht:</p> <table border="1"> <tr> <td>Viti 2018</td> <td>vlera 351,466 lekë</td> </tr> <tr> <td>Viti 2013</td> <td>vlera 382,824 lekë</td> </tr> <tr> <td>Viti 2012</td> <td>vlera 417,708 lekë</td> </tr> <tr> <td>Viti 2011</td> <td>vlera 62,436 lekë</td> </tr> <tr> <td>Viti 2010</td> <td>vlera 40,340 lekë</td> </tr> <tr> <td>Totali</td> <td>1,254,774 lekë</td> </tr> </table> <p>Kjo vlerë është trashëguar nga viti në vit dhe rezulton të jetë kontabilizuar sipas periudhave nga auditet e ndryshme si auditi i prefekturës dhe auditi i brendshëm.</p> <p>-nga drejtoria e financës nuk u është kryer ndalesa punonjësve pasi sipas sqarimeve të punonjësve të financës rezulton se një pjesë e punonjësve janë larguar nga puna dhe disa kanë dalë në pension.</p> <p>-kjo vlerë pra vlera 1,254,774 lekë duhej të ishte kryer ndalesa dhe duhej të ishte derdhur për llogari buxhetit të shtetit si detyrim për tatimin mbi pagë.</p>	Viti 2018	vlera 351,466 lekë	Viti 2013	vlera 382,824 lekë	Viti 2012	vlera 417,708 lekë	Viti 2011	vlera 62,436 lekë	Viti 2010	vlera 40,340 lekë	Totali	1,254,774 lekë
Viti 2018	vlera 351,466 lekë												
Viti 2013	vlera 382,824 lekë												
Viti 2012	vlera 417,708 lekë												
Viti 2011	vlera 62,436 lekë												
Viti 2010	vlera 40,340 lekë												
Totali	1,254,774 lekë												
<b>Kriteri:</b>	<p>-VKM nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; pika 1. Përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël, me cilësinë e sistemit kontabël të përgjithshëm, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi,standartet dhe rregullat kontabël, kapitulli IV, llogaritë e të tretëve, klasa 4.</p> <p>-UMF nr. 08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.</p>												
<b>Ndikimi/Efekti</b>	-Pasaktësi në besueshmërinë e pasqyrave financiare.												
<b>Shkaku:</b>	-Mos zbatimi i kuadrit ligjor për veprimet kontabël dhe pasqyrat financiare.												
<b>Rëndësia:</b>	-E lartë.												
<b>Rekomandimi:</b>	-Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues të marrin masa për zbatimin e procedurave ligjore për klasifikimin kontabël të llogarisë 423,429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” dhe të arkëtimit ose sistemimit të detyrimeve të parapambetura të punonjësve për tatimin mbi pagë për vitin 2018 dhe të trashëguar ndër vite në vlerën 1,254,774 lekë, gjatë hartimit të pasqyrave financiare të vitit 2020.												

\*Në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”, paraqitet vlera prej 10,516,840 lekë, e cila përfaqëson vlerat e disa projekteve për objekte të cilat kanë përfunduar punimet dhe janë marrë në dorëzim nga Bashkia dhe vlera e projektit të hartuar për këto investime, nuk i është bashkuar vlerës së investimit, por ende vazhdon të paraqitet më vete në llogarinë 202, duke paraqitur një situatë të gabuar në pasqyrat financiare.

**Gjetje nga auditimi.**

<b>Titulli gjetjes:</b>	Paraqitje e gabuar e vlerës prej 10,516,840 lekë në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”, në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2018.
<b>Situata:</b>	<p>-Në Pasqyrat e Pozicionit Financiar, gjendja e llogarisë 202 “<b>Studime dhe kërkime</b>” në fund të vitit 2017 dhe vitit 2018, paraqitet në vlerën 10,516,840 lekë, e cila përfaqëson vlerat e 9 projekteve për objekte të cilat kanë përfunduar punimet dhe janë marrë në dorëzim nga Bashkia.</p> <p>Gjatë vitit 2017 llogaria 202 “Studime dhe kërkime” është shtuar për në shumën 4,893,840 lekë, sipas objekteve të mëposhtme:</p> <p>-Hartim projekti kanali vaditës Kodër –Lekël në vlerën 818,400 lekë,</p> <p>-Hartim projekti kanali vaditës Luzat në vlerën 894,000 lekë,</p>


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

	<p>-Hartim projekti rruga Dragot-Pasarelë në vlerën 2,316,000 lekë, -Hartim projekt zbatim kanali vaditës Gusmar në vlerën 865,440 lekë. Nuk ka shtesa projektesh në kontabilitet për vitin 2018. Vlera prej 10,516,840 lekë, duhet të ishte sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit. Sipas analizës projektet, të cilat nuk duhet të ishin pjesë e llogarisë 202:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Llog</th> <th>Emërtimi</th> <th>31/12/2018</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td><b>202</b></td> <td><b>STUDIME DHE KËRKIME</b></td> <td><b>10,516,840</b></td> </tr> <tr> <td>1</td> <td>Projekt preventiv Ujësjellësi Veliqot</td> <td>375,000</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Projekt rruga Dukaj-Fushe Dukaj</td> <td>400,000</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>Projekt rruga Salari</td> <td>474,000</td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>Projekt Ujësjellësi Veliqot</td> <td>294,000</td> </tr> <tr> <td>5</td> <td>Projekt lagja 15 shtatori</td> <td>4,080,000</td> </tr> <tr> <td>6</td> <td>Hartim projekti kanal vaditës Koder-Lekel</td> <td>818,400</td> </tr> <tr> <td>7</td> <td>Hartim projekti kanal vaditës Luzat</td> <td>894,000</td> </tr> <tr> <td>8</td> <td>Hartim projekt rruga Dragot-Pasarele</td> <td>2,316,000</td> </tr> <tr> <td>9</td> <td>Hartim projekt zbatim kanali vaditës Gusmar</td> <td>865,440</td> </tr> </tbody> </table>	Llog	Emërtimi	31/12/2018	<b>202</b>	<b>STUDIME DHE KËRKIME</b>	<b>10,516,840</b>	1	Projekt preventiv Ujësjellësi Veliqot	375,000	2	Projekt rruga Dukaj-Fushe Dukaj	400,000	3	Projekt rruga Salari	474,000	4	Projekt Ujësjellësi Veliqot	294,000	5	Projekt lagja 15 shtatori	4,080,000	6	Hartim projekti kanal vaditës Koder-Lekel	818,400	7	Hartim projekti kanal vaditës Luzat	894,000	8	Hartim projekt rruga Dragot-Pasarele	2,316,000	9	Hartim projekt zbatim kanali vaditës Gusmar	865,440
Llog	Emërtimi	31/12/2018																																
<b>202</b>	<b>STUDIME DHE KËRKIME</b>	<b>10,516,840</b>																																
1	Projekt preventiv Ujësjellësi Veliqot	375,000																																
2	Projekt rruga Dukaj-Fushe Dukaj	400,000																																
3	Projekt rruga Salari	474,000																																
4	Projekt Ujësjellësi Veliqot	294,000																																
5	Projekt lagja 15 shtatori	4,080,000																																
6	Hartim projekti kanal vaditës Koder-Lekel	818,400																																
7	Hartim projekti kanal vaditës Luzat	894,000																																
8	Hartim projekt rruga Dragot-Pasarele	2,316,000																																
9	Hartim projekt zbatim kanali vaditës Gusmar	865,440																																
<b>Kriteri:</b>	<p>-VKM nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kap. II. -UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika “c”, nën pika “b”. -UMF nr. 08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.</p>																																	
<b>Ndikimi/Ef ekti</b>	<p>-Pasaktësi në besueshmërinë e pasqyrave financiare, pasi Aktivi i bilancit për llogarinë 202 “Studime dhe projekte” nuk pasqyron vlerën e saktë të kësaj llogarie, për rrjedhojë ulje e vlerës reale të investimeve të përfunduara dhe rritje artificialisht e vlerës së projekteve, deformim të dhënash për këto dy llogari.</p>																																	
<b>Shkaku:</b>	<p>-Mos zbatim i kuadrit ligjor për veprimet kontabël të llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”,</p>																																	
<b>Rëndësia:</b>	<p>-E lartë.</p>																																	
<b>Rekomandimi:</b>	<p>-Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues të marrin masa për sistemimin e llogarisë 202 “Studime e kërkime”, duke e pakësuar për vlerën 10,516,814 lekë dhe shtuar po këtë vlerë objekteve të investimeve të përfunduara. Në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, për të cilat investimet e lidhura me to nuk kanë përfunduar dhe ato të pa financuara.</p>																																	

\*Në llogarinë 210 “*Toka, Troje, Terrene*”, nuk është pasqyruar vlera e trojeve të ndërtesave si Godina e Bashkisë, Shkolla e Mesme, Shkollat 9-vjeçare, zyrat e ish Komunave, ndërtesat e shkollave në NjA, vlera e truallit dhe e godinave të regjistruar në ZRPP në pronësi të Bashkisë përkatësisht 770 m2 truall i lirë dhe 395 m2 truall dhe ndërtesëdhe vlera e trojeve të cilat me VKM janë kaluar në pronësi të Bashkisë Tepelenë, nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i trojeve.

**Gjetje nga auditimi.**

<b>Titulli gjetjes:</b>	Mos pasqyrim të vlerës së tokës truall nën objekt të ndërtesave sipas inventarit të tyre, në llogarinë 210 “ <i>Toka, Troje, Terrene</i> ”.
<b>Situata:</b>	Në Pasqyrat e Pozicionit Financiar, gjendja e llogarisë 210 “ <b>Toka, Troje, Terrene</b> ” në fund të vitit 2017 paraqitet në vlerën 6,410,630 lekë, pa ndryshime gjatë vitit, ndërsa në fund të vitit 2018 paraqitet në vlerën 7,778,488 lekë, e cila përbëhet nga vlera e parqeve dhe lulishteve në shumën 250,910 lekë, vlera për rehabilitim ambiente publike në


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

shumën 2,879,803 lekë, vlera për sistemime të ambienteve publike në shumën 3,279,917 lekë dhe shtesa gjatë vitit 2018 për këndë lojërash për fëmijë në shumën 1,367,858 lekë. Në këtë llogari nuk është pasqyruar:

-vlera e tokës truall nën objekt dhe sipërfaqe funksionale e ndërtesave të pasqyruar në llogarinë nr.212 “Ndërtime e konstruksione” si Godina e Bashkisë, Ndërtesat si: Shkolla e Mesme, Shkollat 9-vjeçare; Ndërtesat e ish Komunave sot Njësi Administrative, ndërtesat e shkollave në Njësitë Administrative, etj.

-vlera e trojeve të cilat me VKM janë kaluar në pronësi të Bashkisë Tepelenë.

-vlera e truallit të lirë, vlera e godinave së bashku me vlerën e truallit nën objekt të regjistruar në ZRPP Tepelenë, përkatësisht 770 m2 truall i lirë dhe 395 m2 truall + ndërtesë, në pronësi të Bashkisë Tepelenë, të evidentuara në vijim:

Aneksi Asete truall dhe ndërtese të regjistruara në ZRPP, të pa evidentuara në bilanc.

N r	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Sipërfaqja ( ha)	Adresa e pronësisë	Pronësi/përdorim
1	10/111	Truall	3574	0,038	Qytet Tepelenë	pronësi
2	10/127	Truall	3574	0,039	Qytet Tepelenë	pronësi
				<b>0,077</b>		
3	12/314	Godine +truall	3574	0,0281	Qytet Tepelenë	pronësi
4	12/71-n1	Godine +truall	3574	0,0114	Qytet Tepelenë	pronësi
				<b>0,0395</b>		

-gjithashtu nuk është kryer as inventarizimi dhe as vlerësimi i trojeve me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit.

<b>Kriteri:</b>	-Ligji nr.25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, neni 15, pika 1 dhe 2, -UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli IV. pika 74 dhe 96, -UMF nr. 8 datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”.
<b>Ndikimi/Efekt</b>	-Pasqyrat financiare nuk paraqesin informacion të saktë për llogarinë 210 “Toka, troje, terrene”, nuk pasqyrojnë me vërtetësi vlerën e saktë të pasurisë së njësisë vendore.
<b>Shkaku:</b>	-Mos zbatimi i kuadrit ligjor për veprimet kontabël të llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene”,
<b>Rëndësia:</b>	-E lartë.
<b>Rekomandimi:</b>	-Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues të marrin masa për sistemimin e llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene”, duke bërë që në këtë llogari të paraqitet, vlera e tokës truall nën objekte të ndërtesave të pasqyruar në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”, vlera e trojevetë cilat me Vendime të Këshillit të Ministrave janë kaluar në pronësi të Bashkisë dhe vlera e truallit të lirë dhe vlera e tokës truall nën objekt për ndërtesat e regjistruara në ZRPP si dhe të kryhet inventarizimi i trojeve me komision.


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

\*Në llogarinë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, nuk është evidentuar vlera e pyjeve dhe kullotave të regjistruar në pronësi të Bashkisë për 9.17 ha kullotë dhe 3.54 ha pyje, nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i Pyjeve dhe Kullotave me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit, nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë transferuar në bazë në VKM nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 30, shtojca me nr.28, me numër rendor nga 1(një) deri 688 (gjashtëqind e tetëdhjetë e tetë).

**Gjetje nga auditimi.**

<b>Titulli gjetjes:</b>	Mos pasqyrim në llogarinë 211 “Pyje, kullota, plantacione” të vlerës së pyjeve dhe kullotave të regjistruara në ZRPP, mos inventarizim dhe mos vlerësim pyjeve dhe kullotave.																																																								
<b>Situata:</b>	<p>Gjendja e llogarisë 211 “<b>Pyje, kullota, plantacione</b>” në vitin 2017 paraqitet me një vlerë 196,200 lekë në vitin 2018 në vlerën 196,200 lekë, pa ndryshime, e cila paraqet vlerën e pemëve dekorative sipas inventarit të kësaj llogarie.</p> <p>Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se në këtë llogari nuk është pasqyruar: -vlera e pyjeve dhe kullotave të regjistruar në pronësi të Bashkisë për 3,54 ha pyje dhe 9,17 ha kullotë sipas pasqyrës në vijim: Asete në pronësi pyll dhe kullotë, të pa evidentuara në pasqyrat financiare.</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>N r</th> <th>Numri i pasurisë</th> <th>Lloji i pasurisë</th> <th>Zona kadastrale</th> <th>Sipërfaqja (ha)</th> <th>Adresa e pronësisë</th> <th>Pronësi/përdorim</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>239/1</td> <td>Pyll</td> <td>2405</td> <td>1</td> <td>Lekël</td> <td>Pronësi</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>418</td> <td>Pyll</td> <td>2541</td> <td>2,54</td> <td>Luzat</td> <td>Pronësi</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td><b>3,54</b></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>369</td> <td>Kullotë</td> <td>1529</td> <td>0,88</td> <td>Dragot</td> <td>Pronësi</td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>391/2</td> <td>Kullotë</td> <td>1529</td> <td>0,79</td> <td>Dragot</td> <td>Pronësi</td> </tr> <tr> <td>5</td> <td>507/4</td> <td>Kullotë</td> <td>1565</td> <td>7,5</td> <td>Dukaj</td> <td>pronesi</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td><b>9,17</b></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table> <p>-vlera e pyjeve dhe kullotave të transferuara në pronësi të Bashkisë Tepelenë, sipas VKM nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 30, shtojca me nr.28, Lista e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Tepelenë, me numër rendor nga 1(një) deri 688 (gjashtëqind e tetëdhjetë e tetë).</p> <p>-nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i Pyjeve dhe Kullotave me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit.</p>	N r	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Sipërfaqja (ha)	Adresa e pronësisë	Pronësi/përdorim	1	239/1	Pyll	2405	1	Lekël	Pronësi	2	418	Pyll	2541	2,54	Luzat	Pronësi					<b>3,54</b>			3	369	Kullotë	1529	0,88	Dragot	Pronësi	4	391/2	Kullotë	1529	0,79	Dragot	Pronësi	5	507/4	Kullotë	1565	7,5	Dukaj	pronesi					<b>9,17</b>		
N r	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Sipërfaqja (ha)	Adresa e pronësisë	Pronësi/përdorim																																																			
1	239/1	Pyll	2405	1	Lekël	Pronësi																																																			
2	418	Pyll	2541	2,54	Luzat	Pronësi																																																			
				<b>3,54</b>																																																					
3	369	Kullotë	1529	0,88	Dragot	Pronësi																																																			
4	391/2	Kullotë	1529	0,79	Dragot	Pronësi																																																			
5	507/4	Kullotë	1565	7,5	Dukaj	pronesi																																																			
				<b>9,17</b>																																																					
<b>Kriteri:</b>	<p>-Ligji nr.25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, neni 15, pika 1 dhe 2,</p> <p>-UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli IV. pika 74 dhe 96,</p> <p>-UMF nr. 8 datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”.</p>																																																								
<b>Ndikimi/Efektivi</b>	-Pasqyrat financiare nuk paraqesin informacion të saktë për llogarinë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, nuk pasqyrojnë me vërtetësi vlerën e saktë të pasurisë së njësisë vendore.																																																								


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

<b>Shkaku:</b>	-Mos zbatimi i kuadrit ligjor për veprimet kontabël të llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione”.
<b>Rëndësia:</b>	-E lartë.
<b>Rekomandimi:</b>	-Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues të marrin masa për sistemimin e llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione” duke bërë që në këtë llogari të paraqitet, vlera e pyjeve dhe kullotave të regjistruara në ZRPP, si dhe të kryhet inventarizimi i tyre me komision.

Llogaritë e tjera të aktivitetit të pasqyrave financiare paraqiten në vijim:

**-Gjendja e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”** në fund të vitit 2017 paraqitet në vlerën 107,019,668 lekë dhe përfaqëson vlerën e fondeve që trashëgohen për vitin 2018, ndërkohë që më 31.12.2018, ka rezultuar për shumën 4,262,556 lekë e që përfaqëson vlerën e fondeve që trashëgohen në vitin e ardhshëm.

**-Gjendja e llogarisë 31 “Materiale”** të gjendjeve të inventarit qarkullues, në aktivet afat shkurtra, në fund të vitit 2017 paraqitet në vlerën 1,093,892 leke dhe në vitin 2018 paraqitet në vlerën 1,227,154 lekë, paraqitur me shtesë në vlerën 133,262 lekë blerje gjatë vitit, e cila përfaqëson gjendjen e materialeve në magazinë me 31.12.2018.

**-Ndryshimet në gjendjen e llogarisë 32 “Inventari i imët”** të gjendjeve të inventarit qarkullues, në aktivet afat shkurtra, në fund të viteve 2017 paraqitet në vlerën 10,339,110 lekë dhe më 31.12.2018 paraqitet me vlerë 15,071,527 lekë, ndryshimet kanë të bëjnë me shtesë inventari nga blerjet në vlerën 4,732,417 lekë. Në pasqyrën e inventarit kontabël të kësaj llogarie bashkangjitur pasqyrave financiare vlera e llogarisë 32 “Inventari i imët” të gjendjeve të inventarit qarkullues, në aktivet afat shkurtra, në fund të vitit 2018 paraqitet në vlerën 15,071,527 lekë dhe në aktiv të bilancit kjo llogari paraqitet në vlerën 15,071,527 lekë, pa diferenca.

**-Llogaria 468 “Debitor të ndryshëm”** e cila rezulton me 107,990,385 lekë për vitin 2017 dhe 112,768,592 lekë në fund të vitit 2018, sipas pasqyrës në vijim:

Vlera e debitorëve në 31.12.2017 dhe 31.12.2018, paraqitet si në vijim:

	Gjendje më 31.12.2017	Shtesa në vitin 2018	Pakësimi në vitin 2018	Gjendje më 31.12.2018
<b>Totali detyrimeve (Debitorëve)</b>	<b>107,990,385</b>	<b>5,469,195</b>	<b>690,998</b>	<b>112,768,592</b>
Detyrime qira pyje kullota		372,980		
Detyrime taksa e tarifa		3,286,040		
Detyrime urbanistika (legalizime)		211,589		
Detyrime nga Ujësjiellësi Agjent tatimor		1,598,586		
Shlyerje detyrime për taksa e tatime			545,979	
Shlyerje detyrime nga urbanistika (legalizimet)			145,009	

**-Llogaria 4342 “Operacione me shtetin”** (Të drejta) në vitin 2017 ka pasur një gjendje 36,701,445 lekë dhe në 31.12.2018 paraqitet me gjendje në vlerën 97,839,869 lekë, të cilat përfaqësojnë të drejtat për tu arkëtuar në periudhat e ardhshme.

**-Gjendja në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”** për vitin 2017, paraqitet në vlerën 386,603,415 lekë, ndërsa më 31.12.2018, rezulton 395,692,562 lekë, shtuar me një vlerë 9,089,147 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se në këtë llogari është pasqyruar vlera e objekteve si Godina e Bashkisë, Ndërtesat si: Shkolla e Mesme, Shkollat 9-vjeçare; Ndërtesat e ish Komunave sot Njësi Administrative, ndërtesat e shkollave në Njësitë Administrative, etj. Diferenca 9,089,147 lekë përkon me shtesën e vitit 2018 janë vlerat për objektet e mëposhtme:

-Rikonstruksion zyrat e bashkisë në vlerën 1,654,680 lekë,

-Ndërtim çezma publike Uji i Ftohte Tepelene në vlerën 791,316 lekë,

-Ndërtim çezma publike Nj. Administrative Lopës në vlerën 773,772 lekë,


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

- Ndërtim çezma publike Nj. Administrative Kurvelesh në vlerën 263,032 lekë,
- Rivlerësim objekti ish kinema ne vlerën 3,487,089 lekë,
- Rivlerësim objekti ish kaldaja ne vlerën 2,119,258 lekë
- Gjendja në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore”** në vitin 2017, paraqitet në vlerën 854,722,190 lekë, ndërsa më 31.12.2018, gjendja e llogarisë rezulton 960,154,390 lekë, e cila paraqet investimet e kryera ndër vite në rrjetin e infrastrukturës si rrugë dhe vepra ujore. Shtesa gjatë vitit në vlerën 105,432,200 lekë, përbëhet nga vlera e objekteve të mëposhtme :
  - Rikonstruksion rruge të brendshme në qytet në vlerën 618,000 lekë,
  - Rikonstruksion rruga “Ago Çeli” në vlerën 31,375,000 lekë,
  - Rikonstruksion rruga Pasarelë - Dragot në vlerën 56,625,000 lekë,
  - Rikonstruksion kanali ujitës Gusmar në vlerën 15,556,000 lekë,
  - Rikonstruksion kanali vaditës Dukaj në vlerën 563,800 lekë,
  - Rikonstruksion rruga Mezghoran në vlerën 694,400 lekë.
- Gjendja e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”** në fund të vitit 2017, paraqitet në vlerën 10,730,947 lekë dhe në fund të vitit 2018 rezulton në vlerën 11,320,947lekë, shtesat në këtë llogari kanë të bëjnë me, blerje kontejnerë në vlerën 414,000 lekë dhe blerje pajisje kompjuterike ne vlerën 176,000 lekë.
- Gjendja e llogarisë 215“Mjete transporti”** në fund të vitit 2017, paraqitet në vlerën 11,136,309 lekë dhe në fund të vitit 2018 paraqitet me vlerën 16,768,309 lekë, lëvizjet në këtë llogari kanë të bëjnë me blerjen e dy automjeteve, një mjet, autoveturë, në vlerën 2,500,000 lekë dhe një mjet transporti, eskavator, në vlerën 3,132,000 lekë.Në kartelën e inventarizimit kjo llogari është zbërthyer në mënyrë analitike dhe përbëhet nga 9 mjete, në vlerën 16,768,309 lekë. Amortizimi i akumuluar i kësaj llogarie është në vlerën 13,405,255 lekë.
- Gjendja e llogarisë 218“Inventar ekonomik”,** në fund të vitit 2017, paraqitet në vlerën 31,031,240 lekë dhe më 31.12.2018, rezulton në vlerën 32,671,240 lekë, ndryshimet në këtë llogari kanë të bëjnë me shtesë inventari nga blerjet në vlerën 1,640,000 lekë.

**Llogaritë e pasivit të bilancit.**

Këto llogari pasqyrohen në aneksin nr.xx në fund të raportit përfundimtar të auditimit.

\*Në llogarinë 431 “*Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa*”, nuk është analizuar sipas klasifikimit kontabël vlera 3,255,400 lekë, në detyrime të vitit në vazhdim 2018 në vlerën 351,466 lekë, detyrime të viteve të mëparshme për vitet 2010-2013 në vlerën 2,903,934 lekë dhe nuk është likuiduar në llogari të buxhetit të shtetit.

**Gjetje nga auditimi.**

<b>Titulli gjetjes:</b>	-Mos pasqyrim të saktë sipas klasifikimit kontabël të vlerës <u>3,255,400 lekë</u> , në llogarinë 431 “ <i>Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa</i> ”, dhe mos likuidim të vlerës së mësipërme në llogari të buxhetit të shtetit.
<b>Situata:</b>	-Në pasqyrat e pozicionit Financiar, gjendja e llogarisë 431 “ <i>Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa</i> ”, në 31.12.2018 paraqitet në vlerën 3,255,400 lekë, e cila përfaqëson detyrime të bashkisë ndaj buxhetit të shtetit për tatimin mbi pagë të personelit, e analizuar paraqitet si në vijim: <ul style="list-style-type: none"> <li>-vlera .....351,466 lekë, dhjetor viti 2018</li> <li>-vlera .....1,283,450 lekë, janar-dhjetor viti 2013(pjesërisht)</li> <li>-vlera .....917,708 lekë, janar-dhjetor viti 2012 (pjesërisht)</li> <li>-vlera..... 562,436 lekë, mars-dhjetor viti 2011(pjesërisht)</li> <li>-vlera..... 140,340 lekë, gusht-nëntor viti 2010.(pjesërisht).</li> </ul>




**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

	<p>Nga analiza e kasaj llogarie konstatohet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-vlera <u>3,255,400 lekë</u> nuk është analizuar sipas klasifikimit kontabël përkatësisht:</li> <li>-në detyrime të vitit në vazhdim 2018 në vlerën 351,466 lekë,</li> <li>-në detyrime të viteve të mëparshme për vitet 2010-2013 në vlerën 2,903,934 lekë.</li> </ul> <p>Gjithashtu nga bashkia nuk janë marrë masa për likuidimin e vlerës prej 3,255,400 lekë në llogari të buxhetit të shtetit, si detyrime të trashëguara dhe të pa likuiduara nga Bashkia.</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>VKM nr.783,datë 22.11.2006 “ Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; pika 1. Përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël, me cilësinë e sistemit kontabël të përgjithshëm, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi,standartet dhe rregullat kontabël, kapitulli IV, llogaritë e të tretëve, klasa 4.</p> <p>-UMF nr. 8 datë 9.03.2018 “<i>Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme</i>”.</p>
<b>Ndikimi/Efekt i</b>	-Pasqyrat financiare nuk paraqesin informacion të saktë për llogarinë 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa”, nuk pasqyrojnë me vërtetësi vlerën e saktë të detyrimeve së njësisë vendore.
<b>Shkaku:</b>	-Mos zbatimi i kuadrit ligjor për veprimet kontabël të llogarisë 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa”,
<b>Rëndësia:</b>	-E lartë.
<b>Rekomandimi :</b>	-Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues të marrin masa për sistemimin e llogarisë 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa”, si dhe të krijohen fonde për likuidimin e vlerës për llogari të buxhetit të shtetit.

\*Gjendja e llogarisë “Sigurime shoqërore dhe shëndetësore” më 31.12.2017 paraqitet në vlerën 8,981,573 lekë dhe në 31.12.2018 në vlerën 19,907,525 lekë, e cila përfaqëson detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të pa paguara. Gjatë vitit 2019 janë kryer pagesa dhe ky detyrim ka ardhur në ulje. Në datën 30.09.2019 vlera e këtij detyrime është 9,815,896 lekë, ndërsa në datën 20.12.2019, bazuar në dokumentacionin e dërguar nga njësia vendore (urdhër shpenzimet) pas fazës së projekt raportit, ky detyrim ka shkuar në vlerën **7,063,544 lekë**. Edhe pse janë marrë masa dhe është ulur konsiderueshëm ky detyrim, anomalia e mos pagesës në kohë të sigurimeve shoqërore është materiale, si në kuptimin e materialitetit sasior edhe atij cilësor.

**Gjetje nga auditimi.**

<b>Titulli gjetjes:</b>	-Mos kryerje e pagesës për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën <b>7,063,544 lekë</b> (llog.435 “ <i>Sigurime shoqërore dhe shëndetësore</i> ) dhe mos pasqyrim i saktë sipas klasifikimit kontabël i kësaj vlere në bilancin e vitit 2018.
<b>Situata:</b>	Në pasqyrat financiare, gjendja e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore dhe shëndetësore” më 31.12.2017 paraqitet në vlerën 8,981,573 lekë dhe në 31.12.2018 në vlerën 19,907,525 lekë, e cila përfaqëson detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të pa paguara. Gjatë vitit 2019 janë kryer pagesa dhe ky detyrim ka ardhur në ulje. Në datën 30.09.2019 vlera e këtij detyrime është 9,815,896 lekë, ndërsa në datën 20.12.2019, bazuar në dokumentacionin e dërguar nga njësia vendore (urdhër shpenzimet) pas fazës së projekt raportit, ky detyrim ka shkuar në vlerën 7,063,544 lekë. Edhe pse janë marrë masa dhe është ulur ky detyrim, anomalia e mos pagesës në kohë të sigurimeve shoqërore është materiale, si në kuptimin e materialitetit sasior edhe atij cilësor.


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

Vlera e pa likuiduar prej **7,063,544 lekë** i përket periudhave të prapambetura ndër vite si më poshtë vijon:

- detyrime të vitit 2010 në vlerën 1,122,342 lekë, për muajt gusht, shtator, tetor, nëntor, për 35 punonjës;
- detyrime të vitit 2011 në vlerën 1,584,683 lekë për muajt mars, prill, maj, shtator, tetor, nëntor, për 35 punonjës;
- detyrime të vitit 2012 në vlerën 2,454,508 lekë për muajt mars, prill, maj, qershor, gusht, shtator, tetor, nëntor, për 33 punonjës.
- detyrime të vitit 2013 në vlerën 1,902,011 lekë, për muajt shkurt, mars, maj, qershor, gusht, për 46 punonjës.

Sipas vendimit Nr. 90, datë 20.12.2019, të Këshillit Bashkiak Tepelenë, protokolluar në këtë bashki me nr. 1896/3, datë 23.12.2019, (një kopje e skanuar të cilit është dërguar në KLSH), është vendosur që detyrimet e mësipërme në vlerën 7,063,544 lekë të likujdohen brenda muajit shkurt 2020.

Të gjitha këto detyrime janë pjesore, pra është likujduar një pjesë e muajve të mësipërm dhe ka ngelur pa likujduar pjesa tjetër e detyrimit mujor.

- Gjithashtu nuk është kryer kontabilizimi i plotë sipas nomenklaturës së llogarive të planit kontabël publik, pasi vlera e detyrimit 19,907,525 lekë e nxjerrë në bilanc, nuk është ndarë e analizuar përkatësisht në llogarinë 435 “Sigurime shoqërore”, llogarinë 436 “Sigurime shëndetësore”, si dhe nuk është klasifikuar në: -detyrime të vitit në vazhdim (viti 2018 në vlerën 7,748,651 lekë), detyrime të vitit të mëparshëm (viti 2017 në vlerën 5,039,393 lekë dhe periudha 2010-2013 në vlerën 7,119,481 lekë).

Situata e detyrimeve

Detyrimi sipas pasqyrave financiare me

1	31.12.2018	19,907,525
2	Likujduar per periudhen janar -30 shtator 2019	10,091,629
3	<b>Detyrimi me 30.09.2019</b>	<b>9,815,896</b>
4	Likujdimet per periudhen 1 Tetor 2019-20 Dhjetor 2019	2,752,352
5	<b>Detyrimet me date 20.12.2019</b>	<b>7,063,544</b>

Keto detyrime i perkasin periudhave si me poshte:

	VITI	2010	1,122,342
	VITI	2011	1,584,683
	VITI	2012	2,454,508
	VITI	2013	1,902,011
	VITI	2014	0
	VITI	2015	0
	VITI	2016	0
	VITI	2017	0
	VITI	2018	0
	VITI	2019	0

7,063,544

**Kriteri:**

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.9136, datë 11.9.2003 i ndryshuar “ Për mbledhjen e kontributeve te detyrueshme te sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, neni 6 -Detyrimet e personave qe paguajnë kontributet, neni 11 -Afatet e deklarimit dhe te pagesës, UMF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

	vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme” dhe të VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; pika 1. Përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël, me cilësinë e sistemit kontabël të përgjithshëm, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, standardet dhe rregullat kontabël, kapitulli IV, llogaritë e të tretëve, klasa 4 -UMF nr. 8 datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”.
<b>Ndikimi/Efekti</b>	-Mos pagesa e kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetsore përveç se është në kundërshtim me kërkesat ligjore sjell anomali, për punonjësit, sidomos për ata që dalin në pension.
<b>Shkaku:</b>	-Mos zbatimi i kuadrit ligjor për pagesën e <i>sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore</i> .
<b>Rëndësia:</b>	-E lartë.
<b>Rekomandimi:</b>	Titullari i njësisë vendore dhe Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, të marrin masa të menjëhershme pagesën e detyrimeve të prapambetura për sigurime shoqërore dhe shëndetësore në vlerën <b>7,063,544 lekë</b> . Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, të marrë masa për zbatimin e procedurave ligjore për klasifikimin kontabël të llogarisë 435 “Sigurime shoqërore dhe shëndetësore”.

\*Në llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, në pasqyrat financiare nuk është sistemuar vlera 9,109,383 lekë, pasi janë detyrime të bashkisë ndaj subjekteve për garanci punimesh të kryera para vitit 2018, por bazuar në dokumentacionin e dorëzuar me imel nga njësia vendore (dokumente origjinal të skanuara), gjatë vitit 2019 janë kryer pagesa për këtë çështje nga njësia vendore dhe aktualisht ka ngelur si detyrim për tu shlyer nga fondi i ngurtësimit vetëm vlera 777,813 lekë. Ky detyrim është për operatorin ekonomik “ Sh.” SHPK, për objektin “Rikonstruksion i kanalit vaditës Gusmar”. Sipas njësisë vendore nga operatori nuk është dorëzuar certifikata e përfundimtare e punimeve, pra operatori nuk është paraqitur ende që të zhbllloket fondi i ngurtësimit për veprën e ndërtuar.

**-Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura më to”,** më 31.12.2017 paraqitet në vlerën 68,051,158 dhe në 31.12.2018 paraqitet në vlerën 31,109,492 lekë e cila përbëhet nga fatura të papaguara, nga ana e bashkisë Tepelenë, trajtuar më hollësisht në pikën B të buxhetit.

**Llogaria 421 -Personeli e llogari të lidhura** me to, për vitin 2017 ka vlerën 7,691,717 lekë, e cila i përket detyrimit për pagat e punonjësve (vlera neto) për muajin dhjetor 2017 të likuiduara në muajin janar 2018. Kjo vlerë përputhet me vlerën e përmbledhëses së listë pagesës së muajit dhjetor 2017. Për vitin 2018 ka vlerën 7,943,016 lekë, e cila i përket detyrimit për pagat e punonjësve (vlera neto) për muajin dhjetor 2018 të likuiduara në muajin janar 2019. Kjo vlerë përputhet me vlerën e përmbledhëses së listë pagesës së muajit dhjetor 2018. Kjo llogari ka një rritje prej 251,299 lekë nga viti i mëparshëm, e cila vjen si pasojë e rritjes së numrit mesatar të punonjësve.

*Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

Ligjin nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, .i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006;

Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare,

VKM nr.783, datë 22.11.2006 “ Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”;

Udhëzimin i Ministrisë Financave nr. 14 , date 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”

njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/ zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaj;

UMF nr. 08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”,

Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:*

**Z. S. K.**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar.

**Znj. M. N.**, me detyrë specialiste kontabilitetit.

*(Sa më sipër është mbajtur akt konstatimi nr.10, datë 15.11.2019)*

#### **D.1. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike.**

Nga AK Bashkia Tepelenë është hartuar regjistri i parashikimit të prokurimeve publike për vitin dhe 2017, 2018 dhe 2019, i cili për të dy vitet është raportuar në APP në sistemin elektronik si dhe në degën e thesarit.

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë më parë kërkesat nga secili sektor përfitues i mallit, punës apo shërbimit të planifikuar. Janë bërë konsultime me komunitetin për përparësinë e investimeve. Vlerat e prokurimeve janë në përputhje me buxhetin dhe të mbështetura me fonde buxhetore. Nuk ka shpenzime shume vjeçare. Për sa më sipër u krahasuan vlerat e regjistrit të prokurimeve me vlerat e miratuara në buxhet për secilin prokurim. Gjithashtu u verifikua kohëzgjatja e secilit investim. Urdhrat e prokurimit janë vulosur në thesar, përpara fillimit të procedurës së prokurimit.

Ka pasur ndryshime në regjistrin e prokurimeve në vlera dhe në numër procedurash dhe kanë qene të mbështetura me fonde buxhetore përkatëse përpara se të bëhej ndryshimi, duke u miratuar në këshillin bashkiak.

Regjistri i realizimit të prokurimeve reflekton sakte prokurimet e kryera gjate vitit.

Në Bashkinë Tepelenë për periudhën janar 2017 deri më shtator 2019 janë zhvilluar gjithsej 25 procedura prokurime me vlera të larta, me vlerë të fondit limit 279,302,254 lekë, vlerë të lidhjes së kontratave 270,185,516 lekë, diferenca midis të cilave është 9,116,738 lekë.

Janë audituar gjithsej 15 tendera (zhvillimi i procedurave të prokurimit publik së bashku me zbatimin e kontratave të punimeve) në vlerën totale të kontratës prej 245,043,939 lekë, ose 91% e vlerës së kontratave të lidhura. Për zbatimin e rregullave për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik janë audituar 11 procedura, ndërsa për zbatimin e kontratave të punimeve janë audituar 7 tendera (gjithsej 15 për shkak se disa tendera përfshijnë edhe procedurën edhe zbatimin e punimeve).

Të dhëna për procedurat e zhvilluara dhe të audituara jepen në aneksin përkatës në fund të këtij raporti të auditimit.

Në vijim jepet trajtimi i tenderave në të cilët janë konstatuar devijime nga kuadri rregullator në fuqi, përsa i përket hartimi e kriterëve dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

**Vendosje kritere të pa argumentuara në rubrikën e kapacitetit teknik, jo të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, vlerën dhe natyrën e kontratës.**

<b>Titulli</b>	<b>i</b>	Në 4 procedura prokurimi, një pjesë e kriterëve të veçanta të DST që lidhen me
<b>Gjetjes:</b>		kapacitetin teknik, nuk janë të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, vlerën dhe natyrën


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

	<p>e kontratës, si dhe nuk janë argumentuar. Në raste të veçanta nuk janë përcaktuar dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët.</p>
<p><b>Situata:</b></p>	<p>Katër rastet për të cilat kriteret e kapacitetit teknik nuk janë vendosur në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi si më poshtë vijon:</p> <p><i>1. Për procedurën e prokurimit me objekt "Sistemim asfaltim rruga Pasarele – Dragot (loti I), me vlerë të fondit limit 46,796,083 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.09.2017.</i></p> <p><u>Anomalitë e konstatuara në hartimin e DST , rubrika kapaciteti teknik</u></p> <p>Në kriteret e veçanta të DST, pika 2.5. është kërkuar: ... Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion për stafin <u>drejtues teknik</u>, të përfshirë në licensë: 1 Inxhinier Ndërtimi (profil transport- infrastrukture), 1 Inxhinier Gjeodet, 1 Inxhinier Mekanik</p> <p>Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kontratën e punës, diplomën përkatëse, librezën e punës, CV dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (IQT). Në CV-në e tyre, <u>duhet të pasqyrohet eksperiencë pune jo me pak se 5 vjet.</u></p> <p>Kriteri 5 vjet si eksperiencë pune është i pa argumentuar dhe i pa mbështetur në bazë ligjore.</p> <p>- Në kriteret e veçanta të DST, pika 2.8 është kërkuar: Operatori ekonomik duhet te ketë në stafin e tij, një person te trajnuar për: Ndihmën e pare dhe ndërhyrje ndaj emergjencave, i përfshirë në listëpagesë. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën e lëshuar nga Organizma Çertifikimi, të Akredituar.</p> <p>2.9 Operatori ekonomik duhet te ketë ne stafin e tij, një person te trajnuar: Përgjegjës per sigurinë dhe higjienën ne kantieret e përkohshme te ndërtimit, i përfshirë në listëpagesë. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e lëshuar nga organizma certifikimi të akredituar.</p> <p>Për kërkesën në pikën 2.8 dhe 2.9 të DST, në procesverbalin e mbajtur për hartimin e DST, <u>nuk është dhënë argumentim, nuk është përcaktuar baza ligjore mbi bazën e së cilës mbështeten dy kriteret e kërkuara.</u></p> <p>Në kriteret e veçanta të DST, pika 2.15. është kërkuar: Fabrika e asfaltobetonit kur është në pronësi duhet te shoqërohet me dokumentin që vërteton pronësinë e saj. Në këtë formulim <u>nuk është përcaktuar se cili është dokumentacioni i cili do të vërtetojë pronësinë</u>, duke lënë hapësira për interpretime për KVO, e duke vështirësuar punën e operatorëve ekonomik për përgatitjen e dokumentacionit për tender.</p> <p><i>Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. I. A., ekspert i jashtëm inxhinier ndërtimi, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit e cila ka hartuar DST znj. P. L., inxhinierë, me detyrë ish specialiste e urbanistikës, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, ndërprerë marrëdhëniet e punës në datën 08.07.2019, pasi anomalitë e konstatuara në hartimin kriterëve të veçanta të DST janë konstatuar në rubrikën e kapacitetit teknik të cilat janë hartuar prej tyre, bazuar në urdhrin nr. 96/1, datë 10.07.2017, “Për ndarjen e detyrave në njësisë së prokurimit.</i></p> <p><i>2-Për procedurën e prokurimit me objekt "Rehabilitim kanali ujitës Gusmar", me vlerë të fondit limit 16,906,652 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.11.2017.</i></p> <p><u>Anomalitë e konstatuara në hartimin e DST , rubrika kapaciteti teknik:</u></p>


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

Në DST, kriteret e veçanta të kualifikimit, rubrika 2.3 - Kapaciteti teknik, pika 2.3.4, janë kërkuar: 2 (dy) punonjës specialist te certifikuar dhe trajnuar për punimet në lartësi.D.P.I., Rënia nga lartësitë, Punimet skarpata dheu, etj., sipas V.K.M nr.312 date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” e dhenë nga një organizate certifikimi e akredituar shqiptar ose e huaj. Te jene me kontrate pune individuale dhe te figurojnë ne Listepagesat për te paktën 9 mujorin e fundit.

Por nga auditimi konstatohet se ky kriter nuk ka lidhje me objektin e prokurimit, pasi në preventiv nuk ka zëra që të lidhen me punimet në lartësi.

Në DST, kriteret e veçanta të kualifikimit, rubrika 2.3 - Kapaciteti teknik, pika 2.3.3 është kërkuar: Inxhinier Pyjesh 1(nje), te shoqërohen me kontrate pune, diplome përkatëse, CV dhe te jete ne liste pagesën e shoqërisë, ndërkohë që në preventive nuk ka asnjë zë punimi që të lidhet me nevojën e inxhinierit të pyjeve.

Në rubrikën e kriterëve të veçanta të DST, rubrika 2.3 - Kapaciteti teknik, pika 2.3.5 - Certifikatat që duhet të paraqesin operatori ekonomik, është kërkuar që OE të paraqesin Certifikatë të cilësisë së punimeve: Certifikatë EN-ISO 3834-2: 2006 Për sistemimin e menaxhimit te cilësisë në saldim. Gjithashtu në pikën 2.3.4 të kësaj rubrike është kërkuar që OE ofertues duhet te ketë 2 saldator. Por nga auditimi i preventivit të hartuar nga AK, konstatohet se nuk ka zëra punimesh që lidhen me nevojën e saldatorit (nuk ka proces pune saldimi) e si rrjedhim nuk është i nevojshëm as kriteri për Certifikatë EN-ISO 3834-2: 2006 -Për sistemimin e menaxhimit te cilësisë në saldim dhe as saldatori.

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi*** znj. P. L., inxhinierë, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, e cila ka hartuar DST, me detyrë ish specialiste e urbanistikës, ndërprerë marrëdhëniet e punës në datën 08.07.2019, pasi anomalitë e konstatuara në hartimin kriterëve të veçanta të DST janë konstatuar në rubrikën e kapacitetit teknik të cilat janë hartuar prej saj, bazuar në urdhrin nr. 138/1, datë 20.10.2017, “Për ndarjen e detyrave në njësisë së prokurimit”.

3. Për procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstrukcion i kanalit ujtes ne fshatrat Koder – Lekel” me vlerë të fondit limit 11,427,499 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.03.2017.

Të dhëna për tenderin:

Anomalitë e konstatuara në hartimin e DST

Në hartimin e kriterëve nuk ka përputhje midis zërit të punimeve hartuar në preventiv dhe mjeteve të kërkuara për kryerjen e këtyre punimeve. Konkretisht janë parashikuar zëra punimesh për transport materiale me kafshe, por nuk janë kërkuar në DST kafshë pune për realizimin e këtij zëri të preventivit. Në vijim paraqiten sipas preventivit të hartuar nga AK të dhëna për zërat e transportit të materialeve me kafshe:

Nr. R	Nr i analizës	Emërtimi i punimeve	Njësia	Sasia
		<b>Burimi i ujit, vepra e marrjes</b>		
9	2.37/2b	Transport materiale me kafshe, deri 2.0 km	Ton	58
		<b>Kanali nga piketa 1/6</b>		
7	2.37/2b	Transport materiale me kafshe, deri 2 km	Ton	15
		<b>Kanali nga piketa 87/179, L=945 M</b>		
11	2.37/1b	Transport materiale me kafshe, deri 1 km	Ton	260


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

		<b>Kanali nga piketa 179 / 2611, L= 1010M</b>		
9	2.37/1b	Transport materiale me kafshe, deri 1 km	Ton	135

Në rubrikën e kriterëve të veçanta të DST, -Certifikatat që duhet të paraqesin operatori ekonomik, pika 2.3.6, është kërkuar që OE të paraqesin Certifikatë të cilësisë së punimeve: Certifikatë EN-ISO 3834-2: 2006 Për sistemimin e menaxhimit të cilësisë në saldim. Gjithashtu në pikën 2.3.4 të kriterëve të veçanta të DST është kërkuar që OE ofertues duhet të ketë 2 saldator, si dhe një mekanik. Por nga auditimi i preventivit të hartuar nga AK, konstatohet se nuk ka zëra punimesh që lidhen me nevojën e saldatorit dhe mekanikut (nuk ka proces pune saldimi dhe riparim makinerinë preventiv), e si rrjedhim nuk është i nevojshëm as kriteri për Certifikat EN-ISO 3834-2: 2006 -Për sistemimin e menaxhimit të cilësisë në saldim.

Në rubrikën e kriterëve të veçanta të DST, pika 2.3.11, është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe paisjet teknike që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik. Në hartimin e këtij kriteri nuk është përcaktuar qartë se cili është dokumentacioni që duhet të paraqesin OE për plotësimin e kriterit, duke vështirësuar punën e OE si dhe punën e KVO gjatë vlerësimit të ofertave, pasi operatorë të ndryshëm paraqesin dokumentacion të ndryshëm, sepse nuk është unifikuar cili dokument duhet paraqitur.

Në rubrikën e kriterëve të veçanta të DST, pika 2.3.3, është kërkuar: Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se ka të punësuar për periudhën e realizimit të kontratës ose në stafin e tij: Inxhinier pyjesh 1(një), ndërkohë që në preventiv nuk ka zë punimi që të lidhet me nevojën e inxhinierit të pyjeve.

Në rubrikën Certifikatat që duhet të paraqesin operatori ekonomik, të kriterëve të veçanta të DST, pika 2.3.6, është kërkuar: Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë të cilësisë së punimeve: “Certifikate ISO 39001-2012 Standard për Menaxhimin e Sigurisë Rrugore”, ndërkohë që nuk po rikonstruohet rrugë, por kanal ujitës.

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi z. L. B., në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit e cila ka hartuar DST, me detyrë drejtor i drejtorisë së planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit, pasi anomalitë e konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të DST janë konstatuar në rubrikën e kapacitetit teknik të cilat janë hartuar prej tij, bazuar në urdhrin nr.18/1, datë 17.02.2017, “Për ndarjen e detyrave në njësisë së prokurimit”.***

***4.Për procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstrukcion i kanalit ujitës në fshatin Luzat” me vlerë të fondit limit 9,245,280 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.03.2017. Anomalitë e konstatuara në hartimin e DST:***

Nga auditimi konstatohet se në DST, kriteret e veçanta të kualifikimit, Rubrika 2.3 – Kapaciteti teknik, pika 2.3.2, është vendosur kriteri si vijon: Operatores ekonomike për realizimin e punimeve, objekt i kontratës duhet të disponojnë... License profesionale e shoqërisë NP-7, -Klasifikim B”

Kriteri i mësipërm është në kundërshtim me VKM nr. 42 date 16.01.2008, ”Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

ndertimi”. Klasifikimi B është i nevojshëm kur sipas preventivit të hartuar, vlera e punimeve që do të kryej operatori ekonomik fitues, për një zë punimesh apo për disa zëra së bashku që përfshihen në licencën profesionale NP-7, është nga 21 deri 50 milion lekë. Është e qartë se kërkesa për klasifikim B të licencës NP-7, nuk është në përputhje me vlerën e kontratës, pasi e gjithë vlera e kontratës (e cila ka edhe zëra jashtë fushës së mbulimit të licencës NP-7), nuk shkon në nivelin 21 milion lekë (vlera e fondit limit 9,245,280 lekë).

Bazuar në VKM nr. 42 date 16.01.2008, kreu V - Mënyra e klasifikimit të shoqërive, pika 1-Klasifikimi i shoqërive, germa (a) thuhet:

*Shoqëria vendoset paraprakisht në nivelin (klasën) e pasqyruar në lidhjen nr.4, ku përfshihet vlera e punimeve të kryera gjatë 4 viteve të fundit për kategorinë që klasifikohet. Shoqëria qëndron në të njëjtin nivel klasifikimi apo zbret në një më të ulët në varësi të pikëve që përfiton nga përvoja e drejtuesit teknik të shoqërisë për kategorinë që klasifikohet dhe pikët nga kapaciteti financiar nëpërmjet bilanceve, ...”.*

Në lidhjen 4 të VKM së mësipërme thuhet:

*Niveli i shoqërisë sipas vlerave në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi: A(edhe për herë të parë): 0- 20 milion lekë; B: 21- 50 milion lekë;*

Pra licenca NP-7, duhej e klasifikimit A.

Në DST, kriteret e veçanta të kualifikimit, Rubrika 2.3 – Kapaciteti teknik, pika 2.3.3, është kërkuar që ofertuesit të kenë në listëpagesën e tyre:

- një inxhinier mjedisi dhe një inxhinier pyjesh.

Po në këtë Rubrikë të DST, pika 1.3.4 është kërkuar:

Përveç inxhinieret te sipërpërmendur, në listëpages duhet të rezultojnë të punësuar personeli teknik i domosdoshëm për kryerjen e punimeve si:

-Saldator (2) (dy); -Mekanik 1 (një).

Gjithashtu, në këtë Rubrikë, pika 2.3.6- Certifikatat që duhet të paraqesin operatori ekonomik, është kërkuar që OE të paraqesin:

Certifikate ISO 39001-2012 Standard për Menaxhimin e Sigurisë Rrugore

Certifikat EN-ISO 3834-2: 2006 Per sistemimin e manaxhimit te cilësisë ne saldim.

Nga auditimi konstatohet se bazuar në preventivin e hartuar nga AK, nuk ka zëra punimesh për të cilat lind nevoja e inxhinierit të mjedisit, inxhinierit të pyjeve, saldatorit, mekanikut, si dhe të licencave të mësipërme të kërkuara në DST.

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi*** z. L. B., në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit e cila ka hartuar DST, me detyrë drejtor i drejtorisë së planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit, pasi anomali të konstatuara në hartimin kriterëve të veçanta të DST janë në rubrikën e kapacitetit teknik të cilat janë hartuar prej tij, bazuar në urdhrin nr. 3, datë 12.01.2017 “Për ndarjen e detyrave në njësisë së prokurimit”.

***Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:***

- pikën nr.5 të nenit 26- Kontratat për punë publike të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku thuhet:

*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*




**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

	- nenin 61 të VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” pika nr.2, ku thuhet: “2. Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim ... duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”;
<b>Kriteri:</b>	- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm: - neni 26- Kontratat për punë publike, pika nr.5; - nenin 61, pika nr.2
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos argumentimi i kriterëve, vendosja e tyre jo në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, është mos zbatim i kërkesave ligjore për hartimin e kriterëve të DST, nuk motivojnë operatorët ekonomik për pjesëmarrje në tender, duke ulur numrin e tyre në këtë proces, , e si rrjedhojë edhe konkurrencën. Mos përcaktimi i saktë i dokumentacionit për secilin kriter krijojnë vështirësi për operatorët ekonomik për përgatitjen e dokumentacionit, si dhe për KVO gjatë procesit të vlerësimit të ofertave, pasi nuk është unifikuar dokumentacioni që duhet të dorëzohet.
<b>Shkaku:</b>	Mos zbatim i kërkesave ligjore lidhur me hartimin dokumenteve standarde të tenderit.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandime:</b>	Në hartimin e kriterëve të DST, njësia e prokurimit të jap argumente për secilin kriter dhe këto argumente të bëhen pjesë e procesverbalit që mbahet prej saj. Argumentimi të bëhet duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve, etj.

**Komente nga subjekti i audituar:** Për sa më sipër janë bërë kundërshti nga z. L. B., me detyrë drejtor i drejtorisë së planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit. Në mënyrë të përmbledhur në kundërshti thuhet: Në lidhje me objektin “Rikonstruksioni i Kanalit ujitës në fshatin Kodër-Lekël” dhe objektin “Rikonstruksioni i Kanalit ujitës në fshatin Luzat”, këto 2 objekte prokurimi janë proceduar në mënyrë të përshpejtuar për shkak të udhëzimeve të ministrisë së linjës (financuesit) e cila akordoi fondin e plotë për të 2 objektet (ku në rast të mos përfundimit të procedurës së prokurimit dhe fillimit të punimeve në afat, do të tërhiqeshin fondet). Fillimisht urdhrat për prokurim në këto objekte u hartuan për t’u hedhur si një objekt i vetëm. Për shkak të auditimit në proces të KLSH dhe shoqërimit nga ana DPKZHT me përfaqësues ing. L. B. të tyre/audituesve të zbatimit të KLSH në objektet e investuara në fshatrat e largët si Lopës etj., nuk u rakordua me zyrën juridike, e cila vendosi t’i ndaje në 2 objekte të veçanta për shkak të kërkesës së zyrës së financës Tepelenë, se procedura e prokurimit në këto dy objekte duhet të zhvillohen domosdoshmërisht të ndara, për shkak të ndarjes së kodeve/llogarive të thesarit të akorduar për këto 2 investime dhe për pasojë zyra juridike gabimisht ngarkoi DST e hartuar për të dy kanalet bashkë. Nga njësia e prokurimit është diskutuar në lidhje edhe me afatet, meqenëse ky konstatim i ngarkimit të kriterëve teknike të objekteve ishte disa dite me pas shpalljes zyrtar të prokurimeve. Nga njësia e prokurimit u gjykua që mos të anulohet prokurimi (për shkak të kohës tepër të ngjeshur e delikate në limite për djegien e fondeve), por u mbajt një proces-verbal sqarues për palët e treta (Komisionin e Vlerësimit të Ofertave KVO, subjekteve të cilët do të ankoheshin apo që kërkonin sqarime).



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”

Në këtë proces verbal është sqaruar qartë situata se cilido operator që do futej dhe nuk do të dispononte licencën me kategorinë përkatëse NP7 niveli B me vlerë (21 mln. – 50 mln.), por nivelin A, nuk do të shkualifikohej, etj.

Kriteret e vendosura për të dy rastet e objekteve i janë referuar preventivit të zbatimit, projektit teknik dhe favorizimit e teknologjisë në infrastrukturën e mjeteve dhe pajisjeve të subjekteve.

Paçka në preventiv figuron zëri **transport materialesh me kafshë**, në DST nuk është kërkuar numri i kafshëve sepse do duheshin specifikime të tipit, matrikulli, masa, tipi i kafshës, fuqia, pesha etj.

Arsyeja e mos vendosjes se numrit apo specifikimeve të kafshëve për transport ka qene sepse në Dokumentet e Tenderit (DT) ka qenë pasqyruar vështirësia e objektit, por nuk mund të kushtëzohet asnjë operator i cili dispononte mjete dhe pajisje të cilat e zbatonin edhe më shpejt dhe sipas KTZ këtë zë punë.

Objektet e lartpërmendura kanë punime me tubacion çeliku si dhe intersektime me rrugët nacionale. Në rastin e objektit në Koder-Lekel hyrje-dalja për në objekt (zona e Leklit) është me fushëpamje tepër të kushtëzuar të rrugës nacionale dhe përbën rrezik potencial për aksidentet rrugore.

**Inxhinieri i pyjeve** është kërkuar si specialist meqenëse prokurimi fillestar u konceptua si një i tërë (për të dy objektet) dhe në objektin Koder-Lekel impakti i parcelave pyjore si rezultat i zgjerimit të kanalit, ishte me impakt të lartë. Për këtë kemi pasur debate me ministrinë e linjës dhe specialistet/administruesit rajonal të pyjeve.

Lidhur me kriterin e disponimit të kategorisë NP12 “Për punime mjedisore”, theksojmë se për gërmime masive ku gjurma e objektit veç duhej zgjeruar por vende-vende nuk ekzistonte për shkak të shkarjeve masive të skarpateve gjate reshjeve (rikujtojmë se objektet Kodër-Lekel dhe Luzat janë realizuar gjatë stinës së dimrit).

**Certifikata për menaxhimin e sigurisë se informacionit** është kërkuar si kriter meqenëse materialet e dorëzuara si Projekt-Preventivi i punimeve, hartat kadastrale në forme fizike dhe elektronike, duhet të ruhen dhe mos të përdoren nga palë të pa autorizuar si pasojë e ligjit për të drejtën e autorit pra të kontratës që ka Bashkia Tepelenë me subjektin projektues.

Së fundmi, për shkak të citimit të afateve për dorëzim të objekteve apo arkivimit në fund të Akt Konstatimit nr. 11 faqe 30 dhe 31, sqaromë se:

Objekti publik, pavarësisht kontratës apo çdo shtate tjetër, konsiderohet i nisur vetëm pasi të lirohet sheshi i ndërtimit pra referuar Proces-Verbalit të dorëzimit të sheshit të ndërtimit që mbahet nga Zhvilluesi/investitori në rastin konkret Bashkia Tepelenë, Mbikëqyrësit të punimeve të kontraktuar nga zhvilluesi/investitori dhe zbatuesi/sipërmarrësit të punimeve të kontraktuar nga zhvilluesi/investitori.

Dosja dërgohet në arkivin e Bashkisë nga DPKZHT, vetëm pasi është pajisur objekti me Certifikatën e Përdorimit.

**Qëndrim i grupit të auditimit:** Për sa i përket pretendimit tuaj se për licencën me kategorinë përkatëse NP7 niveli B, është mbajtur një proces verbal sqarues për palët e treta (Komisionin e Vlerësimit të Ofertave KVO, subjekteve të cilët do të ankoreshin apo që kërkonin sqarime), ku është sqaruar qartë situata se cilido operator që do futej dhe nuk do të dispononte licencën me kategorinë përkatëse NP7 niveli B me vlerë (21 mln. – 50 mln.), por nivelin A, nuk do të shkualifikohej, sqaromë se: Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është parashikuar neni 61- Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit, si dhe neni 62 - Ndryshimi i dokumenteve të tenderit. Gjithçka që ka të bëjë me kriteret e veçanta, si pjesë e DST, zgjidhet nëpërmjet këtyre dy neneve. Pra kriteret vendosen dhe janë pjesë e DST. Nëse një kriter është vendosur i gabuar, atëherë veprohet nëpërmjet ndryshimit të tyre dhe këto ndryshime bëhen përsëri pjesë e DST, shkresërisht dhe në sistemin e APP. Pra nuk mbahen procesverbale të brendshme (sikurse ju thonin, por që nuk i keni paraqitur pranë grupit të auditimit as gjatë kohës që grupi i


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

auditimit ka qenë në njësinë vendore, as bashkangjitur me kundërshtitë tuaja dërguar në KLSH). Theksojmë se në nenin nr. 55 –Kriteretepërcaktimittëofertësfituese, pika nr. 2 thuhet “Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertënfituese,nëpërputhjemeproceduratdhekriterete përcaktuaranëdokumentete tenderit. Nukduhettëpërdoret asnjëkriter,që nuk ështëpërfshirë nëdokumentet e tenderit. Pra lidhur me pretendimin tuaj se keni mbajtur një proces-verbal sqarues për palët e treta (Komisionin e Vlerësimit të Ofertave KVO, subjekteve të cilët do të ankoheshin apo që kërkonin sqarime), kjo nuk vlen, për faktin që u tha më lart (nuk është e parashiluar në legjislacion), por edhe për faktin tjetër se KVO nuk mund ti referohet këtij materiali (procesverbal),i cili nuk ështëpërfshirë nëdokumentet e tenderit, pasi nuk përdoret asnjëkriter që nuk ështëpërfshirë në DST.

Për sa i përket kundërshtisë suaj se në dy tendera e mësipërm ka qenë i nevojshëm kriteri për inxhinierin e pyjeve, për shkak se si rezultat i zgjerimit të kanalit impakti i parcelave pyjore ishte i lartë, kjo nuk qëndron. Argumentet janë dhënë në aktin e konstatimit dhe raport, por shtojmë se kur ka nevojë për zgjerim të kanalit, kjo i përket hartimit të projektit, pra hartuesi i projektit do të studiojë se në cilën anë të tij do të zgjerohet kanali. Tenderat në fjalë janë për rikonstrukcion të kanalit ujitës, që do të thotë se do të zbatojnë një projekt të hartuar më parëpër këtë qëllim.

Për sa kundërshtoni, bazuar në arsyetimet tuaja, marrim parasysht se ka qenë e drejtë kërkesa për licencën e kategorisë NP12 “Për punime mjedisore” dhe Certifikikata për menaxhimin e sigurisë së informacionit. Nuk merren parasysht kundërshtitë e tjera.

**Mos kryerja e trajnimeve për anëtarët e KVO dhe të njësisë së prokurimit**

Titulli i Gjetjes:	Mungesa e trajnimeve për KVO dhe NJP
Situata:	Nga autoriteti kontraktor Bashkia Tepelenë, nuk janë marrë masa për trajnimin e zyrtarëve të përfshirë në veprimtarinë e prokurimit publik (personave të cilët janë caktuar të kryejnë detyrën e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave dhe anëtarit të njësisë së prokurimit. Njësia vendore nuk ka paraqitur asnjë kërkesë pranë APP për trajnimin e tyre, duke mos garantuar se këta punonjës kanë aftësitë dhe përgatitjen e duhur në drejtim të njohjes së bazës ligjore në fushën e prokurimit publik, për kryerjen e detyrës së ngarkuar. Kryerja e trajnimeve është një domosdoshmëri për anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave dhe anëtarit të njësisë së prokurimit, si dhe cdo komisioni tjetër që ngrihet për kryerjen e detyravë që i ngarkohen nga titullari, pasi nëpërmjet tyre ulen rrisqet e kryerjes së gabimeve.
Kriteri:	VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 83.
Ndikimi/Efekti:	Mos kryerja e trajnimeve rrit rrishtun e gabimeve gjatë hartimit të kriterëve dhe vlerësimit të ofertave.
Shkaku:	Mos zbatim i kërkesave ligjore lidhur me trajnimet për KVO dhe NJP.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	Bashkia Tepelenë të marrë masa për trajnimin e zyrtarëve të përfshirë në veprimtarinë e prokurimit publik, duke paraqitur në cdo fillim viti pranë APP, kërkesë për trajnimin e punonjësve të cilët do të jenë të angazhuar si anëtar të KVO dhe NJP.

Nga autoriteti kontraktor Bashkia Tepelenë, nuk janë marrë masa për trajnimin e zyrtarëve të përfshirë në veprimtarinë e prokurimit publik (personave të cilët janë caktuar të kryejnë detyrën e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave dhe anëtarit të njësisë së prokurimit. Njësia vendore nuk ka paraqitur asnjë kërkesë pranë APP për trajnimin e tyre, duke mos garantuar se këta punonjës kanë aftësitë dhe përgatitjen e duhur në drejtim të njohjes së bazës ligjore në fushën e prokurimit



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”

publik, për kryerjen e detyrës së ngarkuar. Mos kryerja e trajnimeve është në kundërshtim me kërkesat e nenit 83-Manualet shpjeguese dhe trajnimi, ku thuhet:

Në fillim të çdo viti, APP-ja, në bazë të të dhënave apo kërkesave të autoriteteve kontraktore, planifikon nevojat e trajnimit të zyrtarëve të përfshirë në veprimtarinë e prokurimit publik.

Lidhur me problematikat e mësipërme, është mbajtur akt-konstatimi nr. 11, datë 15.11.2019

#### **D.2. Hartimi dhe zbatimi i kontratave të punimeve**

*1-Objekti i prokurimit: “Rikonstruksion i Rrugës “Ago Celi”, Rrugës së re dhe Rikonceptim i palestrës të lagjes “15 Shtatori”.*

**Titulli i gjetjes:** Nga auditimi mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit, u konstatuan likuidime të pakryera për punime të deklaruara të kryera nga zbatuesi i punimeve Operatori Ekonomikë “G. C.” SHPK, në vlerën **390,280 lekë pa TVSH**.

<b>Situata:</b>	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur likuidime për punime ndërtimit të pakryera, për zërat e punimeve: “FV Rrjetë plegmë Ø 6 mm çdo 20 cm për trotuaret” dhe “Punime ndërtimi për trotuarin”. Nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet dhe zërat e punës të situacionuar si dhe atyre të kryera në fakt, rezultoi se këta zëra punimesh nuk janë kryer, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën <b>390,280 lekë pa TVSH</b> .
<b>Kriteri:</b>	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.2. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me Nr. 37/1 Prot, Datë 13.03.2017.
<b>Impakti:</b>	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Tepelenë.
<b>Shkaku:</b>	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt preventivit. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: <b>Z. A. Sh.</b> , me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.
<b>Rëndësia:</b>	I lartë.
<b>Për këtë rekomandojmë:</b>	Nga Bashkia Tepelenë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej <b>390,280 lekë pa TVSH</b> nga Operatori Ekonomikë (OE) “G. C.” SHPK , në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1/1 Prot, datë 10.02.2017 me objekt “Rikonstruksion i Rrugës “Ago Celi”, Rrugës së re dhe Rikonceptim i palestrës të lagjes “15 Shtatori”, Bashkia Tepelenë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

**Shqyrtimi dhe vlerësimi i komenteve të subjektit të audituar, Bashkisë Tepelenë.**

Në zbatim në nenit 32, të Rregullores së Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit (miratuar me vendimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit Nr. 107, datë 08.08.2017 “Për miratimin e rregullores së procedurave të auditimit në kontrollin e lartë të shtetit” në observacionin e bërë nga mbikëqyrësi i punimeve z. A. Sh., me nr. prot. 1282/2/55, datë 22.11.2019 është trajtuar si vijon:

**Komente nga subjekti i audituar:** Mbikëqyrësi i punimeve nuk pranon problematikat e konstatuara për zërat e punimeve, duke sqaruar si vijon:

1. Përsa i përket zërit të punimeve, 1 (3.160/e) “Germim dheu për trup rruge + transport”, kjo nuk është e drejtë sepse në dosjen teknike janë paraqitur profili gjatësor dhe seksionet terthore sipas matjeve faktike...nisur nga fakti se paketa e shtresave në preventivin e ripunuar është 65 cm, për të bërë të mundur realizimin e këtyre shtrsave është e domosdoshme gërmimi 65 cm, kështu që nuk kemi të bëjmë me përfitim dhe arsytimi nuk qëndron.

2. Përsa i përket zërit të punimeve, 3 (An) FV Rrjetë plegmë Ø 6 mm çdo 20 cm për trotuaret dhe zërave 1(3.21); 2(3.628); 3(An); 8(3.211); 13(An) [punime ndërtimi për trotuarin], mbikëqyrësi i punimeve pretendon se në librezën e masave janë  $954.88 \text{ m}^2$  trotuar  $\times 2.22 \text{ kg/m}^2 \times 2$  zgara =  $4,2396.66 \text{ kg} = 4.2 \text{ ton}.....$  dhe përsa i përket zërave të ndërtimit në trotuar, mbikëqyrësi argumenton se sipërfaqja totale e trotuarit është  $954.88 \text{ m}^2$  dhe por kemi situacionuar dhe jemi likuiduar për sipërfaqe  $880 \text{ m}^2$  pra më pak se çështë në fakt.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Lidhur me pretendimin e ngritur nga mbikëqyrësi i punimeve, bazuar në argumentet e trajtuara në observacion (12 faqe), kundërshtitë merren pjesërisht në konsideratë dhe konkretisht:

1. Vlera prej **372,375 lekë zbritet si dëm ekonomik** për zërin e punimeve: “Germim dheu për trup rruge + transport”, me sqarimin:


- së pari, profilet gjatësore dhe terthore bashkëlidhur observacionit, nuk kanë qenë pjesë e dosjes teknike përgjatë periudhës së auditimit në subjekt, edhe pse u kërkue disa herë.

- së dyti, observacioni për këtë zë punimi, merret në konsideratë, mbështetur në profilet terthore ku duket qartë rritja e volumit të gërmimit dhe jo nga argumentimi i paketës së shtresave, sepse kjo paketë praktikisht mund të realizohet edhe pa u kryer gërmimet, por thjeshtë duke u ngritur në kuotë pa gërmuar sipas profileve terthore, pasi edhe në procesverbalet e punimeve të maskuara nuk jeni shprehur me kuota gërmimi sipas profileve terthore.

2. Argumentet e paraqitura nga mbikëqyrësi i punimeve për zërin të punimeve, 3 (An) FV Rrjetë plegmë Ø 6 mm çdo 20 cm për trotuaret, nuk qëndrojnë sepse:

- Në situacionin përfundimtar për objektin: Rikonstruksion i rrugës së re dhe rrugës “Ago Çeli” dhe rikonceptimi i palestës, në asnjë nga zërat e punimeve të seksionit, punime trotuari, nuk është reflektuar volumi prej  $954.88 \text{ m}^2$ , por volumi prej  $880 \text{ m}^2$ . Pretendimi Juaj, për punime shtesë duhet t’i kërkoni, në zbatim të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar me Ligjin Nr. 9800, datë 10.09.2007, Ligjin Nr. 9855, datë 26.12.2007, Ligjin Nr. 10170, datë 22.10.2009, Ligjin Nr.10 309, datë 22.07.2010, Ligjin Nr. 22/2012, Ligjin Nr. 131/2012, dhe Ligjin Nr. 182/2014 “Për prokurimin publik”. Si përfundim, mbas shqyrtimit të observacioneve të paraqitura nga mbikëqyrësi i punimeve, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultojnë diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e zbatimit, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **390,280 lekë pa TVSH**.

**Paraqitja e dëmit ekonomik mbas shqyrtimit të observacionit.**

	<b>KONTROLLI I LARTË I SHTETIT</b> <b>Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”</b>
---	--

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
<b>III. Punime për trotuarin</b>								
3 (An)	FV Rrjetë plegmë Ø 6 mm çdo 20 cm për trotuarët.	ton	120,000	4	4	2	2	240,000
1(3.21) 2(3.628) 3(An) 8(3.211) 13(An)	Punime ndërtimi për trotuarin	Nuk është zbritur sipërfaqja e pemëve, etj... trajtuar më poshtë						150,280
<b>Totali në lekë pa TVSH</b>								<b>390,280</b>

**2. Objekti i prokurimit: “Rikonstruksion i kanalit ujitës në fshatin Luzat NjA Qender”.**

**Titulli i gjetjes:** “Rikonstruksion i kanalit ujitës në fshatin Luzat NjA Qender”.

Nga auditimi mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit, u konstatuan likuidime të pakryera për punime të deklaruar të kryera nga zbatuesi i punimeve Operatori Ekonomik (OE) “A.” SHPK, në vlerën **825,098 lekë pa TVSH**.

<b>Situata:</b>	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: - Ka patur likuidime për punime ndërtimi të pakryera, për zërat e punimeve: “Germim shkëmbi”; “Germim kanalesh në tokë të fortë, me krahë, me seksion 0.75 m <sup>2</sup> ”; “Germim tokë e zakonshme”; “Mure betoni C 12/15” dhe “Hidroizolim tubacion dy duar bitum” dhe zëri “Veshje me beton C 16/20”. Nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet dhe zërat e punës të situacionuar si dhe atyre të kryera në fakt, rezultoi se këta zëra punimesh nuk janë kryer, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën <b>825,098 lekë pa TVSH</b> .
<b>Kriteri:</b>	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.2.
<b>Impakti:</b>	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Tepelenë.
<b>Shkaku:</b>	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt preventivit. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: <b>Znj. Xh. D.</b> , me detyrë mbikëqyrësi i kontratës së sipërmarrjes.
<b>Rëndësia:</b>	I lartë.
<b>Rekomandime:</b>	Nga Bashkia Tepelenë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej <b>825,098 lekë pa TVSH</b> nga Operatori Ekonomik “A.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me pa nr. Prot, datë 08.08.2017 me objekt “Rikonstruksion i kanalit ujitës në fshatin Luzat NjA Qender”, Bashkia Tepelenë, vlerë kjo e cila


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

**Shqyrtimi dhe vlerësimi i komenteve të subjektit të audituar, Bashkisë Tepelenë.**

Në zbatim në nenit 32, të Rregullores së Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit (miratuar me vendimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit Nr. 107, datë 08.08.2017 “Për miratimin e rregullores së procedurave të auditimit në kontrollin e lartë të shtetit” në observacionin e bërë nga mbikëqyrësi i punimeve znj. Xh. D., me nr. prot. 71, datë 22.11.2019 dhe protokolluar në KLSH me nr. 603/4 prot, datë 06.12.2019 është trajtuar si vijon:

**Komente nga subjekti i audituar:** Mbikëqyrësi i punimeve nuk pranon problematikat e konstatuara për zërat e punimeve, duke sqaruar si vijon:

1. Përsa i përket zërit të punimeve, 2 (2.47/an ) Germim shkëmbi, gabimisht në librezën e masave nuk është vënë skica e duhur dhe që përputhet me veprimet e kryera, duke sqaruar jashtë veprimeve në librezë për murin ekzistues me gjatësi 146 m.

2. Përsa i përket zërit të punimeve 3 (3.46/1 ) “Germim kanalesh në tokë të fortë, me krahë, me seksion deri 0.75 m<sup>2</sup>”, skica në librezë është vendosur gabim dhe nuk përputhet me veprimet që kryhen në librezë.

3. Përsa i përket zërit të punimeve 4 (3.45/1 ) “Germim tokë e zakonshme”, pasqyrohen gërmimet që bëhen në pjesën e mbetur të kanalit nga Pk A deri në Pk 47 dhe 10 m midis Pk 19 dhe Pk 22 me gjatësi 525.6 m + 10 m midis Pk 19 dhe Pk 22. Pra  $V=536 \text{ m} \times 0.6 \text{ m}^2 = 321.6 \text{ m}^3$ .

4. Zëri 11(3.241) “Mure betoni C 12/15” janë realizuar në segmentet Pk 26 deri PK 28 me gjatësi 84 m dhe Pk 32 + 2 m deri te Pk 35 me gjatësi 97 m. Në këtë rast për segmentin e dytë është emërtuar gabim piketa në librezën e masave .....

5. Për zërin e punimit “Zgjatja e kanalit me seksion trapezoidal i pa veshur mbas pik. 71 L= 520, Zëri (3.243/1 ) Veshje me beton C 16/20” gabimi vjen si rezultat i rrubullakimit të numrave nëprogramin ekxel.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Lidhur me pretendimin e ngritur nga mbikëqyrësi i punimeve, bazuar në argumentet e trajtuara në observacion, kundërshtitë nuk merren në konsideratë dhe konkretisht:

1. lidhur me sqarimet për zërin 2 (2.47/an ) Germim shkëmbi, argumentet nuk janë bindëse, dhe ju sqarojmë se:

- Ju pranoni se në librezën e masave keni bërë gabime në pasqyrimin e volumeve dhe se llogaritjet e volumeve në observacion nuk përkojnë me volumet që keni pasqyruar në librezë, volume të cilat janë situacionuar.

- pretendimi për murin ekzistues me gjatësi 146 ml për kanalit e ri, nuk qëndron sepse është pasqyruar një herë në librezën e masave, pra llogaritja e volumit nga Pk 22 deri në Pk 26 ( $146 \text{ ml} \times 0.95 \times 0.5 = 69.35 \text{ m}^3$ ), sa më sipër trajtuar observacioni për këtë zë punimi nuk merret në konsideratë, pra janë situacionuar më tepër  $37.43 \text{ m}^3$  germim.

2. Lidhur me zërin e punimeve 3 (3.46/1 ) “Germim kanalesh në tokë të fortë, me krahë, me seksion deri 0.75 m<sup>2</sup>”, gabimi nuk qëndron tek vendosja e skicës në librezë në mënyrë të gabuar, por në llogaritjen e volumit të gërmimit distanca e trasesë është rritur nga 230 m në 768 ml.

Në observacionin e paraqitur, thjeshtë keni rregulluar piketat dhe gjatësitë e gërmimit për të pasqyruar volumin sipas librezës dhe situacionit të likuiduar.

3. Lidhur me zërin e punimeve 4 (3.45/1 ) “Germim tokë e zakonshme”, kemi të bëjmë me pjesë dubluara gërmimesh dhe ndryshim piketash, madje keni pasqyruar edhe piketa që janë trajtuar në zërin e mësipëm të punimeve, pra në observacion nuk keni paraqitur argumente bindëse, por keni


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

rregulluar piketat dhe gjatësitë e germimit për të krijuar bindjen e realizimit të volumit të këtij zëri punimesh.

4. Lidhur me zërin 11(3.241) “Mure betoni C 12/15” në librezën e masave janë bërë gabime në llogaritjen e mureve nga Pk 33 deri Pk 35. Në observacion Ju ndryshoni piken Pk 33 në Pk 32+2 m, thjeshtë për rregulluar diferencën e konstatuar nga grupi i auditimit prej 36 ml.

5. Për zërin e punimit (3.243/1) Veshje me beton C 16/20” në seksionin “Zgjatja e kanalit me seksion trapezoidal i pa veshur mbas pik. 71 L= 520, edhe pse gabimi mund të ketë ndodhur si rezultat i rrubullakimit të numrave në programin excel, gjithsesi Ju keni librezuar dhe situacionuar tepër 3 m<sup>3</sup> beton. Sa më sipër trajtuar në observacion nuk keni paraqitur argumente të cilat vertetojnë të kundërtën e grupit të auditimit, pothuajse në të gjitha problematikat e konstatuara i trajtoni si gabime në llogaritjen e masave. Ju kujtojmë se: pasqyrimi i zërave të punimeve dhe i volumeve në librezën e masave si të realizuar pasqyrojnë faktin në objekt.

Si përfundim, mbas shqyrtimit të observacioneve të paraqitura nga mbikëqyrësi i punimeve, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultojnë diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e zbatimit, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën 825,098 lekë pa TVSH.

### 3. Objekti i prokurimit: “Rikonstruksion i qendrës së fshatit Veliqot”.

#### Titulli i gjetjes: “Rikonstruksion i qendrës së fshatit Veliqot”.

Nga auditimi mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit, u konstatuan likuidime të kryera për punime të deklaruara të kryera, nga zbatuesi i punimeve Operatori Ekonomik (OE) “A.” SHPK, në vlerën **456,518 lekë pa TVSH**.

<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ka patur likuidime për punime ndërtimi të pakryera, për zërat e punimeve: “Prishje shtresash”; “Spërkatje me emulsion bituminoz 0.5 l/m<sup>2</sup>”; “Shtresë binderi me granil gur kave 6 cm me makineri”; “Shtresë asfaltbetoni me granil gur kave, 4 cm, me makineri”.</li> </ul> <p>Nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet dhe zërat e punës të situacionuar si dhe atyre të kryera në fakt, rezultoi se këta zëra punimesh nuk janë kryer, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën <b>456,518 lekë pa TVSH</b>.</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.</li> <li>- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.2.</li> </ul>
<b>Impakti:</b>	<p>Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Tepelenë.</p>
<b>Shkaku:</b>	<p>Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt preventivit.</p> <p>Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: <b>Znj. Xh. D.</b>, me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.</p>
<b>Rëndësia:</b>	<b>E lartë.</b>




**KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

<b>Për këto rekomandojmë:</b>	Nga Bashkia Tepelenë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej <b>456,518</b> lekë pa TVSH nga Operatori Ekonomik “A.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 77/3 Prot, datë 13.06.2017 me objekt <b>“Rikonstruksion i qendrës së fshatit Veliqot”</b> , Bashkia Tepelenë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.
-------------------------------	--

**Shqyrtimi dhe vlerësimi i komenteve të subjektit të audituar, Bashkisë Tepelenë.**

Në zbatim në nenit 32, të Rregullores së Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit (miratuar me vendimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit Nr. 107, datë 08.08.2017 “Për miratimin e rregullores së procedurave të auditimit në kontrollin e lartë të shtetit” në observacionin e bërë nga mbikëqyrësi i punimeve znj. Xh. D., me nr. prot. 71, datë 22.11.2019 dhe protokolluar në KLSH me nr. 603/4 prot, datë 06.12.2019, për akt-konstatimin mbi objektin “Rikonstruksion i qendres së fshatit Veliqot” është trajtuar si vijon:

**Komente nga subjekti i audituar:** Mbikëqyrësi i punimeve nuk pranon problematikat e konstatuara për zërat e punimeve, duke sqaruar si vijon:

*Lidhur me pretendimin se punimet për këtë objekt nuk kanë filluar në kohën që është lidhur kontrata por kanë filluar më vonë sqarohet se: Punimet filluan më vonë pasi sheshi për fillimin e punimeve ishte i zënë dhe duhet të përshtatej për fillimin e punimeve, pasi këto punime nuk mund të fillonin dhe të bëheshin në ato kushte.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Lidhur me pretendimin e ngritur nga mbikëqyrësi i punimeve, bazuar në argumentet e trajtuara në observacion, kundërshtitë nuk merren në konsideratë dhe konkretisht: Lidhur me problematikën e konstatuar mbi zbatimin e punimeve, sipas grafikut të punimeve, u konstatua:

*Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se, punimet për “Rikonstruksion i qendrës së fshatit Veliqot” Bashkia Tepelenë, kanë filluar me datë 06.06.2017 dhe kanë përfunduar me datë 04.08.2017 (30 ditë kalendarike, jashtë afatit kontraktual të përcaktuar në kontratën e nënshkruar dhe grafikut të punimeve). Pra, sa më sipër, punimet kanë përfunduar 30 (tridhjetë) ditë kalendarike jashtë afatit kontraktual të përfundimit të punimeve të kontratës, sepse referuar nenit 7 “Grafiku i realizimit të punimeve” të kontratës ku përcaktohet se punimet duhet të realizohen brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës, pra punimet duhet të fillonin me datë 13.06.2017 si datë e nënshkrimit të kontratës dhe jo në datën 06.07.2017. Në dosjen teknike të zbatimit të punimeve rezultoi se, nuk është trajtuar asnjë problematikë lidhur me shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve. Pra, nuk ka shtyrje të afatit të përfundimit të punimeve të argumentuar dhe si rrjedhojë kontrata nuk është ekzekutuar brenda afateve të saj dhe operatori ekonomik “A.” sh.p.k., dhe nuk është penalizuar nga Bashkia Tepelenë. Sa më sipër trajtuar është vepruar në kundërshtim me nenin për likuidimin e dëmeve të kontratës, ku thesohet se: “Në rast të shkeljes së afatit përfundimtar të objektit siç është parashikuar në këtë kontratë, kontraktuesi detyrohet të paguajë një kamatë me tarifë ditore 4/1000 e vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por jo më pak se 25 % të vlerës së kontratës....”.*

*Si përfundim, mbas shqyrtimit të observacioneve të paraqitura nga mbikëqyrësi i punimeve, lidhur me problematikat e konstatuara mbi volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, në observacionin tuaj nuk janë paraqitur kundërshtitë, pra janë pranuar, rezultojnë diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e zbatimit si dhe penalitet për kryerje punimesh jashtë afatit të kontratës, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **456,518 lekë pa TVSH.***


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

4. Objekti i prokurimit: “Rikonstruksion i shkollave të Bashkisë Tepelenë” Bashkia Tepelenë, nuk rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera.

5. Objekti i prokurimit “Rikonstruksioni i bllokut midis rrugës Tafil Buzi dhe rrugës Bilbilenjtë”, me vlerë të fondit limit 4,166,666 lekë, vlerë tëkontratës 4,152,691 lekë, data e lidhjes së kontratës 18.05.2018, shpallur fitues OE “Sh.” SHPK.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekt i zbatimit dhe projekti i azhurnuar, Situacioni përfundimtar, Libreza e masave, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik konstatohet që:

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **149,488 lekë pa tvsh**.

<b>Titulli i Gjetjes 1:</b>	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rikonstruksioni i bllokut midis rrugës Tafil Buzi dhe rrugës Bilbilenjtë”, Bashkia Tepelenë, nga zbatuesi i punimeve OE “Sh.” SHPK, për zërat e punimeve 2.4, 2.5 dhe 2.6
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume në zërat e punimeve “Mur mbajtës beton M-200”, “Beton M-150 për fiksime bordure” dhe “FV bordura betoni 20x35 cm, çmimi”, për pasojë vlerat e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve;
<b>Kriteri:</b>	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 38/1 prot datë 18.05.2018. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 41, datë 29.05.2018. - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve sipas aktit pa nr prot, datë 12.06.2018.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Tepelenë.
<b>Shkaku:</b>	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
<b>Rëndësia:</b>	I ulët.
<b>Rekomandime:</b>	Nga Bashkia Tepelenë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 149,488lekëpa tvsh nga OE “Sh.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit


**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

në kontratën me nr. 38/1 prot datë 18.05.2018me objekt “Rikonstruksioni i bllokut midis rrugës Tafil Buzi dhe rrugës Bilbilenjtë”, Bashkia Tepelenë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Sa më sipër, është trajtuar me detaje nëaktkonstatimin nr. 17, datë 15.11.2019.

**Vlera prej 149,488 lekësh, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Tepelenë.Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

- 1) Z. E. N. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
- 2) Z. G. S. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

6. Objekti i prokurimit “Sistemim Asfaltim rruga Pasarelë – Dragot, Loti I”, Bashkia Tepelenë me vlerë të fondit limit 46,796,083 lekë, vlerë tëkontratës 46,784,793 lekë, data e lidhjes së kontratës 28.09.2017, shpallur fitues OE “C. R.” SHPK.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekt i zbatimit dhe projekti i azhurnuar, Situacioni përfundimtar, Libreza e masave, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik konstatohet që:

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **225,831 lekë pa tvsh**.

<b>Titulli i Gjetjes 2:</b>	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Sistemim Asfaltim rruga Pasarelë – Dragot, Loti I”, Bashkia Tepelenë, nga zbatuesi i punimeve OE “C. R.” SHPK, për zërat e punimeve 2.3 – 2.6 dhe 3.8.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume në zërat e punimeve “Shtresë stabilizanti 15 cm + Binder 6 cm+spërkatje 1 kg/m <sup>2</sup> +asfaltobeton 4 cm” dhe “H/betoni për mure mbajtës dhe vepra arti”, për pasojë vlerat e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve;
<b>Kriteri:</b>	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit nr. 131/1 prot datë 03.10.2017.</li> <li>- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit Nr. 112/1 prot, datë 28.09.2017.</li> <li>- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve nr. 20 prot, datë 02.02.2018.</li> </ul>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Tepelenë.
<b>Shkaku:</b>	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
<b>Rëndësia:</b>	I mesëm.
<b>Rekomandime:</b>	Nga Bashkia Tepelenë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 225,831 lekë pa tvsh nga OE “C. R.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me 131/1 prot datë 03.10.2017 me objekt “Sistemim Asfaltim rruga Pasarelë – Dragot, Loti I”, Bashkia Tepelenë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Sa më sipër, është trajtuar me detaje në aktkonstatimin nr. 18, datë 15.11.2019.

**Vlera prej 225,831 lekësh, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Tepelenë. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

1. Z. G. S. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. E. M. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

*Lidhur me këtë pikë të auditimit, ka observuar me shkresën datë 15.08.2019 mbikqyrësi i punimeve z. G. S., si më poshtë:*

**Komente nga subjekti i audituar:**

**1. Zëri 2.2. Mbushje më cakëll gurore, në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri.**  
Nuk jemi dakord me konstatimin tuaj.

**Së pari:**

Sasia e situacionuar = **5837.74 m<sup>3</sup>**

Sasia e llogaritur nga ana juaj, pa dhënë asnjë shpjegim sesi janë llogaritur është = **5376.6 m<sup>3</sup>**

Diferenca do të ishte = 461.14 m<sup>3</sup> dhe jo 470.1 m<sup>3</sup>.

**Së dyti :**

Rruga në projekt ka një profil tip:

Në profil shikohet që paketa e shtresave është: Asfalt 4 cm, Binder 6 cm, Stabilizant 10 cm, Cakëll 25 cm, Material për mbushje.

Për sa duket nga projekti, paketa e shtresave të rrugës ka një shtresë çakëlli me trashësi 25 cm, ndërkohë që në preventivin e objektit është parashikuar vetëm zëri i punës me numër 2.2 Mbushje më cakëll gurore, në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri, për këtë arsye në Librezën e masave :


**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

Shuma 1 = 717 m<sup>3</sup>, Shuma 2 = 650 m<sup>3</sup>, Shuma 3 = 493 m<sup>3</sup>, Shuma 4 = 60.50 m<sup>3</sup>

Në total = 717+650+493+60.50 = 1920.5 m<sup>3</sup>

Paraqesin shtresën e çakëllit, pjesë e paketës së shtresave .

Kurse, pjesa tjetër :

Shuma 5 = 2007.6 m<sup>3</sup>, Shuma 6 = 1820 m<sup>3</sup>, Shuma 7 = 1540 m<sup>3</sup>

Në total = 2007.6 + 1820 + 1540 = 5367.6 m<sup>3</sup>

paraqet pjesën e mbushur të rrugës, sipas çdo profili tërthor të dhënë nga rruga. Nëse profilet do të shikohen në autocad shikohet qartë se sipërfaqja e matur e hedhur në tabelën përbri profilit nuk përfshin paketën e shtresës së çakëllit, prandaj janë llogaritur si volum me vete.

Kështu në total sasia e mbushjes me çakëll është:

Shtresa e çakëllit 25 cm = **1920.5 m<sup>3</sup>**

Mbushja me çakëll matur nga profilet tërthorë = 5367.6 m<sup>3</sup>

Totali = 1920.5 + 5367.6 = 7288.1 m<sup>3</sup>, dhe sasia e situacionuar është 5837.74 m<sup>3</sup>.

Kjo tregon që sipërmarrësi i punimeve, jo vetëm që nuk ka marrë sasi më tepër për këtë zë pune, por nuk është paguar për 1450.36 m<sup>3</sup> çakëll.

**Oëndrim i grupit të auditimit:**

1. Përsa pretendoni se sasia e llogaritur nga ana jonë, është dhënë pa asnjë shpjegim sesi është llogaritur, mendojmë se shpjegimi i bërë nga ana jonë në mënyrë narrative, do të ishte i qartë për personelin inxhinierik të mbikëqyrjes (7288.1 m<sup>3</sup> total sipas librit të masave - 1911.5 m<sup>3</sup> vetëm shtresa e çakëllit 25 cm sipas librit të masave = 5376.6 m<sup>3</sup>). Megjithatë, nisur nga shqyrtimi i dokumentacionit shtesë bashkëlidhur observacionit, ky argument merret në konsideratë dhe do të reflektohet në tabelën e dëmit ekonomik.

**Komente nga subjekti i audituar:**

**Zëri 2.3-2.6 . Shtresë stabilizanti 15 cm + Binder 6 cm + spërkatje 1kg/m<sup>2</sup>+ asfaltobeton.**

Nuk jemi absolutisht dakord për këtë konstatim tuajin, pasi hyrja në Beçisht është 156 m<sup>2</sup>, e megjithatë sipërmarrësi në Libreza masash e ka lenë 150 m<sup>2</sup>, duke lenë hapësira për rezervën e gabimit që mund të jetë bërë në matje. Sip =  $\frac{(14+7)}{2} \times 6.5 + \frac{(7+4)}{2} \times 16 = 68.25 \text{ m}^2 + 88 \text{ m}^2 = 156.25 \text{ m}^2$ .

Prandaj nuk jemi dakord me konstatimin tuaj, përsa kojë që në verifikimin e objektit nuk kemi qënë prezent. Ndërkohë që kjo sipërfaqe është verifikuar nga të gjithë personat përgjegjës për marrjen në dorëzim të këtij objekti.

**Oëndrim i grupit të auditimit:**

2. Së pari, verifikimi i këtij objekti është bërë në prezencën tuaj dhe fakti që ju shkruani të kundërtën, tregon papërgjegjshmëri në hartimin e observacionit.

- Së dyti, edhe nga shqyrtimi i pretendimeve tuaja të sjella nëpërmjet observacionit, ky argument nuk merret në konsideratë, për arsyet se nga matjet në vend në praninë tuaj, kjo sipërfaqe është Sip =  $\frac{(10+6)}{2} \times 6 + \frac{(6+4)}{2} \times 10 = 48 \text{ m}^2 + 50 \text{ m}^2 = 98 \text{ m}^2$ .

**Komente nga subjekti i audituar:**

**Zëri 3.8 . H/betoni për mure mbajtës dhe vepra arti.**

Në preventivin bazë sasia e këtyre zërave është 2.8 ton. Në preventivin e rishikuar situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 4.64 ton. Edhe në librin e masave, ky zë pune figuron në sasinë 4.64 ton, nga të cilat 0.77 ton është marrë dy herë tek muri mbajtës ( 48 shufra D=12 dhe l = 18 m). për pasojë vlera e kësaj difference (0.77 ton ) është përfutur padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Në fakt në këtë seksion në librezën e masave është e vertet që ka lapsus në llogaritjen e hekurit të murit, por jo në masën që keni nxjerrë ju.


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

*Pra, duket qartë se gabimi në llogaritjen e hekurit është vetëm 0.245 ton, e përkthyer në lekë: 0.245 ton x 106741 lekë = 26,151 lekë.*

**Oëndrim i grupit të auditimit:**

*3. Nisur nga shqyrtimi I dokumentacionit shtesë bashkëlidhur observacionit, ky argument merret në konsideratë, pasi është vendosur gabim peshë/ml e hekurit me  $d=14$  mm dhe do të reflektohet në tabelën e dëmit ekonomik.*

Objekti i prokurimit “Rehabilitim i kanalit ujitës Gusmar”, Bashkia Tepelenë, me vlerë të fondit limit 16,906,652 lekë, vlerë të kontratës 16,899,033 lekë, data e lidhjes së kontratës 04.12.2017, shpallur fitues OE ““Sh.” SHPK.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekt i zbatimit dhe projekti i azhurnuar, Situacioni përfundimtar, Libreza e masave, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik konstatohet që:

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **357,264 lekë pa tvsh.**

<b>Titulli i Gjetjes 2:</b>	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rehabilitim i kanalit ujitës Gusmar”, Bashkia Tepelenë, nga zbatuesi i punimeve OE “Sh.” SHPK, për zërat e punimeve I.3, I.4 dhe I.5.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume në zërat e punimeve “Gërmim dheu me eskavator me zinxhirë 0.25m <sup>3</sup> , pk 31-pk.55”, “Brez betoni C 16/20” dhe “Beton për veshje”, për pasojë vlerat e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve;
<b>Kriteri:</b>	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit pa nr. prot datë 04.12.2017. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit nr. 159/1, datë 07.12.2017. - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Tepelenë.
<b>Shkaku:</b>	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
<b>Rëndësia:</b>	I mesëm.


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

<b>Rekomandime:</b>	Nga Bashkia Tepelenë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 113,600lekë pa tvsh nga OE “M.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 2053 prot datë 12.12.2017 me objekt “Rehabilitim i kanalit ujitës Gusmar”, Bashkia Tepelenë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.
---------------------	---

Sa më sipër, është trajtuar me detaje në aktkonstatimin nr. 19, datë 15.11.2019.

**Vlera prej 357,264 lekësh, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Tepelenë. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

1. Znj. R. N. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. A. K. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara.

**E. Zbatimi i rekomandimeve.**

<b>Titulli Gjetjes:</b>	<b>i</b> Mos detajim i detyrimeve sipas natyrës së tyre
<b>Situata:</b>	<p>Bashkia Tepelenë është audituar nga KLSH në vitin 2016 dhe me shkresën nr. 1231/21, datë 30.04.2017 i janë dërguar subjektit të audituar rekomandimet të cilat janë pranuar plotësisht. Në vitin 2017 nga KLSH është bërë verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të mëparshme dhe me shkresën nr. 1153/40 datë 31.01.2018 i janë rikërkuar rekomandimet të cilat nuk janë zbatuar në respektim të Vendimin Nr. 3 datë 29.01.2018 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Rezultoi se bashkia Tepelenë ka nxjerr Urdhrin Nr. 24/1 datë 13.02.2018 me të cilin ka miratuar programin e zbatimit të masave të rikërkua e përcjell në KLSH me shkresën nr.114/1, datë 16.02.2018, brenda afatit ligjor (20 ditor).</p> <p>Nga KLSH janë rekomanduar 11 masa organizative nga të cilat 10 masa janë zbatuar dhe 1 masa (Nr. 6) nuk është zbatuar masë e cila është rikërkuar me Vendimin Nr. 3 datë 29.01.2018. si dhe janë rekomanduar 31 masa për shpërblimin e dëmit në shumën prej 74,906,000 lekë të cilat janë pranuar 100% . Nga këto dy masa në shumën 2,203,000 lekë (masa B. 6-7) janë arkëtuar shumat përkatëse; 4 masa në shumën 9,847,000 lekë janë zbatuar por ende nuk është bërë arkëtimi; 16 masa në shumën 5,176,000 lekë janë kryer të gjitha veprimet administrative dhe janë në proces arkëtimi; 3 masa në shumën 8,715,000 lekë i përkasin detyrimeve ndaj ish-këshilltarëve, të lilat janë anuluar nga KLSH dhe 5 masa në shumën 48,544,000 lekë janë në proces hetimor e gjyqësor. Gjendja aktuale paraqitet si më poshtë:</p> <p>Masat Organizative</p> <p>Rekomandimi nr. 6. Ky rekomandim konsiderohet i pa zbatuar pasi nga verifikimi i dokumentacioni të vënë në dispozicion rezultoi se në zbatim të rekomandimi (Nr 6.) është nxjerr urdhërin nr. 24/1 datë 13.02.2018, ku është përcaktuar dhe personi përgjegjës për plotësimin e dokumentacionit znj. P. L. e cila nuk ka kryer veprime për</p>


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

plotësimin e dokumentacionit të dosjeve teknike të investimeve gjatë procesit të zbatimit të kontratave deri në dorëzimin e objektit.

**Masa Shpërblim Dëmi**

Nga verifikimi i dokumentacioni të venë në dispozicion rezultoi se;

Rekomandimi nr.(9-11-13-14-16-18-19-20-21-22-23-24-25-26-27-28-29-30-31) në vlerën totale 9,106,270 lekë, janë në proces pasi nga ana e bashkisë Tepelenë është nxjerrë urdhëri nr.79 datë 18.05.2017, për kontabilizimin e detyrimeve të konstatuara nga KLSH, kontabilizimin muaji maj 2017 duke u regjistruar në llogarinë 486, si dhe janë kryer njoftimet në baze të shkresës nr. 87 datë 25.05.2017 dhe ende nuk është bërë arkëtimi i vlerave përkatëse.

Rekomandimi nr. (1-2-3-5-15) në vlerën totale 46,209,883 lekë, janë në proces pasi nga ana e bashkisë Tepelenë është nxjerrë urdhri nr.79, datë 18.05.2017, për kontabilizimin e detyrimeve të konstatuara nga KLSH kontabilizimin muaji maj 2017 duke u regjistruar në llogarinë 486, si dhe janë nxjerr urdhrat për shpërblim dëmi dhe ndodhen në proces gjyqësor në mbështetje të shkresave nr. nr.935, datë 20.07.2017, shkresës nr. 765/1 datë 16.06.2017, shkresës nr. 667 prot EP datë 06.07.2017. Gjithashtu rezultoi se nga subjekti “SH.

” shpk është arkëtuar vlera 765,621 lekë duke ngelur pa u arkëtuar vlera prej 13,131,537 lekë si dhe nga subjekti “R.” shpk është arkëtuar Vlera 870,045 leke dhe ka mbetur pa u arkëtuar vlera prej 6,429,393 lekë.

Rekomandimi nr. 4. në vlerën totale prej 5,917,096 lekë. u konstatua se ky rekomandim konsiderohet në proces pasi nga ana e Bashkia Tepelenë dhe DTTV është dërguar urdhër bllokimi në bankat e nivelit të dytë me shkresë nr.1185, datë 18.09.2017 është dërguar urdhër bllokim i llogarive bankare për të gjithë subjektet taksapagues. Për ZVRPP Tepelenë me shkresë nr.1193, datë 20.09.2017 është dërguar urdhër për vendosje barrë siguroese (për pasuritë) e subjekteve taksapagues dhe për DRSHT Gjirokastër me shkresë nr.1193/1, datë 20.09.2017 është dërguar urdhër për vendosje barrë siguroese (për mjetet) e subjekteve taksapagues.

Njoftimi i departamentit të administratës publike dhe komisionarit të mbikëqyrjes të shërbimit civil:

Nga verifikimi u konstatua se ky rekomandim është i pa zbatueshem, pasi me Urdhrit nr. 24/1 datë 13.02.2018 është caktuar dhe personi përgjegjës për njoftimin e Departamentin e Administratës Publike dhe Komisionarin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në lidhje me masat e rekomanduara nga KLSH me shkresën nr. 1153/40 datë 31.01.2018. nga dokumentacioni i venë në dispozicion rezultoi se me VKB nr. 30 datë 28.07.2017, për 2 punonjës është vendosur të mos aplikohet rekomandimi i mësipërm, ndërsa për 4 punonjësit e tjerë respektivisht z. P.H. dhe z. R. K. janë larguar me dëshirë nga administrata e Bashkisë Tepelenë, z. L. H. ka nderuar jetë dhe z. S. S. ka mbushur moshën e pensionit.

I kërkohet titullarit të bashkisë të zbatojë menjëherë Vendimin e APP nr. 84 datë 06.11.2017 për 11 punonjës, respektivisht masat administrative me gjobë. Nga verifikim rezultoi se: nga Agjencinë e Prokurimit Publik është dërguar shkresa me nr. 6651/8 prot, datë 06.11.2017 dhe është protokolluar në Bashkinë Tepelenë, nr.1413 prot datë 07.11.2017. Nga ana e Bashkisë Tepelenë nuk është ndërmarr asnjë veprim për kontabilizimin e detyrimeve sipas vendimit Nr. 84 datë 06.11.2017 në vlerën totale. 1,900,000 lekë si dhe nuk janë kryer veprime të tjera ligjore për nxhierjen e Urdhërit.

D-Masa administrative:




**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**
**D.1. Për inspektoratin e mbrojtjes territorit vendor (IMTV)**

Nga KLSH është rekomanduar Bashkia Tepelenë të merren masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402 dt. 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, t’i kërkojë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të vendosë masë administrative me gjobë në masën 500,000 lekë për Ing. Redi Struga (nën cilësinë e përfaqësuesit ligjor të firmës “I.” Shpk (firma hartuese e projekt preventivit), për shkeljet e konstatuara si më poshtë:

- Në procedurat e hartimit të preventivit të fondit limit me objekt: “Rikonstruksioni i Hyrjes “Ali Pasha”, Vazhdimi i Shëtitores Përgjatë Kalasë dhe Rikonceptimi i Rrugës Batalioni “Baba Abaz”, Bashkia Tepelenë,

Nga verifikimi u konstatua se ky rekomandim konsiderohet i në proces; pasi nga Bashkia Tepelenë në lidhje me këtë rekomandim, nga IMTV me vendimin nr.1, datë 16.05.2017 “Për dënim me gjobë”, është gjobitur subjekti “I.” shpk për kundërvajtje administrative për rritje fiktive të çmimeve, jo në përputhje me manuali teknik, gjatë hartimit të projektit e preventivit për rrugën “Batalioni baba Abaz” e cila referuar fletë konatbilizimit muaji maj 2017 shuma e mësipërme është kontabilizuar në ditarin e veprimeve të ndryshme. Përsa i përket detyrimit që rrjedh nga Vendimi nr. 1 datë 16.05.2017 nuk është kryer asnjë veprim tjetër ligjor për kthimin e vendimit në titull egzekutiv si dhe nuk është bërë arkëtimi i vlerës së gjobës.

**E. HEQJE LICENCE:**

Mbështetur në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në VKM nr. 759, datë 12.11.2014 “Për Licencimin Profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit” dhe në nenet 13, 25 dhe pika 1/a, 1/e, e nenit 41, Kreu VI-të, “Sanksione dhe Dispozita kalimtare”, të “Rregullore për Kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe subjekte juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit”, për shkelje të ligjshmërisë në zbatimin e punimeve, në fushën e ndërtimit, i rekomandojmë Komisionit të Licencave, pranë Ministrisë të Zhvillimit Urban: Heqjen e së drejtës për ushtrimin e aktivitetit ose pezullimin e përkohshëm në zbatim (heqjen e Licencës profesionale), për një afat deri nga 2-3 vjet, si më poshtë:

1-R.bS. (nën cilësinë e përfaqësuesit ligjor të firmës “I.” Shpk (firma hartuese e projekt preventivit);

Lidhur me dëmin ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit dhe njësisë së qeverisjes vendore si pasojë e mangësive të theksuara gjatë hartimit të preventivit në objektin:

“Rikonstruksioni i Hyrjes “Ali Pasha”, Vazhdimi i Shëtitores Përgjatë Kalasë dhe Rikonceptimi i Rrugës Batalioni “Baba Abaz”, Bashkia Tepelenë. Nga auditimi i dokumentacionit teknik mbi hartimin e projektit të zbatimit dhe preventivit të punimeve të ndërtimit, të administruara në dosjen teknike rezulton se janë preventivuar tepër fond limit, si pasojë e rritjes fiktive të çmimeve të krahasuar me manualin teknik të çmimeve, në kundërshtim me, aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë fushën e kontrollit dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, fushën menaxhimit financiar dhe kontrollit, dhe fushën e prokurimit publik, duke i shkaktuar buxhetit të Bashkisë Tepelenë dëm ekonomik në vlerën në 11,817,467 lekë pa tvsh.

Më konkretisht si më poshtë:


**KONTROLLI I LARTË I SHETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

1. “Rikonstruksioni i Hyrjes “Ali Pasha”, Vazhdimi i Shëtitores Përgjatë Kalasë dhe Rikonceptimi i Rrugës Batalioni “Baba Abaz”, Bashkia Tepelenë.

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike nr. - prot., datë - të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Tepelenë përfaqësuar nga kryetari z. T. P. dhe operatorit ekonomik “G. C.” Shpk, me përfaqësues ligjor z. P. B.. Shoqëria “G. C.” Shpk, me Nipt J.....V. Vlera e kontratës bazë është 122,999,961 lekë pa tvsh ose 147,599,953 lekë me tvsh.

Mbi hartimin e fondit limit:

Diferenca midis fondit limit dhe vlerës së kontratës të lidhur midis palëve, për këtë objekt është 1,987,033 lekë pa tvsh ose 1.59 % më pak se fondi limit.

Nga auditimi i dokumentacionit teknik mbi hartimin e projekt - preventivit të punimeve të ndërtimit, të administruara në dosjen teknike rezulton se:

- Janë preventivuar më tepër fond limit në vlerën 13,804,500 lekë pa tv.sh, nga të cilat 11,817,467 lekë pa tvsh (13,804,500 -1,987,033), përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si pasojë e rritjes fiktive të çmimeve jo në përputhje me manualin teknik të çmimeve gjatë hartimit të projekt-preventivit të objektit: “Rikonstruksioni i Hyrjes “Ali Pasha”, Vazhdimi i Shëtitores Përgjatë Kalasë dhe Rikonceptimi i Rrugës Batalioni “Baba Abaz”, Bashkia Tepelenë.

Diferenca e mësipërme ka ardhur si pasojë vendosjes së çmimeve mbi ato të manualit teknik të çmimeve në fuqi si dhe vendosja në analizë e çmimeve mbi ato të çmimeve të marra nga ofertuesit pas sondazheve të kryera në treg. Si rrjedhojë e veprimeve të mësipërme fondi limit është rritur për vlerën 13,804,500 lekë pa tvsh.

Nga hartuesi i projekt preventivit ing. R. S., është vepruar në kundërshtim me:

- Ligjin nr., 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu I, neni 3.

- Vendimin Nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit, ndryshuar me vendim nr. 664, datë 26.09.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 514, datë 15.08.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, e konkretisht pika 2, 3 dhe 9.

2- Ing. Gj. M. (nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve); Lidhur me dëmin ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit dhe njësisë së qeverisjes vendore si pasojë e mangësive të theksuara gjatë zbatimit të kontratës për investime në objektin:

“Ndërtim i Ujësjellësit me Vetërrjedhje Bençë-Veliqot”, ish-Komuna Qendër, Tepelenë. Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolauditimit të punimeve të ndërtimit rezultojnë diferenca në volume pune të pakryera dhe përfitim më tepër në vlerën 7,299,438 lekë pa tvsh.

Më konkretisht si më poshtë:

1. “Ndërtim i Ujësjellësit me Vetërrjedhje Bençë-Veliqot”, ish-Komuna Qendër, Tepelenë.

Kontrata me mbikëqyrësin e punimeve mungon në dosjen teknike të objektit.

Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolauditimit të punimeve të ndërtimit rezultojnë diferenca në volume pune të pakryera dhe përfitim më tepër në vlerën 7,299,438 lekë pa tvsh.

Është vërejtur cilësi e dobët e punimeve të zbatuara në kundërshtim me kushtet teknike të zbatimit. Nuk është zbatuar projekti i zbatimit i parashikuar për ndërtimin e veprës.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”

Depoja e furnizimit me ujë për fshatin ndodhet në një kuotë më të ulët së ajo e vetë fshatit, duke e bërë atë totalisht jo funksionale. Gjithashtu sipërmarrësi i punimeve nuk ka respektuar dimensionet e projektit, duke e kthyer atë nga konfiguracion me bazë rrethore, në konfiguracion me bazë drejtkëndore. Gjithashtu janë konstatuar mangësi në dokumentacion si dhe problematikat si më poshtë:

#### I. Mangësi në dokumentacion:

Konstatohet se në dokumentacionin teknik mungojnë:

Certifikatat e cilësisë për materialet e përdorura në objekt;

Mungojnë provat me ngarkesë në lidhje me ujësjellësin;

Mungon pasqyra e realizimit të punimeve sipas formatit tip;

Mungon dokumentacioni për masat e sigurimit teknik dhe pajisjen me mjetet mbrojtëse përkatëse;

Kontrata me mbikëqyrësin e punimeve;

Kontrata me kolaudatorin e punimeve.

#### II. Mangësitë në zbatimin e punimeve:

Konkretisht janë përfituar nga sipërmarrësi “R.” Shpk më tepër në vlerë, duke i shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të shtetit 7,299,438 lekë pa tvsh për punime të pakryera.

- Vlera 7,299,438lekë pa tvsh si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore. Kjo vlerë ka ardhur si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera por të situacionuara e të pasqyruara në librezën e masave, mosrespektimit të projektit të miratuar si dhe ndryshimin e zërave të punës pa marrë miratimin e projektuesit. Këto veprime janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve, neni 23, pika 23.2 në kontratën me për punë publike nr. - prot., datë 11.12.2014 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor ish-Komuna Qendër, Tepelenë përfaqësuar nga ish-kryetari z. R. R. dhe operatorit ekonomik “R.” Shpk, me përfaqësues ligjor z. Nj. P..

Nga mbikëqyrësi i punimeve Ing. Gj. M. është vepruar në kundërshtim me:

-ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7.

-udhëzimin e KM nr.3, datë 15.02.2001 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të KM “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 3.2 e 3.3.

-me kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetin Kontraktor ish-Komuna Qendër, Tepelenë ku përcaktohen Detyrimet e mbikëqyrësit.

Nga verifikimi u konstatua se ky rekomandim është i pa zbatuar; pasi nga IMTV në bashkia Tepelenë për sa i përket masës së rekomanduar “heqje licence” nuk ka evidentuar dhe nuk ka pasqyruar asnjë lloj relacioni për masën e rekomanduar, ndërkohë që këta subjekte janë penalizuar me masën administrative gjobë në shumën 500,000 lekë e kontabilizuar nga bashkia veprime të cilat bihen në kundërshtim të nenit 15, shkronja (j) dhe nenit 30 pika 2, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit” për veprime dhe mosveprime ngarkohet me përgjegjësi z. G. M. me detyrë inspektor në IMTV.

G.2.Për Njësinë e Auditit të Brendshëm të Bashkisë Tepelenë.

Në zbatim të nenit 15, shkronja (i) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe nenit 25 të ligjit nr.


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

	<p>114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Tepelenë së bashku me specialistë të fushës, në bazë të një programi auditimi të miratuar nga Titullari i Bashkisë, të auditojë më tej, të gjitha gjetjet e konstatuara të evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH, përfshi dhe ato zëra punimesh të cilat nuk janë evidentuar për shkak të terrenit të vështirë, për zbatimin e punimeve sipas kontratës nr. ska, datë 11.12.2014 me vlerë 28,792,967 lekë pa tvsh, lidhur ndërmjet ish-kryetarit të komunës Qendër z. R. R.e operatorit ekonomik “R.” shpk, për objektin: “Ndërtimi Ujësjiellësit me vetërrjedhje Bënçë-Veliqot”, kolauduar më datën 20.04.2015 dhe marë në dorëzim më datën 12.05.2015.</p> <p>Për përfundimin e rezultateve të auditimit brenda datës 20.05.2017 të njoftohet edhe Kontrolli i Lartë i Shtetit.</p> <p>Nga verifikimi u konstatua se ky rekomandim është i pa zbatuar pasi në mbështetje të urdhrit nr. 24/1 date 13.02.2018 “Për zbatimin e detyrave të rikërkuara” është ngarkuar njësia e auditimit të brendshëm për kryerjen e auditimit për objektin: “Ndërtimi i Ujësjiellësit me vetërrjedhje Benc - Veliqot”, mbi gjetjet e konstatuara dhe evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH, përfshir edhe ato zëra punimesh të cilat nuk janë evidentuar për shkak të terrenit të vështirë”. Për auditimin në objektin “Ndërtimi i ujesjiellësit me vetërrjedhje Benc-Veliqot”, me urdherin nr. 28 date 27.02.2018, është ngritur grupi i punës i përbërë nga: znj. A. S. me detyrë përgjegjëse e Auditimit të Brendshëm, z. F. K. me detyrë auditues, z. L. B. me detyrë Drejtor i Planifikimit Urban dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, znj. P. L. me detyrë specialiste në Planifikimit Urban dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, z. V. P. me detyrë teknik në Planifikimit Urban dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, z. M. Sh. me specialist i Tokës dhe Ujërave, znj. B. Xh. me detyrë specialist në sektorin e Mjedisit Turizmit Energjisë.</p> <p>Grupi i punës nuk ka zbatuar urdhërin e mësipër të titullarit të njësisë vendore. Nga grupi i punës në respektim të afatit të auditimit, respektivisht nga data 10.05.2018-10.06.2018 të percaktuar në programin e punës, nuk është paraqitur asnjë relacion teknik apo dokumenta justifikues për mos kryerjen e detyrës të ngarkuar sipas urdhërit të mësipërm të kryetarit të bashkisë. Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi të gjithë anëtarët e grupit të punës (si më lartë) dhe bihen në kundërshtim me urdhërin e mësipërm të titullarit, nenin 64 të ligjit 139 datë 17.12.2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” dhe nenet 15, shkronja (j) dhe nenit 30 pika 2, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.</p>
<b>Kriteri:</b>	Veprim në shkelje të nenit 15, shkronja (j) dhe nenit 30 pika 2, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit” dhe shkresën nr. 256/12 datë 05.07.2017 “Për zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Tepelenë”, shprehur në Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 3, datë 29.01.2018.
<b>Ndikimi</b>	Mos ndjekje të procedurave në arkëtimin e detyrimeve sipas planit të veprimit nr. 24/1 datë 13.02.2018.
<b>Shkaku:</b>	Përgjegjësi e strukturave drejtues dhe e grupit të punës sipas urdhrit Nr. urdhëri nr.79 datë 18.05.2017 dhe shkresës nr. 87 datë 25.05.2017
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandim</b>	Kryetari i Bashkisë Tepelenë të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për rizbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara dhe të rikërkuara të


**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

KLSH në auditimin e mëparshëm, dërguar nga KLSH me shkresën Nr. 1153/40 prot datë 31.01.2018, respektivisht:

**Komente nga subjekti i audituar:** Për sa më sipër me shkresën nr. 1282/22 datë 22.11.2019 (të dhëna të subjektit), janë bërë kundërshti nga znj. A. S. me detyrë përgjegjëse e auditit të brendshëm, ku në mënyrë të përmbledhur thuhet:

Në mbështetje të urdhrin nr. 24/1 date 13.02.2018 “Për zbatimin e detyrave të rikërkua”, është ngarkuar për kryerjen e auditimit për objektin: “Ndërtimi i ujësjellësit me vetërrjedhje Benc - Veliqot” me operatorin ekonomik “R.” shpk, mbi gjetjet e konstatuara dhe evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH, përfshirë edhe ato zëra punimesh të cilat nuk janë evidentuar për shkak të terrenit të vështirë”, njësia e auditimit të brendshëm. Me urdhrin nr. 28 date 27.02.2018 është ngritur grupi i punës për auditimin e objektit “Ndërtimi i ujësjellësit me vetërrjedhje Benc-Veliqot”, ku janë përcaktuar personat përgjegjës për kryerjen e verifikimit në teren. Nga ana ime si audituese e brendshme janë marrë masat për procedurat e auditimit sipas Manualit të Auditimit miratuar me urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 100 datë 25.10.2016, që nga njoftimi, deklarata e pavarësisë së auditimit, hartimi i programit të punës nr. 646 datë 07.05.2018 dhe ndarja e detyrave, ku janë përcaktuar qartë detyrat e përcaktuara për gjithsecilin. Detyra ime ishte hartimi i raportit dhe raportit final, duke mbledhur materialet nga specialistët përkatës. Theksoj se nga grupi i punës në respektim të afatit të auditimit, respektivisht nga data 10.05.2018-10.06.2018 të përcaktuar në programin e punës, nuk është paraqitur asnjë relacion teknik apo dokumente justifikues për mos kryerjen e detyrës të ngarkuar sipas urdhrin nr. 28 datë 27.02.2018 të kryetarit. Për këtë arsye kërkoj nga audituesit e KLSH që pretendimet e mia të merren në konsideratë.

**Qëndrim i grupit të auditimit:** Kundërshtitë tuaja nuk merren parasysh, për arsye se nuk është zbatuar urdhëri i titullarit dhe për këtë mbajnë përgjegjësi të gjithë anëtarët e grupit të punës, pasi detyra nuk është përmbushur prej tyre.


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**
**V. REKOMANDIME**
**Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave të mëposhtme:**
**A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Tepelenë nuk ka ngritur si duhet një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Nuk janë hartuar rregulla për ruajtjen e aktiveve, përfshirë këtu edhe mbrojtjen dhe ruajtjen e të dhënave elektronike (sistem rezervë back-up), rregulla për dorëzimin e detyrës në rastet e largimit të punonjësve nga puna ,nuk është hartuar regjistri i rriskut, lista e proceseve të punës, gjurma e auditimit nga asnjë sektor dhe drejtori. Në fund të çdo viti vlerësimi i funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit nuk është bërë si duhet nga menaxherët kryesor, duke mos përcaktuar pikat e dobëta të këtij sistemi e marrjen e masave për përmirësimin e tij. Nga stafi nuk njihet mjaftueshëm ligji 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe manuali përkatës në zbatim të këtij ligji.

Njësia e auditit të brendshëm nuk ka kryer auditime në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me rrisht të lart, të tilla si prokurimet publike, ngritja, implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm dhe efektiviteti i këtij sistemi, inspektorati i mbrojtjes së teritorit, asetet. Gjithashtu nga kjo njësi, në auditimin e kryer prej saj, nuk është bërë ndjekja e rekomandimeve pas 6- muajsh, sipas afatit të përcaktuar në manualin e auditimit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, kërkesat e nenit nr.5 dhe nr.6 të ligjit 114/2015, datë 22.10.2015 “ Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” (*Më hollësisht trajtuar në pikën A faqe 17-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1.Rekomandim:**Titullari i njësisë vendore, njësia e auditit të brendshëm dhe menaxherët kryesor të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësinë vendore. Të hartohen rregulla për ruajtjen e aktiveve, duke përfshirë edhe ruajtjen dhe sigurinë e informacionit elektronik, duke siguruar sisteme rezervë të IT (back-up). Të hartohet regjistri i rriskut, gjurma e auditimit dhe lista e proceseve të punës për secilin sektor dhe në nivel institucioni.

**1.2.Rekomandim:**Nga njësia e auditimit të brendshëm të merren masa për planifikimin në programet e auditimit të fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me rrisht të lart, duke i dhënë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave. Të ndiqet zbatimi brenda afateve të caktuara, i rekomandimeve të dhëna nga KLSH si dhe zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga vetë njësia e auditit të brendshëm.

*Deri më 31.03.2020*

**2. Gjetje nga auditimi:** Në shpenzimet buxhetore ka diferenca midis treguesve të planifikimit dhe zbatimit të buxhetit. Në vitin 2017 treguesit e buxhetit për shpenzimet nga 637,570 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 515,970 mijë lekë, ose në masën 81%, në vitin 2018 nga 410,952 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 389,998 mijë lekë, ose në masën 95%, ndërsa për periudhën janar-shtator 2019 nga 319,323 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 228,915 mijë lekë, ose në masën 72%.

Mos realizime të ndjeshme ka në zërin e investimeve, i cili në vitin 2017 është realizuar në masën 68%, në vitin 2018 në masën 90%, ndërsa për periudhën janar-shtator 2019 në masën 31%.


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

Mos realizimi i treguesve buxhetor në shpenzime ka ardhur si rezultat i mos realizimit të të ardhurave të planifikuara, duke bërë që të planifikohen në buxhet shpenzime të pa mbështetura në pritshmërinë reale të të ardhurave.

Peshën më të madhe të mosrealizimit e zënë investimet në periudhën janar-shtator 2019 të cilat janë realizuar në masën 31% ku ndër të tjera shkak i mosrealizimit është edhe vonesa në kryerjen e procedurave të prokurimit publik.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 42; 43; 47; 50; 65; UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, pikat 253, 354 i ndryshuar me Udhëzimin plotësues nr. 2, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018” (Më hollësisht trajtuar në pikën B, faqe 20-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1.Rekomandim:**Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Tepelenë të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm e objektiv të të ardhurave. Të merren në konsideratë realizimet faktike të të ardhurave dhe shpenzimeve në vitin e mëparshëm buxhetor.

*Në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Vlera e faturave të pa likuiduara në 30.09.2019 është **48,674,646 lekë**, nga të cilat detyrime për investime në vlerën 12,220,490 lekë, në 13 raste; detyrime për mallra e shërbime në vlerën 32,435,561 lekë, në 33 raste; detyrime për vendimet gjyqësore të cilat kanë marrë formën e prerë për vlerën 4,018,595 lekë, për 5 raste.

Vlera 48,674,646 lekë është e trashëguar sipas periudhave si më poshtë:

Vlera 9,026,517 e mbartur nga periudha para vitit 2017;

Vlera 6,242,576 është e krijuar gjatë vitit 2017;

Vlera 19,417,869 lekë është e krijuar gjatë vitit 2018;

Vlera 13,987,684 lekë është krijuar gjatë vitit 2019.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH”, i ndryshuar, neni 40 “E drejta për të kryer shpenzime”; UMF nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014;Udhëzimin plotësues nr. 2 të MF, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”; UMF nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore” (Më hollësisht trajtuar në pikën B, faqe 20-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1.Rekomandim:** Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, bazuar në Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” dhe Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 “Për buxhetin e vitit 2019”, pikat 106-110, “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” dhe pikat 116-117- *Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore*’, të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave për vlerën 48,674,646 lekë, sipas aneksit bashkangjitur mbi gjendjen e faturave të pa likuiduara me datën 30.09.2019.

*Në mbledhjen me të afërt të Këshillit Bashkiak*

**4. Gjetje nga auditimi:** Në pasqyrat financiare, gjendja e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore dhe shëndetësore” më 31.12.2017 paraqitet në vlerën 8,981,573 lekë dhe në 31.12.2018 në vlerën 19,907,525 lekë, e cila përfaqëson detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të pa paguara. Gjatë vitit 2019 janë kryer pagesa dhe ky detyrim ka ardhur në ulje. Në datën 30.09.2019 vlera e këtij


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

detyrime është 9,815,896 lekë, ndërsa në datën 20.12.2019, bazuar në dokumentacionin e dërguar nga njësitë vendore (urdhër shpenzimet) pas fazës së projekt raportit, ky detyrim ka shkuar në vlerën 7,063,544 lekë. Edhe pse janë marrë masa dhe është ulur ky detyrim, anomalia e mos pagesës në kohë të sigurimeve shoqërore është materiale, si në kuptimin e materialitetit sasior edhe atij cilësor.

Vlera e pa likuiduar prej **7,063,544 lekë** i përket periudhave të prapambetura ndër vite si më poshtë vijon:

- detyrime të vitit 2010 në vlerën 1,122,342 lekë, për muajt gusht, shtator, tetor, nëntor, për 35 punonjës;
- detyrime të vitit 2011 në vlerën 1,584,683 lekë për muajt mars, prill, maj, shtator, tetor, nëntor, për 35 punonjës;
- detyrime të vitit 2012 në vlerën 2,454,508 lekë për muajt mars, prill, maj, qershor, gusht, shtator, tetor, nëntor, për 33 punonjës.
- detyrime të vitit 2013 në vlerën 1,902,011 lekë, për muajt shkurt, mars, maj, qershor, gusht, për 46 punonjës.

Të gjitha këto detyrime janë pjesore, pra është likuiduar një pjesë e muajve të mësipërm dhe ka ngelur pa likuiduar pjesa tjetër e detyrimit mujor. Sipas vendimit Nr. 90, datë 20.12.2019, të Këshillit Bashkiak Tepelenë, protokolluar në këtë bashki me nr. 1896/3, datë 23.12.2019, (një kopje e skanuar të cilit është dërguar në KLSH), është vendosur që detyrimet e mësipërme në vlerën 7,063,544 lekë të likujdohen brenda muajit shkurt 2020.

- Gjithashtu nuk është kryer kontabilizimi i plotë sipas nomenklaturës së llogarive të planit kontabël publik, pasi vlera e detyrimit 19,907,525 lekë e nxjerrë në bilanc, nuk është ndarë e analizuar përkatësisht në llogarinë 435 “Sigurime shoqërore”, llogarinë 436 “Sigurime shëndetësore”, si dhe nuk është klasifikuar në: -detyrime të vitit në vazhdim (viti 2018 në vlerën 7,748,651 lekë), detyrime të vitit të mëparshëm (viti 2017 në vlerën 5,039,393 lekë dhe periudha 2010-2013 në vlerën 7,119,481 lekë).

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.9136, datë 11.9.2003 i ndryshuar “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, neni 6 -Detyrimet e personave që paguajnë kontributet, neni 11 -Afatet e deklarimit dhe të pagesës, UMF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” dhe të VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; pika 1. Përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël, me cilësinë e sistemit kontabël të përgjithshëm, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, standardet dhe rregullat kontabël, kapitulli IV, llogaritë e të tretëve, klasa 4 (*Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 42-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

**4.1.Rekomandim:** Titullari i njësisë vendore dhe Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, të marrin masa të menjëhershme pagesën e detyrimeve të prapambetura për sigurime shoqërore dhe shëndetësore në vlerën **7,063,544 lekë**.

Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, të marrë masa për zbatimin e procedurave ligjore për klasifikimin kontabël të llogarisë 435 “Sigurime shoqërore dhe shëndetësore”.

***Brenda muajit shkurt 2020***

**5. Gjetje nga auditimi:** Në pasqyrat financiare, gjendja e llogarisë 423,429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba”, në fund të vitit 2018 paraqitet e pa ndryshuar në vlerën 1,254,774 lekë, e cila përfaqëson detyrimet e punonjësve për tatimin mbi pagë për vitin 2018 dhe të trashëguar ndër vite. Konstatohet se, vlera totale 1,254,774 lekë nuk është analizuar sipas klasifikimit kontabël përkatësisht: në detyrime të vitit në vazhdim 2018 në vlerën 351,466 lekë, në detyrime të viteve të




**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

mëparshme për vitet 2010-2013 në vlerën 903,308 lekë, të trashëguara dhe të pa arkëtuara nga punonjësit si dhe nuk është arkëtuar nga punonjësit vlera 1,254,774 lekë dhe nuk është derdhur për llogari buxhetit të shtetit se detyrim për tatimin mbi pagë, veprimi dhe mosveprimi është në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” dhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; pika 1. Përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël, me cilësinë e sistemit kontabël të përgjithshëm, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, standardet dhe rregullat kontabël, kapitulli IV, llogaritë e të tretëve, klasa 4 (Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 42-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**5.1.Rekomandim:**Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, të marrë masa për zbatimin e procedurave ligjore për klasifikimin kontabël të llogarisë 423,429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” dhe të pagesës së detyrimeve të prapambetura të punonjësve për tatimin mbi pagë për vitin 2018 dhe të trashëguar ndër vite në vlerën 1,254,774 lekë.

*Në hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2020*

**6. Gjetje nga auditimi:** Në pasqyrat financiare, gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” në fund të vitit 2018, paraqitet në vlerën 10,516,840 lekë, e cila përfaqëson vlerat e 9 projekteve për objekte të cilat kanë përfunduar punimet dhe janë marrë në dorëzim nga njësia vendore, (sipas aneksit në fund të raportit) , vlerë e cila duhet të ishte sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar, si pjesë e kostos totale të objektit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”; UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika c, nën pika b (Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 42-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**6.1.Rekomandim:**Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”, duke bërë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, për të cilat investimet e lidhura me to nuk kanë përfunduar. Kjo llogari të zvogëlohet për vlerën **10,516,840 lekë** dhe kjo vlerë të shtohet në investimet e përfunduara sipas objekteve që u përkasin projektet.

*Në hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2020*

**7. Gjetje nga auditimi:** Në pasqyrat e pozicionit financiar, llogaria 210 “Toka, troje, terrene” dhe llogaria nr. 211 “Pyje, kullota, plantacione”, nuk paraqesin vlerën e saktë të pasurisë së njësive vendore, për shkak të mos marrjes së masave për rregjistrimin në ZVRPP të pasurive ekzistuese dhe të atyre të cilat me VKM të posaçme kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Tepelenë. Në vitin 2018 llogaria 210 “Toka, troje, terrene” ka vlerën 7,778,488 lekë dhe përbëhet nga vlera 250,910 lekë për parqe dhe lulishte, vlera 2,879,803 lekë për rehabilitim ambiente publike, vlera 3,279,917 lekë për sistemime të ambienteve publike, vlera 1,367,858 lekë për kënde lojërash për fëmijë. Llogaria nr. 211 “Pyje, kullota, plantacione” në fund të vitit 2018 ka vlerën 96,200 lekë dhe paraqet vlerën e pemëve dekorative.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, neni 15, pika 1 dhe 2, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli IV. pika 74 dhe 96 dhe të UMF nr. 8 datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” (Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 42-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

**7.1.Rekomandim:** Titullari i njësisë vendore, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, të marrë masa për sistemimin e llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” dhe llogarisë nr. 211 “Pyje, kullota, plantacione, duke bërë që në këto llogari të paraqitet vlera e saktë e pasurisë së njësisë vendore. Të inventarizohen këto prona, duke krijuar regjistrin e aktiveve me të gjitha të dhënat e nevojshme (vendndodhje, sipërfaqja etj.). Të merren masa për rregjistrimin e këtyre aseteve në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës.

*Deri më 31.03.2020*

**8. Gjetje nga auditimi:** Në pasqyrat e pozicionit financiar, gjendja e llogarisë 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa”, në 31.12.2018 paraqitet në vlerën 3,255,400 lekë, e cila përfaqëson detyrime të pa paguar të bashkisë ndaj buxhetit të shtetit për tatimin mbi pagë të personelit, e analizuar si më poshtë:

-vlera 351,466 lekë, dhjetor viti 2018

-vlera 1,283,450 lekë, janar-dhjetor viti 2013(pjesërisht)

-vlera 917,708 lekë, janar-dhjetor viti 2012 (pjesërisht)

-vlera 562,436 lekë, mars-dhjetor viti 2011(pjesërisht)

-vlera 140,340 lekë, gusht-nëntor viti 2010.(pjesërisht).

Vlera 3,255,400 lekë nuk është analizuar sipas klasifikimit kontabël përkatësisht: -detyrime të vitit në vazhdim 2018 në vlerën 351,466 lekë, -detyrime të viteve të mëparshme për vitet 2010-2013 në vlerën 2,903,934 lekë, të trashëguara dhe të pa derdhura në llogari të buxhetit të shtetit.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.9136, datë 11.9.2003 i ndryshuar “ Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, neni 6 -Detyrimet e personave që paguajnë kontributet, neni 11 -Afatet e deklarimit dhe të pagesës; UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”; VKM nr. 783,datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; pika 1- Përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël, me cilësinë e sistemit kontabël të përgjithshëm, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi,standartet dhe rregullat kontabël, kapitulli IV, llogaritë e të tretëve, klasa 4 (Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 42-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1.Rekomandim:** Titullari i njësisë vendore dhe Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, të marrin masa të menjëhershme për pagesën e detyrimeve të prapambetura në vlerën 3,255,400 lekë për tatimin mbi pagë të personelit, si dhe për zbatimin e procedurave ligjore për klasifikimin kontabël të llogarisë 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa”.

*Brenda muajit shkurt 2019*

**9. Gjetje nga auditimi:** Në katër procedura prokurimi, një pjesë e kriterëve të veçanta të DST që lidhen me kapacitetin teknik, nuk janë të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, vlerën dhe natyrën e kontratës, si dhe nuk janë argumentuar. Në raste të veçanta nuk janë përcaktuar dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Procedura në të cilat janë konstatuar shkeljet e mësipërme janë:1)"Sistemim asfaltim rruga Pasarelë – Dragot (loti I), me vlerë të fondit limit 46,796,083 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.09.2017; 2) "Rehabilitim kanali ujitës Gusmar”, me vlerë të fondit limit 16,906,652 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.11.2017; 3) “Rikonstruksion i kanalit ujitës në fshatrat Koder-Lekel”, me vlerë të fondit limit 11,427,499 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.03.2017; 4), “Rikonstruksion i kanalit ujitës në fshatin Luzat”, me vlerë të fondit limit 9,245,280 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.03.2017. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm:

- neni 26- Kontratat për punë publike, pika nr. 5;



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”

- nenin 61, pika nr.2 (Më hollësisht trajtuar në pikën D1, faqe 52-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1.Rekomandim:** Në hartimin e kriterëve të DST, njësia e prokurimit të jap argumente për secilin kriter dhe këto argumente të bëhen pjesë e procesverbalit që mbahet prej saj. Argumentimi të bëhet duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve, etj.

Në vijimësi

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga autoriteti kontraktor Bashkia Tepelenë, nuk janë marrë masa për trajnimin e zyrtarëve të përfshirë në veprimtarinë e prokurimit publik (personave të cilët janë caktuar të kryejnë detyrën e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave dhe anëtarit të njësisë së prokurimit. Njësia vendore nuk ka paraqitur asnjë kërkesë pranë APP për trajnimin e tyre, duke mos garantuar se këta punonjës kanë aftësitë dhe përgatitjen e duhur në drejtim të njohjes së bazës ligjore në fushën e prokurimit publik, për kryerjen e detyrës së ngarkuar. Kryerja e trajnimeve është një domosdoshmëri për anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave dhe anëtarit të njësisë së prokurimit, si dhe çdo komisioni tjetër që ngrihet për kryerjen e detyrave që i ngarkohen nga titullari, pasi nëpërmjet tyre ulen rrisqet e kryerjes së gabimeve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 83 (Më hollësisht trajtuar në pikën D1, faqe 52-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1.Rekomandim:** Titullari i njësisë vendore dhe njësia e burimeve njerëzore, të marrin masa për trajnimin e zyrtarëve të përfshirë në veprimtarinë e prokurimit publik, duke paraqitur në çdo fillim viti pranë APP, kërkesë për trajnimin e punonjësve të cilët do të jenë të angazhuar si anëtar të KVO dhe NJP.

Në vijimësi

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga institucioni Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), nëpërmjet njësisë vendore, konstatohet se numri i subjekteve të regjistruara në QKB dhe me status aktiv, që zhvillojnë aktivitet në teritorin e Bashkisë Tepelenë, është 619, nga të cilat 155 subjekte të kategorisë person juridik dhe 464 subjekte të kategorisë person fizik. Por nga dokumentacioni që u paraqit nga zyra e taksave dhe tarifave vendore, konstatohet se numri i subjekteve të regjistruara në njësinë vendore, për të cilat llogariten taksa dhe tarifa, është 412, nga të cilat 87 subjekte të kategorisë person juridik dhe 325 subjekte të kategorisë person fizik, pra 207 subjekte më pak. Nga zyra e taksave dhe tarifave vendore jepen shpjegime se diferenca vjen si rezultat i mbylljes së këtyre subjekteve dhe mos kryerjes prej tyre të deklarimeve dhe azhurnimeve në organet tatimore dhe QKB. Ky mos rakordim nuk jep siguri se numri i bizneseve të regjistruar në njësinë vendore për pagesën e taksave dhe tarifave vendore është i saktë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 40, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 40 - Regjistrimi i personave që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jo tregtare, pika 4- Regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit shërben njëkohësisht si regjistrim në administratën tatimore (Më hollësisht trajtuar në pikën B2, faqe 25-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1.Rekomandim:** Me qëllim evidentimin e saktë të numrit të bizneseve që kryejnë aktivitet në Bashkinë Tepelenë, drejtoria ekonomike, zyra e taksave dhe tarifave vendore, të verifikojnë në teren numrin e bizneseve faktik që ushtrojnë aktivitet, si dhe të bashkëpunojnë me drejtorinë rajonale Tatimore Gjirokastër dhe QKB për të evidentuar subjektet e mbyllura, që nuk ushtrojnë aktivitet e nuk kanë bërë deklarin për këtë qëllim. Në fund të verifikimeve dhe rakordimeve të bëhen ndryshimet e nevojshme në regjistrin e taksapaguesve privat në Bashkinë Tepelenë. Çdo ndryshim të justifikohet me dokumentacion përkatës.

Në vijimësi


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga dokumentacioni i paraqitur nga zyra e taksave dhe tarifave vendore konstatohet se në Bashkinë Tepelenë në vitin 2019 kanë zhvilluar aktivitetet 32 subjekte pa u regjistruar në QKB. Mos rregjistrimi i subjekteve në QKB, ka sjellë mos regjistrimin e tyre në organet tatimore, e për pasojë mos pagesën e detyrimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe TAP, por edhe dëmtim e vetë individëve, të cilët nuk vlerësojnë interesat e tyre afatgjata, që sjellë vetëdeklarimi dhe regjistrimi në skemën e sigurimeve. Nga drejtoria e taksave dhe tarifave vendore Bashkia Tepelenë nuk janë marrë masa për mbyllje të veprimtarisë së këtyre subjekteve dhe konfiskim të mallit si dhe nuk është vendosur asnjë gjobë ndaj tyre, në kundërshtim me nenin 41-Identifikimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare pa u regjistruar në nenit 112 -Mungesa e ekzekutimit të detyrimit për regjistrim, të ligjit nr. 9920 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, pikën 6 dhe 7 të paragrafit III të VKM 77, datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën B.2, faqe 25-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**12.1. Rekomandim:** Sektori i taksave dhe tarifave vendore, për subjektet e paregjistruara në QKR të njoftojnë zyrtarisht Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjyrokastër dhe QKB për marrjen e masave për futjen e tyre në sistemin e deklarimit. Në rastet e konstatimit të subjekteve që zhvillojnë aktivitet në territorin e njësisë vendore pa u regjistruar, të marrë të gjitha masa për mos lejimin e tyre, duke vendosur sanksione e llogaritur detyrimet tatimore edhe për periudhën e pa regjistruar, me qëllimin final që subjektet të kryejnë regjistrimin e tyre në QKB.

**Në vijimësi**

**13. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Tepelenë është audituar nga KLSH në vitin 2016 dhe në vijim është bërë verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të dërguara në Bashkinë Tepelenë nga KLSH. Me shkresën nr. 1113/122, datë 1153/40 është rikërkuar zbatimi i masave të pa zbatuara. Për përmirësimin e gjendjes janë rikërkuar 11 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 11 masa, janë zbatuar 10 dhe 1 masë e pa zbatuar.

Nga 25 masa për shpërblim dëmi, në vlerën 63,988,000 lekë, të cilat janë pranuar dhe kontabilizuar, deri me datë 30.09.2019 janë arkëtuar 1,619,316 lekë, ndërsa shuma 62,368,684 lekë nuk është arkëtuar.

Nga 25 masat e mësipërme, për 19 prej tyre në vlerën 9,106,270 lekë janë nxjerrë urdhrat e titullarit për zbatim, por nuk janë kryer veprime të mëtejshme për arkëtim, 5 masa për shpërblim dëmi në vlerën 46,209,883 lekë janë në proces gjyqësor dhe 1 masë shpërblim dëmi në vlerën 5,917,096 lekë, që i përket arkëtitimit për detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, nga njësi vendore janë nxjerrë urdhrat e bllokimit për llogaritë bankare, hipotekë dhe drejtorinë e transportit rrugor, por ende e pa arkëtuar.

-Për 11 masa administrative, nuk janë zbatuar penaltetet e vendosura nga APP mbi shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve në vlerën totale prej 1,900,000 lekë.

- Në lidhje me njoftimin e Komisionit të Licencave, pranë Ministrisë të Zhvillimit Urban për heqjen e licensave për dy subjekte: -R. S. (në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të firmës “I. K.” Shpk; - Ing. Gj. M. (në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve), nuk është bërë njoftimi nga ana e IMTV (*Më hollësisht trajtuar në pikën E faqe 72-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**13.1 Rekomandim** Nga Kryetari i Bashkia Tepelenë, drejtoria juridike dhe ekonomike të merren masa të menjëhershme për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Për këtë të ndiqen të gjitha rrugët e mundshme ligjore deri në hapjen e proceseve gjyqësore. Nga titullari të hartohet një plan veprimi dhe të caktohen personat përgjegjës për zbatimin e tij. Të njoftohet KLSH për masat e marra.

*Deri më 31.03.2020*


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**
**B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga **Titullari i Njësisë Publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **2,404,479 lekë**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “*Rikonstruksion i Rrugës “Ago Celi”, Rrugës së re dhe Rikonceptim i palestrës të lagjes “15 Shtatori”, Bashkia Tepelenë*, me vlerë të kontratës 140,470,869 lekë me TVSH, shpallur fitues operatori ekonomikë (OE) “G. C.” SHPK, rezultoi se nuk janë realizuar zërat e punimeve: “FV Rrjetë plegmë Ø 6 mm çdo 20 cm për trotuarët”; “Punime ndërtimi për trotuarin” duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën **390,280 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve me nr. 1/1 Prot, datë 10.02.2017, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tepelenë dhe sipërmarrësit Operatorit Ekonomikë “G. C. SHPK”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve me nr. 1/1 Prot, datë 10.02.2017, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tepelenë dhe sipërmarrësit Operatorit Ekonomikë “G. C. SHPK” (*Më hollësisht trajtuar në pikën D2 faqe 60-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Tepelenë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **390,280 lekë pa TVSH** nga OE “G. C.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1/1 Prot, datë 10.02.2017, për kryerjen e punimeve me objekt “*Rikonstruksion i Rrugës “Ago Celi”, Rrugës së re dhe Rikonceptim i palestrës të lagjes “15 Shtatori”, Bashkia Tepelenë*, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

*Deri më 31.03.2020*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “*Rikonstruksion i kanalit ujitës në fshatin Luzat NjA Qendër”, Bashkia Tepelenë*, me vlerë të kontratës bazë 8,686,074 lekë me TVSH dhe shtesës së kontratës me vlerë 1,736,979 lekë me TVSH, shpallur fitues operatori ekonomikë (OE) “A.” SHPK, rezultoi se nuk janë realizuar zërat e punimeve: “Germim shkëmbi”; “Germim kanalesh në tokë të fortë, me krahë, me seksion 0.75 m<sup>2</sup>”; “Germim tokë e zakonshme”; “Mure betoni C 12/15” dhe “Hidroizolim tubacion dy duar bitum” të kontratës bazë dhe zëri “Veshje me beton C 16/20” që i përket shtesës së kontratës, duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën **825,098 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën bazë me nr. 46/1 Prot, datë 06.04.2017 dhe shtesës së kontratës me nr. 46/2 Prot, datë 07.06.2017, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tepelenë dhe sipërmarrësit Operatorit Ekonomikë “A.” SHPK (*Më hollësisht trajtuar në pikën D2 faqe 60-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Tepelenë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **825,098 lekë pa TVSH** nga OE “A.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit të kontratës bazë me nr. 46/1 Prot., datë 06.04.2017 dhe shtesës së kontratës me nr. 46/2 Prot., datë 07.06.2017, për kryerjen e punimeve me objekt “*Rikonstruksion i kanalit ujitës në fshatin Luzat NjA Qender”, Bashkia Tepelenë*, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

*Deri më 31.03.2020*


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “*Rikonstruksion i qendrës së fshatit Veliqot*”, Bashkia Tepelenë, me vlerë të kontratës 4,657,095 shpallur fitues operatori ekonomikë “A.” SHPK, rezultoi se nuk janë realizuar zërat e punimeve: “Prishje shtresash”; “Spërkatje me emulsion bituminoz 0.5 l/m<sup>2</sup>”; “Shtresë binderi me granil gur kave 6 cm me makineri”; “Shtresë asfaltobetoni me granil gur kave, 4 cm, me makineri”, duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën **456,518 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën bazë me nr. 77/3 Prot, datë 13.06.2017, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tepelenë dhe sipërmarrësit Operatorit Ekonomikë “A.” SHPK (*Më hollësisht trajtuar në pikën D2 faqe 60-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Tepelenë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **456,518 lekë pa TVSH** nga Operatori Ekonomikë “A.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 77/3 Prot, datë 13.06.2017 me objekt “*Rikonstruksion i qendrës së fshatit Veliqot*”, Bashkia Tepelenë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

*Deri më 31.03.2020*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “*Rikonstruksioni i bllokut midis rrugës Tafil Buzi dhe rrugës Bilbilenjtë*”, me vlerë të kontratës 4,152,691 lekë pa TVSH, shpallur fitues operatori ekonomikë “Sh.” SHPK, rezultuan diferenca midis volumeve të punimeve të situacionuara e likuiduara dhe volumeve të punimeve të kryera në fakt, në vlerën **149,488 lekë pa TVSH**, dëm ekonomik për buxhetin e shtetit dhe të njësisë vendore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve Nr. 38/1 prot., datë 18.05.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Tepelenë dhe OE “Sh.” SHPK (*Më hollësisht trajtuar në pikën D2 faqe 60-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Tepelenë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **149,488 lekë pa TVSH** nga OE “Sh.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 38/1 prot datë 18.05.2018, me objekt “*Rikonstruksioni i bllokut midis rrugës Tafil Buzi dhe rrugës Bilbilenjtë*”, Bashkia Tepelenë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

*Deri më 31.03.2020*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “*Sistemim Asfaltim rruga Pasarelë – Dragot, Loti I*”, Bashkia Tepelenë, me vlerë të kontratës 46,784,793 lekë pa TVSH, shpallur fitues operatori ekonomikë “C. R.” SHPK, rezultuan diferenca midis volumeve të punimeve të situacionuara e likuiduara dhe volumeve të punimeve të kryera në fakt, në vlerën **225,831 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve Nr. 131/1 prot datë 03.10.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Tepelenë dhe OE “C. R.” SHPK (*Më hollësisht trajtuar në pikën D2 faqe 60-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**5.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Tepelenë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **225,831 lekë pa TVSH** nga OE “C. R.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 131/1 prot datë 03.10.2017, me objekt “*Sistemim Asfaltim rruga Pasarelë – Dragot, Loti I*”, Bashkia Tepelenë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

*Deri më 31.03.2020*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “*Rehabilitim i kanalit ujitës Gusmar*”, Bashkia Tepelenë, me vlerë të kontratës 16,899,033 lekë pa



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”

TVSH, shpallur fitues operatori ekonomikë “Sh.” SHPK, rezultuan diferenca midis volumeve të punimeve të situacionuara e likuiduara dhe volumeve të punimeve të kryera në fakt, në vlerën **357,264 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve pa nr. prot datë 04.12.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Tepelenë dhe OE “Sh.” SHPK (Më hollësisht trajtuar në pikën D2 faqe 60-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Tepelenë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **357,264 lekë pa TVSH** nga OE “Sh.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën pa nr. prot datë 04.12.2017, me objekt “Rehabilitim i kanalit ujitës Gusmar”, Bashkia Tepelenë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

*Deri më 31.03.2020*

## **B.1 MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Tepelenë për periudhën objekt auditimi ka administruar për zbatim 7 vendime gjyqësore të formës së prerë (të mbartura dhe gjatë periudhës së auditimit) në vlerën 6,270,288 lekë, efekt negativ në buxhetin e njësisë vendore. Nga vendimet e mësipërme tre raste janë për “Dëmshpërblim për largim të padrejtë nga puna”, në vlerën 2,812,560 lekë, katër raste për “detyrim kontrate” në vlerën 3,454,728 lekë, janë shtuar gjatë periudhës vlera 3,369,415 lekë, janë zbatuar (likuiduar) në vlerën 5,621,108 lekë, përkatësisht në vitin 2017 vlera 2,173,493, lekë, në vitin 2018 vlera 2,977,615 lekë dhe në vitin 2019 vlera 470,000 lekë, pra efekti real si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore për periudhën janar 2017 – shtator 2019 është **5,621,108 lekë, efekt negativ financiar për buxhetin e njësisë vendore**. Mbeten për likuidim të mëtejshëm në buxhetin e vitit 2019, e në vijim vlera 4,018,595 lekë, zbatimi i vendimeve të mësipërme do të rëndoj shpenzimet e viteve në vazhdim. Përpara zbatimit të vendimeve gjyqësore nga titullari nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative dhe nuk është nxjerrë akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi, në kundërshtim me pikën 62 të UMF nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” (Më hollësisht trajtuar në pikën B.1, faqe 20-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**1.1. Rekomandim:** Titullar i njësisë vendore të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore, të nxjerr arsyet dhe përgjegjësitë për efektin negativ që këto vendime kanë dhënë në buxhetin e njësisë vendore, ndërsa sektori juridik të ndjek proceset në të gjitha shkallët e gjyqimit, duke bërë edhe rekurs. Në rastet e largimeve të punonjësve nga puna, nga sektori juridik dhe titullari të zbatohen të gjitha procedurat e nevojshme të afateve të njoftimit dhe të pagesave të duhura, me qëllim që të ulen rrisqet e humbjes së proceseve gjyqësore. Përpara zbatimit të vendimit gjyqësor Titullari të nxjerr përgjegjësitë administrative, si dhe aktin që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi.

*Brenda muajit shkurt 2020*

## **B.2. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR TË RRIUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga puna e pa mjaftueshme e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Tepelenë, në fund të vitit 2019 janë krijuar debitorë për taksat dhe tarifa vendore në vlerën totale **12,618,921 lekë**. Kjo vlerë përbëhet nga detyrimi prej 11,263,917 lekë nga subjektet private (principal 9,410,242 lekë, kamatëvonesë 1,826,675 lekë), si dhe detyrimi prej 1,355,004 lekë nga 953 subjekte familjare, sipas rakordimit që njësia vendore ka me “U.T.” SHA. Vlera debitore e taksapaguesve privat është e ndarë si më poshtë:

- për vitin 2017 vlera e debisë 2,739,025 lekë, nga e cila principali 2,212,959 lekë, kamat vonesa 526,066 lekë, numri subjekteve debitor 112, nga të cilat 16 subjekte biznesi i madh dhe 96 subjekte biznesi i vogël;


**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

- për vitin 2018 vlera e debisë 3,987,683, nga e cila principali 3,268,040 lekë, kamat vonesa 719,643 lekë, numri subjekteve debitor 143 nga të cilat 31 subjekte biznesi i madh dhe 112 subjekte biznesi i vogël;

- për vitin 2019 vlera e debisë 4,537,209 lekë, nga e cila principali 3,722,074 lekë, kamat vonesa 815,135 lekë, numri subjekteve debitor 205, nga të cilat 32 subjekte biznesi i madh dhe 173 subjekte biznesi i vogël.

Nga zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk janë ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme ligjore, për arkëtimin e debitorëve veprim në kundërshtim me nenin 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenet 91, të ligjit nr. 9920 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe nenin 12 të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore (*Më hollësisht trajtuar në pikën B2, faqe 27-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1. Rekomandim:** Drejtoria ekonomike, zyra e taksave dhe tarifave vendore, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, *për të gjitha subjektet e private* për vlerën e detyrimit prej **11,263,917 lekë** të nxjerrë njoftim vlerësimet tatimore dhe në vazhdim të marrën masat për arkëtimin e këtij detyrimi, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

**a-** Tu dërgohen të gjitha bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

**b-** Tu dërgohen Drejtorisë Rajonale të Transportit, si dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, kërkesat për vendosjen e barrës siguroese respektivisht për mjetet dhe për pasuritë e paluajtshme, bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

**c-** Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë, nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, bazuar në nenin 182, të ligjit të Kodit Penal në RSH i ndryshuar, pasi të vendosen masa administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal.

**d-** Për debitorët e kategorisë familjare bazuar në akt-marrëveshjen e lidhur me “U.” ShA, të kërkojë nga kjo e fundit në cilësinë e agjentit tatimor, të marrë masa për arkëtimin e detyrimit prej 1,355,004 lekë nga 953 subjekte familjare (*Më hollësisht trajtuar në pikën B2 faqe 25-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

*Deri më 31.03.2020*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga drejtoria e planifikimit, zhvillimit dhe kontrollit të territorit dhe sektori i taksave dhe tarifave vendore, Bashkia Tepelenë, nuk është llogaritur saktë taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja, nuk është kryer përlllogaritja në bazë të çmimit referencë që është kosto mesatare e ndërtimit sipas Entit Kombëtar të Banesave, me pasojë **të ardhura të munguara për buxhetin e njësisë vendore në vlerën 7,429,682 lekë**. Kjo vlerë është detyrim nga tre pronarët e lejeve të ndërtimit si më poshtë:

- z. Xh. N. në vlerën 43,920 lekë, leje ndërtimi në vitin 2017;

- z. R. T. në vlerën 782,818 lekë, leje ndërtimi në vitin 2018;

- z. I. H. dhe B. H. në vlerën 6,603,574 lekë leje ndërtimi në vitin 2019.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, neni 46, Udhëzimin e KM nr.4, datë 30.9.2015 “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i banesave, për vitin 2015”, Udhëzimin KM nr.3, datë 28.12.2016, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i banesave, për vitin 2016”, VKB nr.2, datë 20.01.2017, nr.41, datë 21.12.2017 dhe nr.74, datë 28.12.2018 “Për miratimin e Paketës Fiskale të Bashkisë Tepelenë” (*Më hollësisht trajtuar në pikën B2 faqe 25-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).




**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tepelenë”**

**2.1.Rekomandim:** Nga titullari i njësisë vendore, drejtorja e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, zyra e taksave vendore, të merren të gjitha masat e duhura ligjore, për arkëtimin e detyrimit prej **7,429,682 lekë** nga pronarët e lejeve të ndërtimit si më poshtë:

- z. Xh. N. në vlerën 43,920 lekë;
- z. R. T. në vlerën 782,818 lekë;
- z. I. H. dhe B. H. në vlerën 6,603,574 lekë.

*Deri më 31.03.2020*

**3. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e programimit dhe realizimit të të ardhurave, nga dhënia me qira e aseteve të Bashkisë Tepelenë subjekteve private, të cilat janë pajisur me leje minerare të miratuara nga “Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi, për periudhën 01.01.2017 deri më 30.09.2019, u konstatua se:

-Në një rast nuk është lidhur kontratë qiraje me subjektin “K.” SHPK me NIPT K.....W, pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror, me vendndodhje në fshatin Luzat, Tepelenë, me sipërfaqe 1 (një) ha, me pasojë mos llogaritjen dhe mos arkëtimin e detyrimit në vlerën 1,209,994 lekë, të ardhura të munguara për buxhetin e njësisë vendore.

-Në një rast është lidhur kontratë qiraje me subjektin “C.” SHPK me NIPT K.....M, pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror, me vendndodhje në Bënçë, Tepelenë me sipërfaqe 3,3 ha, por nga detyrimi total që rrjedh nga kontrata e lidhur nuk është arkëtuar vlera 3,570,600 lekë, e ardhur e munguar për buxhetin e njësisë vendore.

-Në një rast, është lidhur kontratë qiraje nr. 53, datë 11.04.2011, me subjektin “I.” SHPK, me objekt dhënie në përdorim nga fondi Pyjor/kullosor një sipërfaqe prej 2,253 ha, për ndërtimin e Hidrocentralit “B. i L.”, me vendndodhje në fshatin Mezhgoran”, Tepelenë, por nga subjekti nuk është kryer pagesa e plotë e detyrimit në vlerën 185,873 lekë.

**Tre rastet e mësipërme i kanë shkaktuar buxhetit të njësisë vendore të ardhura të munguara në vlerën 4,966,467 lekë.** Veprimi dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 391, datë 21.06.2006, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar, lidhja nr. 2, pikat 6 dhe 11 (*Më hollësisht trajtuar në pikën B2 faqe 25-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

